

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7430 E diel 4 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga JORGJI KOTE



Vit rekord me 30 data jubilare



Opinion i Ditës

Nga PËLLUMB KARAMETA

Planifikimi "6 në 3" si risi kurrikulare

Në vendin tonë dhe në trojet e banuara nga shqiptarët kanë filluar të përkujtohen disa ngjarje epokale, ku spikat 550-vjetori i vdekjes së Heroit ...  
Vijon në faqen 21

Mësuesit e dinë që koha mësimore dhe ngarkesa ditore e nxënësve janë elemente thelbësore që ndikojnë suksesin. Historikisht, shkollat kanë evoluar nga ...  
Vijon në faqen 22



EKSKLUZIVE

MILOSAO/ Historiani: Ksenofobi e skajshme

## Oliver Schmitt: Më kanë fyer dhe kërcënuar pas librit për Skënderbeun

"S" kam shkruar se Kastrioti ka origjinë të pastër serbe. Ofendimet? Njerëzit u nxitën nga Kadare"

Nga BEN ANDONI

Në këtë intervistë të gjatë për "Milosao", historiani i njohur tregon disa nga keqkuptimet për monografinë e tij, por edhe në mënyrë të thukët mënyrën sesi e ka parë Skënderbeun. Ai shprehet se e respekton figurën e Skënderbeut...

Suplement

## PRAPASKENAT E KRIMIT/ VIKTIMA DYSHOI, POR ME PAS E LA TE LIRE KILLERIN GREK

# DEVI KASMI IA VURI ARMEN NE KOKE VRASESIT TE TIJ

Dëshmia në polici e ish-efektivit të forcave speciale greke. Kush është Aurel Hoxhallari, i dyshuari si organizator dhe çfarë fiksuan kamerat e sigurisë



FLET KOLONELI Myslim Pashaj: "Deti"? Duhet një ekip me miratimin e Presidentit

Në faqen 4



CEREMONIA Viti i parë pa Diritëroin, Sadija: Ai më jep forcë e kurajë për jetën

Në faqen 7

(Në foto) Momenti kur Mario Meshini largohet nga vendi i ngjarjes. Viktima Devi Kasmi.Autori i dyshuar, Efthymiou Efthymios

Në faqet 2-3

EKONOMI



Tatimet: Emrat e 127 biznesmenëve që morën gjoba për kasat dhe kuponat

Në faqen 8

Operacioni "Forca e ligjit", agentët e infiltruar zbuluan bazën e drogës

## Kokainë dhe heroinë, 7 vetë në pranga

Kush janë të arrestuarit në Shkodër, disa prej tyre me precedentë penalë

Nga SENAD NIKSHIQI

Shtatë persona, pjesë e një grupi kriminal që shpërndante kokainë dhe heroinë në Shkodër kanë përfunduar në pranga, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Mësohet se në kuadër të opera-



cionit "Forca e ligjit" (goditja e dytë në qytetin verior) u sekuestrua një sasi prej 2.237 kg kokainë. Droga u gjet në lokalitë e natës "Sampa" në fshatin Beltojë të zonës së Bërdicës, i cili që prej të paktën 3 vitesh ishte kthyer në ...

Në faqen 12

MAXHORANCA Lëvizjet në kryesinë e PS, kush ikën dhe kush vjen në drejtim

Në faqen 6

NGA SHABAN MURATI Mbi romanin "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë", të Flutura Açës

Në faqen 11

## VRASJA NE TIRANE HETIMET

Aurel Hoxhallari dyshohet si personi që ka organizuar këtë krim duke aktivizuar ish-policin grek Eftimiu, që ka hyrë në mënyrë klandestine në Shqipëri, pasi nuk është i regjistruar në asnjë pikë kufitare.



Momenti kur Mario Meshini largohet nga vendi i ngjarjes



Vendi ku u ekzekutua Devi Kasmit

Iu gjetën 25 mijë euro, dyshohet se shumica është "pazari" për ekzekutimin e Devi Kasmit

# "Në Shqipëri kam ardhur për qejf, s'kam kryer krim"

Greku Eftymiu Eftymious në polici: Njoh njërin nga të arrestuarit

Ina Allkanjari

Në Shqipëri kam ardhur për qejf. S'kam kryer asnjë krim". Kështu mësohet të ketë thënë djepë përpara hetuesve, ish-policin i forcave speciale greke, Eftymiu Eftymious, i cili dyshohet të jetë ekzekutori i Devi Kasmit, 41-vjeçari u qëllua disa ditë më parë me 4 plumba ku humbi jetën, pas një prite të bërë përpara shtëpisë së tij. Eftymious, shtetasi grek i arrestuar për vrasjen e Dëfrim Devi Kasmit mohan të ketë lidhje me atentatin e 29 janarit në rrugën "Petro Cani". Gjatë dëshmisë në policinë e Tiranës, ish-policin i forcave speciale greke tha se nuk ka lidhje me ngjarjen. Ai ka pranuar para hetuesve se prej disa kohësh ndodhej në vendin tonë, por jo për arsye kriminale po për disa ditë pushime. I pyetur për pjesëtarët e tjerë të grupit të arrestuar për të njëjtën akuzë greku tha se një vetëm njërin prej tyre. Akuzat janë mohuar edhe nga të arrestuarit e tjerë, Elton Halipaj, Malvin Dinellari Elton Hoxhallari dhe Mario Meshini, të cilët vijojnë të mbahen në ambientet e drejtorisë së policisë së kryeqytetit. Ata pritet që të dalin ditën e sotme për masë sigurie në Gjykatën e Tiranës. Ndërkohë policia dhe prokuroria thonë se ekzekutimi i Devi Kasmit mund të ketë ndodhur ose për përplasje të grupeve të drogës ose për të marrë hak për një krim të 2011



Ish-policin i forcave speciale greke, Eftymiu Eftymious

### DËSHMIA

Gjatë dëshmisë në policinë e Tiranës, ish-policin i forcave speciale greke tha se nuk ka lidhje me ngjarjen. Ai ka pranuar para hetuesve se prej disa kohësh ndodhej në vendin tonë, por jo për arsye kriminale po për disa ditë pushime. I pyetur për pjesëtarët e tjerë të grupit të arrestuar për të njëjtën akuzë greku tha se një vetëm njërin prej tyre.

në Tiranë. Dhe Aurel Hoxhallari dyshohet si personi që ka organizuar këtë krim duke aktivizuar ish-policin grek Eftimiu, që ka hyrë në mënyrë klandestine në Shqipëri, pasi nuk është i regjistruar në asnjë pikë kufitare. Përveç arsenalit të armëve të gjetur në banesën e vëllezërve Hoxhallari, policia beson që ka gjetur armën e krimit, një pistoletë "Glok" dhe veshjen që përdori vrasësi natën që qëlloi viktimën. Ndërsa hetuesit shpresojnë

të bindin njërin nga pesë të arrestuarit, që të pranojë statusin e bashkëpunëtorit me drejtësinë. Por prokuroria pretendon se ka prova që vërtetojnë implikimin e grupit. Ish-policin grek besohet se është njeriu që po e priste Devi Kasmin pranë banesës së dytë që pak veta e dinin dhe e ka qëlluar. Pavarësisht kësaj, policia po vijon me mbledhjen e provave që tregojnë se Eftimiu është ekzekutori me pagesë i Devi Kasmit. Armët

e gjetura në bazën e grupit të strukturuar kriminal pjesë e të cilit ishte edhe greku, janë në laboratorin e kriminalistikës ku po kryhen analiza pasi një prej pistoletave të gjetura dyshohet të jetë arma e krimit. Nga hetimet rezultoi se shtetasi grek ka hyrë në Shqipëri afro dy muaj para vrasjes dhe ka jetuar në një shtëpi me qira në zonën e Unazës së rë. Eftimiu dyshohet se është paguar nga Aurel Hoxhallari për të eliminuar Kasmin. Ka dyshime që vrasësi është paguar me një shumë prej 25 mijë eurosh. Burime zyrtare bënë me dije se gjatë arrestimit shtetasi grek i është gjetur një shumë e tillë, që mendohet se ka qenë pazari për vrasjen e Kasmit. Ndërkohë mësohet se banesa e Aurel Hoxhallarit, e cila shërbente si bazë e grupit të strukturuar kriminal është ndërtuar para 6 vitesh në një zonë në periferi të kryeqytetit mes dy kodrave në Mëzez. Banesa në pronësi të Aurel Hoxhallarit ishte tepër e veçuar, në distancë të madhe me ndërtime të tjera dhe ishte e pajisur me disa kamera sigurie. Vendi i ngjarjes dhe tunelet pas banesës dyshohet se shërbenin si bazë për të fshehur armatimet moderne, snajperët e prodhimet të fundit si dhe municionet. Nga jashtë perimetrit të sigurisë duken pasojat e ndërhyrjes së bëftë dhe të shpejtë të policisë, pasi vetratat e dritareve janë të shkatërruara. Ndërkohë brenda saj, policia po punon për gjetjen e provave të reja.



Vendi ku u ekzekutua Devi Kasmit

## ATENTATI

E shkuara e Aurel Hoxhallarit, personi i dyshuar si organizatori i vrasjes së Kasmit

Shtetasi i shpallur në kërkim Altin (Aurel) Hoxhallari, i cili dyshohet se është organizatori i grupit të përfshirë në vrasjen e Devi Kasmit, nuk është një emër i panjohur për policinë. Hoxhallari, është arrestuar edhe më 10 janar të vitit 2015 së bashku me kushërinin e tij Amarildo Hoxhallari, si porosites të dyshuar për atentatin ndaj Pajtim Serjanit, ngjarje e ndodhur më 5 janar 2015 në "Rrugën e Kavajës" në Tiranë. Por Amarildo dhe Aurel Hoxhallari mohuan akuzat dhe kanë deklaruar se policia duhet të mbajë përgjegjësi për të gjetur autorët e vërtetë të krimit. Në seancën me dyer të mbyllura, kushërinjtë Hoxhallari kanë kërkuar lirimin e menjëhershëm pasi, sipas tyre, ata nuk kanë asnjë lidhje me atentatit. Arrestimi i Amarildo dhe Aurel Hoxhallarit u bë më 10 janar, ndërsa fillimisht gjykatat vendosi për ta masën e sigurisë 20 ditë "arrest me burg" për t'i dhënë kohë prokurorisë për të faktuar akuzën. Në atentatin e Rrugës së Kavajës, personi që plagosi Serjanin, Artur Baze, i dyshuar si vrasës me pagesë, mbeti vetë i vrarë, pasi u qëllua nga efektivit Roland Mete. Në datën 1 shkurt 2015, thuhet para 3 vjetësh, Gjykatë e Krimeve të Rënda liroi dy autorët e dyshuar si porosites të atentatit ndaj Pajtim Serjanit. Ata u lanë të lirë për mungesë provash dhe mosvërtetimit akuzash.



Artan Hoxha: Mario Meshini nuk mund të jetë bashkëpunëtor

# Konflikti i grekut me viktimën, Kasmi i vuri pistoletën në kokë para palestrës

*Kamerat e sigurisë zbulojnë ekzekutorin Eftimios*

Ina Allkanjari

Pas ekzekutimit të 41-vjeçarit Devi Kasmi, zbardhen detaje të reja në lidhje me këtë ngjarje. Mësohet se shtetasi grek, i cili ra në pranga pasi dyshohet të jetë ekzekutori i Kasmit, e ndoqi për një kohë të gjatë viktimën për të mësuar rutinën e tij të përditshme. Mendohet se Ethimoi Eftimiu ishte kontraktuar nga grupi kriminal për ta vrasur 41 vjeçarin. Për këtë ai erdhi në dhjetor në Shqipëri ku ka studiuar zonën dhe pikat më të frekuentuara të Devi Kasmit. 3 ditë para ekzekutimit ish-ushtaraku grek Eftimiu është parë të bënte lëvizje të shpeshta pranë palestrës së Kasmit. Kjo është verifikuar falë kamera të sigurisë që viktimë kishte instaluar në gjithë rrugicën ku ndodhesh palestra. Kështu pasi konstatoi lëvizjet e dyshimta të një njeriu me mjekër, mësohet se Devi Kasmi doli jashtë palestrës, e kapi atë nga pas, duke i vënë pistoletën në qafë. Ky i fundit, i përgatitur për gjithçka, nuk reagoi. Vetëm përsëriti disa herë në anglisht "no problem". (Nuk ka asnjë problem). Pasi e kontrolloi për armë dhe nuk konstatoi gjë, Kasmi e la të lirë dhe u largua. Vetëm pak minuta pas kësaj përballje, për arsye që ende s'dihen, greku ishte kthyer sërish në këtë zonë. Kjo ka shtuar më tepër dyshimet e viktimës dhe nga kamerat e sigurisë i ka bërë një foto njeriut që për të u bë tepër i dyshimtë. Kjo foto si edhe dëshmia e Mario Meshinit, dëshmitarit okular në vrasje ndihmoi në identi-



Viktima Devi Kasmi

fikimin e ekzekutorit të vrasjes së Devi Kasmit. Ndërkohë gazetari investigativ, Artan Hoxha ftuar në emisionin "Kjo Javë" në News24, ka dhënë ditën e djeshme detaje të reja në lidhje me atentatin në Tiranë që i mori jetën Dëfrim (Devi) Kasmit. "Greu ka tentuar të njohë vendin, lëvizjet dhe oraret. Por në përpjekje për të njohur terrenin është zbuluar dhe kur Kasmi i ka vënë pistoletën në kokë. Kasmi i ka folur në shqip, greku i është përgjigjur në anglisht. Kasmi i ka bërë kontroll të imtësishtëm, dhe nuk i gjeti armë kur e kapi. E shpëtoi fakti që ai foli në anglisht dhe që nuk kishte armë. Dëfrim Kasmi ka hyrë në palestër e ka dalë, dhe brenda 15 minutave greku është rikthyer në vendin e ngjarjes, dhe kjo i ka shpëtuar Kasmit. Një i huaj që i vihet pistoletë në kokë në një vend si Shqipëria, ai nuk është rikthyer sërish," zbuloi Hoxha. Sakaq është siguruar

video e lëvizjeve të Mario Meshinit, miku i Devi Kasmit që qëndron në burg i akuzuar se e nxori në pritë. Videoja është nxjerrë nga kamerat e sigurisë së një biznesi disa metra larg vendit ku mbeti i vrarë 41-vjeçari dhe tregon Mario Meshinin duke ecur me motor dhe pa skafandër në kokë. Në lidhje me përfshirjen e Meshinit në vrasje, Artan Hoxha hedh poshtë zërat që ai mund të jetë bashkëpunëtor. "Nga pamjet shikojmë që është larguar me motorin e vetë, pa skafandër. Lëvizja ka qenë nga vendi i ngjarjes në banesën e tij. Pra, për 4 minuta nga vendi i ngjarjes ka shkuar në banesë. Takimi është lënë se Mario Meshini e ka telefonuar. Devi Kasmi ka ardhur menjë "Golf" në vendngjarje. Njiheshin prej 7 muajsh, janë lidhur me shumë në palestër. Njerëz që e kanë njohur të thonë se ai s'të linte kurrë vend të saktë takimi dhe iu besonte pak njerëzve", tha Hoxha.

**NGJARJA**

**Celulari i viktimës, Artan Hoxha: Policia ka gjetur kontakte me rëndësi**

**TIRANË**- Dyshime, pikëpyetje dhe ende shumë detaje të pazbardhura kanë mbetur pas vrasjes së Devi Kasmit. Gazetari investigativ Artan Hoxha i ftuar në studion e emisionit "Kjo Javë" në News 24 tha se Devi (Dëfrim) Kasmi kishte një vit që ishte kthyer në Shqipëri dhe kishte hapur një palestër; të cilën e survejonte me kamera sigurie. Hoxha thotë se është pamundur që Mario Meshini të jetë bashkëpunëtor në vrasje, sepse prova e parë që do kishte zhdukur nga vendngjarja do ishte celulari i Kasmit, brenda të cilit janë gjetur "thesare" siç u shpreh Hoxha. "Nëse do ishte pjesë e grupit Mario do i merrte celularin. Policia ka gjetur aty kontakte shumë të rëndësishme, madje edhe numra të oficerëve të policisë së shtetit dhe personazhe të gjyqësorit. Mund të them se edhe një emër i njohur në kryeqytet i arrestuar për implikim në droga të forta është kapur pikërisht nga të dhënat në celularin e Devi Kasmit", u shpreh Hoxha. E sa për Konjarin e armiqësitë e vjetra me të, Hoxha shton se Devi Kasmi e dinte që ai nuk ndodhesh në Shqipëri, e për këtë kishte ulur edhe vigjilencën.

**MARIO MESHINI**

25-vjeçari, Mario Meshini personi i parë i shoqëruar në polici pas vrasjes së Devi Kasmit, mësohet të ketë qenë mik i ngushtë me viktimën Devi Kasmin dhe në momentin e vrasjes ai do të takohet me të. "E vërteta është se Mario Meshini njoftoi menjëherë bashkëshorten e Kasmit. Policia e akuzon pse ka lëvizur nga vendi i ngjarjes, pse nuk ka shkuar në polici, autori i ka drejtuar pistoletën, dhe kur iu drejtua armën ka ngritur duart lart. Ai ka patur ditëlindjen e të dashurës së vet, dhe rreth 1 orë pas ngjarjes, ka shkuar te e dashura e tij. Dhe të afërt të tij, e kanë çuar sërish në banesë sepse kishin frikë se nuk dinin kush ishte autori," tha gazetari Hoxha.

**BANESA E AUREL HOXHALLARIT**

Banesa e Aurel Hoxhallarit, e cila shërbente si bazë e grupit të strukturuar kriminal që ekzekutoi Devi Kasmin, dhe pas tre ditësh vijon të jetë e rrethuar nga policia. E ndërtuar para 6 vitesh në një zonë në periferi të kryeqytetit mes dy kodrave në Mëzëz, banesa në pronësi të Aurel Hoxhallarit ishte tepër e vecuar, në distancë të madhe me ndërtime të tjera dhe ishte e pajisur me disa kamera sigurie. Vendi i ngjarjes dhe tunelet pas banesës shërbenin si bazë për të e fshehur armatimet moderne, snajperat e prodhimet të fundit si dhe municionet.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dt 05.02.2018 ora 16:00  
Përfundon Ankandi i Tretë për pasurinë:  
"Pasuria "Apartament" me sip. 55 m2, Nr. pasurie 212/15-1-5, Z. K 2140, Vol. 2, Fq. 33, me adresë Kërçukal (Gosë), Kavajë. Me çmim 1 247 400 Lekë

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Biv.kryesor (ish kinma iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

# PAKTI ME GREQINE REAGIMET

“Për të bërë negociata duhet një ekip me miratimin e Presidentit”

## 12 milje det dhënë Greqisë? Pashaj: Të drejtat i kanë të dyja palët

“Deklaratat e Kotzias krijuan tymnajë e mjegulli”

Myslim Pashaj, një hur ndryshe si “koloneli i detit”, ish-drejtori i Institutit të Topografisë Ushtarake të Shqipërisë shpjegoi dje, me detaje pikat, ku qeveria shqiptare duhet të ketë kujdes në marrëveshjen e dytë me Greqinë për kufirin detar. Në një lidhje direkte në emisionin “Kjo Javë” me Nisida Tufën, në News 24 profesor Pashaj u shpreh se marrëveshja e parë, ajo e 2009 është zeruar nga Gjykata Kushtetuese. “Ne vetë shqiptarët kemi krijuar një problem me Greqinë. Bëmë një marrëveshje që në teorinë diplomatike ishin të dy palët që luftuan në bazë të të drejtës kombëtare. Unë mendoj se pala greke nuk ka ndikuar. Pala greke ka dhënë mendimin e saj, por humbi luftën. Luftën e humbi shteti shqiptar, ky është një problem që krijuam ne”, -u shpreh Pashaj. “Çfarë tymnajë dhe mjegullie është krijuar vetëm nga një frazë që ka thënë Kotzias!? Ka një moskuptim që është i habitshëm jo vetëm nga njerëzit e zakonshëm, por edhe nga drejtues emisionesh të rëndësishme. Duhet shpjeguar para opinionit termat. Është bërë një punë goxha e madhe që ne të ulemi në tavolinë jo për negociata, por të bëjmë një përaftrim për të bërë negociata, sepse për të bërë negociata duhet një ekip me miratimin e Presidentit”, tha ai. Myslim Pashaj, gjithsesi kritikoi faktin që institucionet shqiptare nuk duhet të ishin treguar kaq hermetike, por duhet të kishin sqaruar opinionin publik. Sipas tij, “kjo është punë e tyre. Ministri i Jashtëm grek nuk ka folur për shtrirjen e hapësirave deri në 12 milje, por ia ka dhënë e drejta detare për të folur për to. Opinioni shqiptar duhet të kuptojë që bëhet fjalë për det territorial, që janë si hapësira tokë-



**PROBLEMI**  
“Sikur ju të merrni një kompas ta vendosim në pikën e mesit, do prekte Otranto, në krahun tjetër Karaburunin, dhe në palën greke Othonoi. Kjo është zgjidhja më e keqe. Këtu shteti shqiptar u dëmtua në një hapësirë mbi 220 km katror. Kjo është nyja gordiane”, tha Pashaj.

### LUAN HAJDARAGA

“Këtë takim disa ditore, në Kretë e Korçë, pritet ta kthejmë me një marrëveshje të definuar. Në metodologjinë e marrëveshjeve, negociatat i paraprijnë marrëveshjes. Është pranuar nga pala greke që marrëveshja e detit të diskutohet nga e para. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, përbëjnë një bazë solide për një bisedim serioz”, -u shpreh Hajdaraga, në News 24.



sore. Edhe 12 milje detare janë njësoj si tokësore. Të drejtat i kanë të dyja palët. Problemi është për hapësirat ekonomike ekskluzive. Ne kemi hapësirë vetëm ngushticën e Otrantos. Sikur ju të merrni një kompas ta vendosim në pikën e mesit, do prekte Otranto, në krahun

### Ish-anëtari i Kushtetueses

## Sokol Sadushi: Pakti i parë për detin, nuk na bleu askush

I ftuar në emisionin “JAVA” në RTSH, ish-anëtari i Gjykatës Kushtetuese dhe aktualisht Drejtori i Shkolles së Magjistraturës, Sokol Sadushi, ka shpjeguar më në detaje arsyet e rrëzimit të marrëveshjes së ish-qeverisë “Berisha” me Greqinë për detin, në kontekstin e polemikave që po zhvillohen këto ditë për marrëveshjen e re. Ai i është përgjigjur pyetjes së analistit dhe gazetarit Loren Vangjeli në lidhje me akuzat e ish-krumbarit Berisha për blerjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga palë të treta. “Jo, e them me përgjegjësi të plotë jo vetëm për vete, por të gjithë trupën e Gjykatës Kushtetuese që rrëzoi atë marrëveshje”, tha Sadushi. “Vendimi i Gjykatës Kushtetuese”-u shpreh ai “është një pikë referimi për çdo negociatë tjetër për një marrëveshje të re me palën greke” deklaroi Sadushi, duke shtuar se “në këtë kontest, çdo marrëveshje e re do të jetë më e mirë se ajo e vitit 2009”

tjetër Karaburunin, dhe në palën greke Othonoi. Kjo është zgjidhja më e keqe. Këtu shteti shqiptar u dëmtua në një hapësirë mbi 220 km katror. Kjo është nyja gordiane”, tha Pashaj. Ai tha se duhet marrë shembull zgjidhja që është bërë me Italianë. “Kryeministri tha që nuk do vendoset më në Barketa. Kjo është një gjë shumë e madhe. Dhe të dy palët në mënyrë paqësore do ulen për të bërë një gjë të mirë. Barketa sikur ta ketë dhënë Zoti është vendosur mu në qendër të kanalit të Korfuzit vetëm 32 m në drejtim të Shqipërisë”,-tha Pashaj.



Gjatë një seance parlamentare

### TUBIMI

## Dhjetëra qytetarë protestojnë para Kryeministrit për marrëveshjen e detit

Dhjetëra qytetarë janë mbledhur përpara goditës së Kryeministrit për të protestuar kundër marrëveshjes së detit me Greqinë. Me flamuj kombëtarë dhe harta të Shqipërisë etnike, protestuesit kënduan himnin kombëtar përpara Kryeministrit. Protesta është organizuar nga shoqëria civile. Megjithatë ende nuk ka një draft përfundimtar të marrëveshjes, deklarata e ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias se hapësira detare greke zgjerohet me 12 milje shkaktoi një furi reagimesh në vendin tonë. Protestuesit i bënë thirrje kryeministrit që të jepte sqarime, ndërsa kërkuan nga profesionistët që të japin një zgjidhje ligjore për këtë çështje. “Këta po na marrin dinjitetin, këta po na marrin shtetin. Dua më transparencë në lidhje me këtë marrëveshje”,-u shpreh Aulon Kalaja. Një tjetër protestues tha: “Protestojmë kundër tradhtisë së politikaneve shqiptarë”. Një tjetër i pranishëm, i ardhur nga Vlora tha se protestonte për tokat kanë dhe për të mos marrë asnjë asnjë metër nga pronat e tyre në Greqi. Disa prej protestuesve u shpërngulën para ambasadës italiane në Tiranë për të kërkuar që edhe Italia të bëhet pjesë e procesit të kërkimit të eshtrave të ushtarëve grekë të rënë në luftën italo-greke në territorin shqiptar. Ata kërkuan që të ngrihen monumente për të nderuar të tri palët që luftuan dhe jo vetëm grekët. Protesta u mbyll qetësisht pas asnjë incidenti.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përmbarrimore “Best 2010”

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 12 shkurt 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 leks ju zyrë përmbarrimore do zhvillohet ankandit i I re për shpëtimin e tre apartamente në ndodhur në L.TJ, ZK 8518, Fshat, Durres e konkretisht pasurisë nr 5854/vet 17, fq 2-5856/fq 3-5857, fq 4. Cila trashit ka sipërfaqen prej 450 m<sup>2</sup> dhe më të rëndësishme marrëveshje siparimje.

Cmimi fillues me të cilin fillon ankandit do të jetë:

1) për pasurinë 5854 është 57000 Euro 2) për pasurinë 5856 është 57000 Euro 3) për pasurinë 5857 është 19889 Euro.

P.s: Qytetarët/sqaruesit që deshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillues si garancë për pjesëmarrje në ankand. Kjo garancë pasurisë duhet të jetë e dëruar në 98% të shprehjes Samir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA).

Adresa: L. 2, rrapi Plokarorisë së Rrethit Durres, tel/fax: 052-22-6000

E-mail: best.2010@permbarrim.com, web: www.permbarrim.com

**PERMBARRUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ**

\*Permbarruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e treta për shpëtimin e pasurisë se paluajtshme 7% pjesë ideale takuese e debitorit Hysen Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme e llojit apartament, me numer pasurie 4/89+1-3, Volumi 11, Faqe 23 ne Zonen Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe prej 78.94 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne Tirane, Adresa: Rr:Qemal Stafa, Shkalla 1, Katil 2, Ap.3”, per shpëtimin e detyrimit me favor te kreditori Rafik Copeli, per shumen 10'400 Usd dhe 165'992 leke. Cmimi me të cilin fillon ankandit treta është ne vleren 932'478.78 (nenteqind e tridhjetete e dy mijë e katerqind e shtatëdhjetete e teze pike shtatëdhjetete e teze) leke.

Ankandit treta zhvillohet ne date 14.02.2018, ora 16.00 ne zyrën e përmbarruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga “Abdi Toptani”, Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email : ermirgodaj@zyrapermbarrim.com.\*

**PERMBARRUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ**

Permbarruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e dyte per shpëtimin e pasurisë se paluajtshme “Tinasil”, me Nr.Pasurie 7/91, Volumi 14, faqe 97, Zona Kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 186.70 m<sup>2</sup>, nga e cila ndërtesa me sip. 62.70 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne Rr. “Haxhi Sina”, Tirane, per shpëtimin e detyrimit ne favor te kreditorëve Shasime Mera, Ajel Dema, Lirim Kasirati, per shumat 90'144 (nenteqindhjetete mijë e njeqind e dyzete e kater)Euro dhe 880'015 (tezeqind e teze dhjetete mijë e pesëmbdhjetete)leke.

Cmimi fillues me të cilin fillon ankandit është ne shumen 67'200 (gjashtëdhjetete e shtate mijë e dyqind)Euro.

Ankandit zhvillohet ne date 12.02.2018, ora 16.00 ne zyrën e përmbarruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga “Abdi Toptani”, qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrapermbarrim.com.



Kryetari i "Ligjeve": Nëse nuk duan kryeprokuroren, të votojnë KLP

# Të hënën hidhen goglat e fundit për KLP e KLGJ, Manja: Të vijë opozita

10 kandidatët quhen automatikisht të votuar nga Kuvendi

Darina Tanushi

Të hënën pritet të hidhen goglat e fundit për emrat që do të përbëjnë dy institucionet e rëndësishme të drejtësisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Maxhoranca e opozita nuk arritën të gjejnë konsensus në të dy raundet e para, duke mos bërë dot 94 votat për miratimin e listës së kandidatëve. Kështu të hënën është hera e tretë që do të hidhen goglat për të përzgjedhur sërish 10 kandidatët, por këta quhen të miratuar automatikisht në seancën e së enjtes që vjen, në bazë të ligjit. Me këtë votim parlamenti realizon pjesën e tij të përgjegjësisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë 18 muaj pas miratimit të reformës në drejtësi, por dy Këshillat ende nuk mund të ngrihen pasi kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit e prokurorisë duhet t'i nënshtrohen vetingut. Ky proces tashmë ka nisur, por nuk ka ende një datë se kur mund të mbyllet për 31 njerëzit e drejtësisë që garojnë për këto institucione. Ndërkohë dje, duke iu përgjigjur edhe akuzave të opozitës, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja shtoi: "Nuk është Kuvendi që ka zgjedhur kandidatët, për KLGJ dhe KLP, por janë trupat respektive, dhe kandidatët që kanë plotësuar kushtet, kanë kaluar në disa filtra në tryezën e nënkomisjonit ad hoc, që do të bëjë përzgjedhjen në Kuvend". Ndërkohë me krijimin e KLP i mbaron mandati edhe kryeprokurores së përkohshme Arta Marku, për t'i hapur rrugën një kryeprokurorit të zgjedhur nga KLP sipas ligjit. Në një intervistë për ERTV-në, Ulsi Manja, kryetari i Komisionit të Ligjeve, i pyetur për propozimin e amendamentit të opozitës për ndryshime kushtetuese, lidhur me zgjedhjen e prokurorit të ri të përkohshëm, Manja u shpreh se "Këtë çështje e zgjidh 'Kushtetuta dhe ligji. Është e qartë situata, sepse amendamenti i opozitës për rishikimin e Kushtetutës, në thelb synon zhbërjen e reformës në drejtësi dhe kthimin e reformës në vitin 2016". Për sa i përket zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm, sipas opozitës në mënyrë antikushtetuese, Manja shprehet se Prokurorja e Përgjithshme është zgjedhur në përpunje me



Kushtetutën dhe ligjin për organizimin e prokurorisë. "Opozita nëse do të kishte pretendime se ligji është antikushtetues, ka pasur gjithë mundësitë dhe kohën për ta atakuar këtë ligj në Gjykatën

Kushtetuese, ashtu siç bëri me ligjin e vetingut. Dhe nuk e ka atakuar dhe derisa ligji nuk është i atakuar, mbetet në fuqi dhe kjo shumicë parlamentare ka detyrimin Kushtetues për të zbatuar

ligjin", tha Manja. Me tej, Manja shtoi se "Ligji shprehet qartë, nëse mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron dhe nuk është zgjedhur akoma KLP për të bërë zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm me mandati të plotë Kushtetues, caktohet njëri nga prokurorët në detyrë. Vendimi i Kuvendit thotë; caktimin e prokurores Arta Marku, si Prokurore e Përgjithshme, dhe këtë ka bërë Kuvendi". Po ashtu, Manja pohon se, nëse ka shqetësimin opozita që Prokurori Përgjithshëm të mos jetë në detyrë, hajde ngrëmë KLP. "Pastaj a duhet të kalojë vetingun, Prokurori i Përgjithshëm, e ka përcaktuar ligji, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe kandidatët për këshillat respektive, i nënshtrohen vetingut".

**"PESHQIT E MËDHENJ"**

I pyetur në lidhje me deklaratën e ambasadori Lu për "peshqit e mëdhenj", Manja tha: "Peshqit e mëdhenj" nuk kapen me fushata". "Do të ketë edhe rezultate konkrete, sepse reforma në drejtësi e garanton këtë me ngritjen e institucioneve të reja si KLGJ dhe KLP dhe institucione të tjera si SPK dhe BKH", tha Manja.



Deputeti i PD: Reforma në drejtësi, një kaos total

## Bylykbashi: Shqiptarët dhe të drejtat e tyre sot janë në udhëkryq

Nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, demokrti, Oerd Bylykbashi u shpreh dje, se reforma në drejtësi është në një rrëmujë. Në një analizë të tij, në rrjetin social, "FB", Bylykbashi shprehet: "Sot është rrëmujë, rrumpallë e kaos total. Koncepti i shtetit të së drejtës është zëvendësuar me shtetin që nuk bazohet në Kushtetutë, por në memo e memorandum bashkëpunimi. Koha do të sjellë nevojën për konsolidimin e sistemit dhe zhbërjen e fragmentimit të sistemit të drejtësisë dhe forcimin e pavarësisë së saj". Sipas tij, "një reformë kushtetuese e vërtetë do sillte drejtësi efikase, të shpejtë, profesionale dhe të pakorrruptuar. Sot, kjo rrëmujë në drejtësi e quajtur reformë, as që e siguron këtë. Shqiptarët dhe të drejtat e tyre sot janë në udhëkryq. Ajo lloj drejtësie që duan shqiptarët nuk ka ndodhur ende..." Duke bërë paralelizëm me mesjetën, Bylykbashi shkruan se "Perandoria Romake u fragmentua në dhjetëra mbretëri, principata e konte, ku çdo lord barbar vriste kë t'i dilte përpara që të merrte pushtet. Aty filloi Mesjeta, periudha më e errët e njerëzimit. Sistemi i drejtësisë u fragmentua në një duzinë institucioneve që as profesionistët nuk ua mbajnë mend emrat: KLGJ, KLP, GjK, GjL, ILD, KED, PP, PPP, SPAK, SPAK i përkohshëm, BKH, KPK, KA, KP. Aty filloi mesjeta e drejtësisë ku askush nuk di ç'bëhet, ç'bën tjetri, ku të kërkohet të drejtat, a do t'i marrë të drejtat, kur do t'i marrë ato...", shkroi dje, Bylykbashi. Sipas tij, "reforma solli vetingun, që pritet të qerrojë shumë gjyqtare e prokurorë që të korrupuar siç janë, nuk kanë lidhjet e duhura me pushtetin dhe ata që nuk janë në përpunje me doktrinën e kryeministrit. Por të korrupuarit ustallare do t'i gjejnë flijet me pushtetin dhe do të shpëtojnë pa u prekur nga vetingut. Të tjerë, ndoshta jo më pak të korrupuar, do të futen nga radhët e avokatisë dhe shoqërisë civile?".

## Terrorizmi, droga e krimi, Xhafaj firmos marrëveshje me Maqedoninë

Lufta kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe kriminalitetit kanë qenë pjesë e një marrëveshje bashkëpunimi nënshkruar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë respektivisht nga ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, dhe homologu i tij, Oliver Spasovski, në Ohër. Dy ministrat janë dakortësuar dhe për ngritjen e pikave të përbashkëta kufitare ndër-

mjet Shqipërisë dhe Maqedonisë, pika të cilat do të jenë në Qaf Thanë, Tushemisht dhe Trebisht. Pas takimit, në konferencë për mediat, ministri Xhafaj u shpreh: "Unë besoj se çështjet që diskutuam për luftën kundër terrorizmit dhe luftën kundër krimit të organizuar, kontribuojnë për

qetësinë dhe sigurinë në dy vendet tona, por kontribuojnë për qetësinë dhe sigurinë edhe në rajon. Po ashtu iniciativat ku ne bashkëpunojmë deri më sot apo iniciativat e reja që dëshirojmë të zhvillojmë më tej i shërbejnë miqësisë ndërmjet dy vendeve por edhe të ardhmes së rajonit".

**EPSPA** SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

- 1- Apartament** me nr.5/131+1-20, Zk.8532, vol.12, fq.60, me sip.98 m2 e ndodhur ne Lgj."Konferenca e Pezës", Sh.1, K.3, Ap.20, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 3,920,000 (tre milion e nëntëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 2- Njesi** me nr.4/122+1-N, Zk.8533, vol.11, fq.188, me sip.40 m2 e ndodhur ne Lgj."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 4,000,000 (katër milion) Lekë.
- 3- Truall** me nr.52/34, Zk.3981, vol.9, fq.192 me sip.3020 m2 e ndodhur ne Sheq, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) Lekë.
- 4- Truall + ndërtesë** me nr.52/44, vol.12, fq.132, Zk.3981, me sip.truallit 6134 m2 dhe me sip.ndërtese 2160.2 m2 e ndodhur në Fshatin Sheq i Madh, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 59,440,000 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) Lekë.
- 5- Godinë** me nr.3/166, vol.11, fq.242, me sip.totale 290.6 m2, Zk.8534 me vendodhje në Rr."Apollon", Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 51,064,000 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.
- 6- Truall** me nr.108/35, Zk.1791, vol.10, fq.248, me sip.500 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 7- Truall** me nr.108/36, Zk.1791, vol.10, fq.249, me sip.2000 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 10,400,000 (dhjetë milion e katërqind mijë) Lekë.

**Ankandi per shitjen e te gjitha pasurive te sipërcaktuara do te zhvillohet ne date 13.02.2018, ora 16.00 ne seline e shoqerise EPSA SHPK ne adresen Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.**

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

## SITUATA POLITIKE REAGIMET

### Kryetarja e LSI ashpëson tonet ndaj prokurorëve

## Kryemadhi: Do flasim për prokurorë që iu mbyllen dosjet te Krimet e Rënda

Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi, ka ashpërsuar tonet kundër prokurorëve, ajo ka kërcënuar se do t'u publikojë të gjitha dosjet korruptive. Ajo u shpreh për Tema TV, se sistemi i drejtësisë duhet të funksionojë pa ndikim dhe se tani ka ardhur koha që të mos ketë më heshtje për anëtarët e drejtësisë. "Ska më tani, tani do fillojmë të flasim dhe ne, për prokurorë, të cilëve iu mbyllen dosjet tek Krimet e Rënda, për prokurorë që janë të implikuar në përgjime me grupe kriminale dhe trafikantë droge, për prokurorë që kanë bërë allshverishe për deklarimin e pasurisë, për



Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi

prokurorë që kanë mbajtur çështje të hapura duke bërë shantazh ndaj individëve të institucioneve të shtetit", deklaroi Kryemadhi. Lidhur

me arrestimin e ish-kreut të ARRSH-së Dashamir Xhika, Kryemadhi tha se ai është arrestim politik. "Dashamir Xhika është arrestim poli-

tik, monstroz, i cili nuk do të ngelet këtu, por do të kthehet mbrapsht, sepse nuk mund të arrestosh një drejtor për një tender që nuk e ka kryer ai. Një tender që është bërë në 2008, ndërsa Xhika është bërë drejtor në 2013. Ky është një shantazh nga prokuroria e Elbasanit për përfitime personale të personave të lidhur me prokurorin", tha Kryemadhi. "Po të kishte Dashamir Xhika edhe një shkelje të ligjit, i pari që do ta arrestonte do ishte Saimir Tahiri me Edi Ramën", tha ajo.



Homazhet për 1-vjetorin e Agollit

Përgatitja për zgjedhjet vendore 2019, kryesocialisti bën lëvizje në PS-në e Tiranës

# Rama: Nëse hyjmë tani në zgjedhje, rrezikojmë

"Niveli i investimeve nuk përputhet me numrin e votave"

Kryesocialisti, njëherësh edhe kryeministër i vendit, Edi Rama është detyruar të bëjë ndryshime në radhët e të deleguarve nëpër zona të caktuara të kryeqytetit. Pas largimit të Saimir Tahirit nga PS dhe zëvendësimit të tij në detyrën e drejtuesit politik të Tiranës me Blerina Gjylametin, Rama, nisur edhe nga sondazhe të brendshme ka menduar të bëjë një riorganizim për të nisur vullshëm punën për përgatitjen e partisë për zgjedhjet vendore të 2019. Edi Rama ka caktuar Ulsi Manjën si deputet përgjegjës për njësinë 11, teksa deri më tani ka mbuluar zonën e Paskuqanit, bën me dije Report TV. Rakip Suli largohet nga Lapraja dhe i caktohet të mbulojë Bashkinë Kamëz. Klotilda Ferhata do të mbulojë njësinë 3 në vendin e lënë bosh nga Olta Xhaçka, pasi kjo e fundit është caktuar drejtuese politike e qarkut Dibër. Sadri Abazi ikën nga Kamza dhe shkon si përgjegjës tek nj.4 në vend të Blerina Gjylametit, e cila prej kohësh është në krye të PS-së së Tiranës, detyrë që iu ngarkua pas pezullimit të Saimir Tahirit. Kryeministri Rama ka marrë pjesë vetë në të gjitha takimet me njësitë e Tiranës ku janë prezantuar të deleguarit e rinj. Burime brenda partisë socialiste bëjnë me dije se këto lëvizje



Grupi Parlamentar i PS-së

### LËVIZJET NË PS

- **Ulsi Manja** ikën nga Paskuqani, shkon përgjegjës për njësinë 11
- **Rakip Suli** largohet nga Lapraja dhe i caktohet të mbulojë Bashkinë Kamëz
- **Klotilda Ferhata** do të mbulojë njësinë 3 në vend të Olta Xhaçkës
- **Olta Xhaçka** u delegua në Dibër
- **Sadri Abazi** ikën nga Kamza dhe shkon si përgjegjës tek nj.4 në vend të Blerina Gjylametit
- **Blerina Gjylameti** u zgjodh në krye të PS-së së Tiranës

vijnë pas shqetësimit të shprehur nga kryesocialisti Rama në mbledhjen më të fundit të kryesisë së partisë. Të njëjtat burime saktësojnë

se kryeministri është i pakënaqur me organizimin e strukturave, përfshirë edhe Tiranën, ku ka thënë se niveli i investimeve nuk përputhet

### ZGJEDHJET

Zgjedhjet vendore të 2019 janë një test shumë i rëndësishëm për PS-së, pasi sipas të gjitha gjasave ajo do të jetë e vetme në garë, pa koalicion, gjë që nuk e favorizon ashtu siç ndodhi në zgjedhjet e 2017-tës. Nëse PD do zgjedhë të hyjë në koalicion përballë një PS-je të vetme, kjo e dëmton rezultatit e socialistëve, të cilët mund të rrezikojnë shumicën në këshillat bashkiake.

me votat. Duke ju referuar zgjedhjeve të ardhshme të vitit 2019, kreu i PS-së Edi Rama mësohet të ketë thënë në kryesi se "Nëse PS hyn tani në zgjedhje, me këtë nivel organizativ, rrezikon të fitojë ose të humbasë për 10 vota, siç ndodhi në vitin në 2011 në Tiranë", ndaj ka kërkuar mobilizim total të strukturave. Zgjedhjet vendore të 2019 janë një test shumë i rëndësishëm për PS-së, pasi sipas të gjitha gjasave ajo do të jetë e vetme në garë, pa koalicion, gjë që nuk e favorizon ashtu siç ndodhi në zgjedhjet e 2017-tës, kur doli e vetme pa LSI-në e partitë që ka pasur gjithnjë si aleatë. Nëse PD do zgjedhë të hyjë në koalicion përballë

## Majko me diasporën në SHBA: Të gatshëm të sigurojmë librat shqip

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, nisi të shtunën një vizitë disa ditore në SHBA. Ndaleshën e parë e bëri në Miçigan, ku edhe jeton një numër i madh shtetasish shqiptarë. Majko, i shoqëruar nga ambasadorja e Shqipërisë në SHBA, znj. Floreta Faber, Konsulli i Nderit, z. Ekrem Bardha dhe përfaqësues të tjerë të diasporës atje, vizitoi qendrat fetare të komunitetit shqiptar në Rochester Hills. Më pas, ministri i Shtetit për Diasporën vizitoi Teqen e Baba Rexhepit, e para Teqe Bektashiane e hapur në SHBA. Në fokus të diskutimeve ishte ruajtja e gjuhës shqipe tek brezat e rinj. Z. Majko shprehu gatishmërinë për t'u angazhuar për sigurimin e librave të gjuhës shqipe për shqiptarët atje dhe regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit.



një PS-je të vetme, kjo e dëmton rezultatit e socialistëve, të cilët mund të rrezikojnë shumicën në këshillat bashkiake. Ndaj, duket se edhe pse

shumë muaj para fushatës, gati një vit e ca më herët, kryetari i PS-së, Edi Rama po përgatit situatën për të mos i lënë këto për muajt e fundit.



Epitafi për veten, mbi varr: "Më tepër mund të bënte, por s'e lanë"

# Viti i parë pa Dritëroin, Sadija: Ai më jep forcë dhe kurajë për jetën

*Dokle: Nano, Berisha, Rama do harrohen, Dritëroi jo*

Darina Tanushi

**M**e një cigare, ulur pranë varrit të tij, Sadija Agolli ka përcjellë dje, miq, bashkëpunëtorë e të afërm të Dritëro Agollit në 1-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Në varrezat e Tufinës, është krijuar një kënd i veçantë për shkrimtarin. Aty ka një bust, vendprehen të rrethuar me pemë e lule si dhe dy stola betoni, në mënyrë që ata që ta vizitojnë t'i shkëmbejnë dy fjalë, ashtu siç, në fakt, ndodhte sa herë që shkoje për vizitë në shtëpinë e tij. Në njërin prej stolave dje, qëndronte bashkëshortja Sadija, me një cigare në dorë, zakon, të cilin ja ka "vjedhur" të shoqit prej kohësh. Ka qenë një vit tepër i vështirë. Netët kanë qenë të pagjuma për Sadijen, ashtu siç ajo u shpreh dje. "Ai ka qenë gjithnjë afër gjatë gjithë këtyre kohëve, sepse kam vuajtur nga pagjumësia kështu që ditë dhe natë ka qenë bashkë me mua. Falënderoj të gjithë njerëzit që e kanë dashur dhe e duan Dritëroin përsëri!", tha ajo, ndërsa ka pritur fillimisht në shtëpinë e saj, që vazhdon ta mbajë hapur si zakonisht edhe kur ishte gjallë Dritëroi. Mbresa e tij, Ana nuk i ka ndalur lotët as dje, për gjyshin e saj. Homazhet në nderim të shkrimtarit të njohur kanë mbledhur në varrezat e Tufinës njerëz të penës, mes të cilëve ishte edhe studiuesi dhe mikun e familjes Agolli, Moikom Zeqo. "Është një vend, i cili nuk do të zihet nga askush, në të gjitha ceremonitë që mund të bëhen edhe për njerëz të tjerë, ky është vendi i Dritëroit. Ky vendi këtu që është dhe përmendorja dhe varri i tij që pushon Dritëroi, të jenë të bindur se do të jetë një vend pelegrinazhi", u shpreh ndër të tjera Zeqo.

**AKTIVITETI**

Më pas, familja kishte organizuar edhe drekën e rastit për miqtë, në hotel "Tirana", ku veç njerëzve të letrave e gazetarisë morën pjesë edhe politikanë. Aty u bënë bashkë të vjetrit e PS-së që nga Sabit Brokaj, Namik Dokle, Arta Dade. I pranishëm ishte edhe kreu i bashkisë së Tiarnës, Erjon Veliaj. "Pas 100 vjetësh në një gjimnaz, nëse do të ketë gjimnaze atëherë në Tiranë, mësuësja do t'iu bëjë pyetje nxënësve: Dini gjë kush ka



Ceremonia përkujtimore për 1-vjetorin e Agollit



Namik Dokle

**EPITAFI**

Mbi varrin e shkrimtarin, ishte shkruar pikërisht ajo çfarë ai ia amanet, ajo që shkroi për veten e tij: Përfjetësisht, këtu fle Dritëroi Me etërit, gjyshërit dhe shokët pranë. Të mira bëri pak gjersa jetoj, Më tepër mund të bënte, por s'e lanë. Janë këto radhë, të cilat ai i ka shkruar në të gjallë, për veten e tij dhe që familjarët ia kanë gdhendur mbi pllakën e mermertë.

Bektashinjtë dhe Unioni i Gazetarëve për kontributin e dhënë në vite në publicistikë, gazetarë në të përditshmen "Zëri i popullit", dhe për shum "Vjet ka qenë Kryetar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

**INTERVISTA**

Në një intervistë për TCH, pas ceremonive përkujtimore, Sadija Agolli rrefeu disa çaste të jetës së saj me Dritëroin.

**Si ishte të bashkëjetonte një shkodrane me një devolli?**

Në fillim çdo çift e ka të vështirë të bashkëjetojë me njëri-tjetrin. Derisa të mësohen me njëri tjetrin. Sigurisht është dashuria ajo, më madhja që nuk i ve re veset e njëri-tjetrit. Por më vonë ka vështirësi, se secili kishte trashëgari nga krahina e vet. Por gjithmonë jemi munduar ti zbusim gjërat. Unë bile edhe kam shkruar këtë.

**Si e keni pritur idenë e shndërrimit të shtëpisë suaj në muze në të ardhmen?**

Do të vazhdoj të qëndroj deri në fund. Unë e kam të prerë. Nuk ka diskutim ky vendim i imi. Kur të vdes unë, atëherë le të bëjnë fëmijët çfarë të duan. Por tani për tani unë ja kam kushtuar jetën atij dhe aty do ta mbyll jetën time.

**Çfarë keni për t'i thënë Dritëroit në këtë ditë. Është pak furtunë. Fryn era për të xhamave dhe mbasa ai është duke na dëgjuar.**

Të gjitha mendoj që i ka dëgjuar. Se unë nuk mendoj që ka vdekur. Akoma nuk e besoj. Ndofta më vonë mund të them. Por tani për tani, mendoj që ai më ka dëgjuar dhe ai më jep forcën dhe kurajën sot që jam ulur bashkë me ju.

**ERION VELIAJ**

"Do të doja që secili në Tiranë, që ka një kujtim dhe dëshirë për të shprehur dashurinë, mund të vijë të mbjellë lule, një pemë dhe të japë diçka mbrapsht nga ajo kulturë e madhe që morëm nga Dritëroi", -tha Veliaj, duke shtuar se është misioni ynë që t'ia kalojmë stafetën e veprës së Dritëroit një gjeneratë të re.



**Veliaj: Duam të jetë një vend meditimi**

*Mbillen 20 selvi në parkun e liqenit, Do të krijohet kopshti "Dritëro Agolli"*

**N**ë Parkun e Liqenit të Tiranës do të jetë një kopsht i veçantë me selvi, kushtuar shkrimtarit të madh shqiptar, Dritëro Agolli, i cili u nda nga jeta pikërisht një vit më parë, në 3 shkurt 2017. Në përvjetorin e parë të ndarjes së tij nga jeta, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Shoqatën "Devolli" dhe të afërm të poetit e shkrimtarit, mbollën 20 selvi, duke shënjuar nisjen e punimeve për kopshtin e letrarit të shquar të kulturës kombëtare shqiptare, një moment kujtëse dhe nderimi për kolosin e letrave shqipe. Në mbjelljen e pemëve të llojit selvi ishte edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili vlerësoi figurën e Dritëroit, si njeriu që arriti të bëjë bashkë dashamirës nga çdo cep i Shqipërisë. "Sot e fillojmë me një gjest simbolik, mbjelljen e 20 selvive në një pjesë të parkut të liqenit që ia kemi kushtuar Dritëroit. Duam që të jetë një vend meditimi, pushimi, një vend paqeje, një vend ku njerëzit të lexojnë libra dhe të kujtojnë veprën e Dritëroit. Ndaj kemi përgatitur që në këtë pjesë memoriale të parkut, ku janë disa prej figurave të shquara, të kemi një vend të posaçëm për të kujtuar Dritëroin. Fuqia që tui duket edhe në faktin që arrin të na mbledhë nga çdo cep i Shqipërisë", deklaroi Veliaj. Bashkia e Tiranës parashikon që në këtë pjesë të parkut të vendoset edhe busti i shkrimtarit, që së bashku me pemët e selvisë që u mbollën sot, do të krijojnë kopshtin e Dritëro Agollit. Kryebashkiaku Veliaj ftoi qytetarët që kontribuojnë duke dhuruar një pemë për qytetin për të shprehur dashurinë apo të përkujtojnë njeriun e tyre të dashur që nuk jeton më.

**Qosja: Unë historian i letërsisë shqipe, Dritëroi krijues i një vepre të shumëllojshme**

**A**kademiku nga Kosova Rexhep Qosja, i ka dërguar një letër familjes së shkrimtarit Dritëro Agolli, në përvjetorin e parë të ndarjes së tij nga jeta. Përmes kësaj letre, Qosja shkuan se Dritëroi është krijues i një vepre të shumëllojshme, klasik i letërsisë sot dhe vëllimet e tij janë maja më e lartë kuptimore e artistike.

**Letra E nderuara Sadija,**

Të nderuar familjarë, kolegë e miq! Ju përhëndes prej Prishtinës, me mendje e me zemër jam bashkë me ju dhe jam aty ku jeni edhe ju, aty ku po prehet e ku po përkujtohet me nderimet më të përkushtuara shkrimtarit i madh, klasiku i letërsisë sonë, Dritëro Agolli, Dritëroi ynë i dashur. E si të mos përkujtoj unë gjithnjë, çdo vit e çdo ditë të shënuar të tij?

Unë jam historian i letërsisë shqipe, kurse ai krijues i një vepre të shumëllojshme e të shumvëllimëshe, të cilën e quaj njërin prej majave më të larta kuptimore e artistike të kësaj letërsie, prej së cilës mijëra lexues shqiptarë i kanë parë e i kanë përjetuar më thellë e më gjithanshëm të kaluarën, traditën e të përshtatshmen tonë dhe janë frymëzuar të mendojnë bashkë me mua me shpresë e besim në të ardhmen tonë të përbashkët kombëtare e shtetërore.

qenë Nano, Berisha, Rama etj., nxënësit të gjithë do të heshtin. Më i zgjuari ndër ta do të japë këtë përgjigje: Mos janë ca politikanë që kanë jetuar në kohën e Dritëro

Agollit?", tha në fjalën e rastit, Namik Dokle. Një vit pas vdekjes, Agolli u vlerësua me certifikata mirënjohje dhe cmime vlerësuese nga Kryegjyshata botërore e

Gjjobat ndaj këtyre bizneseve nisin nga 50 mijë lekë për moslëshim kuponi për të dytën herë

# Tatimet, gjoba 200 mijë lekë për kasat

## Publikohet lista me 127 bizneset që janë gjetur me shkelje

Ornela Manjani

Tatimet shtrëngojnë masat për bizneset që nuk lëshojnë kupon tatimor. Administrata tatimore nuk po mjaftohet vetëm me evidentimin dhe gjobitjen e subjekteve që nuk përdorin rregullisht apo fare kasat fiskale, por ka nisur edhe publikimin e identitetit të tyre në faqen e vet zyrtare. Këtë javë në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë publikuar pronarët dhe NIPT-et e 127 bizneseve, të cilët janë evidentuar me kundërvajtje në përdorimin e kasave fiskale. Pjesa më e madhe e gjobave ndaj këtyre bi-



zneseve është në vlerën e 50 mijë lekëve, por nuk mungojnë as gjobat nga 100 mijë deri 200 mijë lekë.

### LISTA

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqaron se identiteti i shkelësve me pajisjet

fiskale do të bëhet publik. Publikohet identiteti i tatimpaguesit kundërvajtës në rastet kur: nuk instalon pa-

### SHKELJET E TATIMPAGUESVE

1. Nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit.
2. Nëse pas verifikimit të parë, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale dhe situata nuk është rregulluar brenda 15 ditëve gjobitet.
3. Nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve.
4. Çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të para.

jisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit; nëse pas verifikimit të parë, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale dhe situata nuk është rregulluar brenda 15 ditëve; kur nuk lëshon

kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve. Identiteti publikohet, gjithashtu, për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të para.

Subjekt	Agjencia	Data	Gjoba
Eduard Llulla	Agjensia Tatimore Tiranë	11/14/2017	50000
Jorgo Kondi	Agjensia Tatimore Sarandë	7/31/2017	50000
Kujlim Mullai	Agjensia Tatimore Tiranë	11/9/2017	50000
Armir Zaimi	Agjensia Tatimore Tiranë	11/2/2017	50000
Vangjush Saraci	Agjensia Tatimore Korçe	11/15/2017	50000
Ilirian Jashari	Agjensia Tatimore Durres	11/14/2017	50000
Gastur Biduli	Agjensia Tatimore Tiranë	11/7/2017	50000
Frida Avduli	Agjensia Tatimore Gjirokastrë	11/20/2017	50000
Gjezar Kurti	Agjensia Tatimore Tiranë	11/3/2017	50000
Group 3 Shpk	Agjensia Tatimore Tiranë	11/14/2017	50000
Esat Duraj	Agjensia Tatimore Tiranë	11/7/2017	50000
Kemal Ertas	Agjensia Tatimore Durres	11/22/2017	50000
Artur Sinani	Agjensia Tatimore Tiranë	10/21/2017	50000
Mario Xhumari	Agjensia Tatimore Lushnje	10/18/2017	50000
Ervin Dodani	Agjensia Tatimore Tiranë	10/11/2017	50000
Robert Skendaj	Agjensia Tatimore Fier	8/31/2017	50000
Marko Dylja	Agjensia Tatimore Tiranë	8/25/2017	50000
Milleni Intern	Agjensia Tatimore Tiranë	10/23/2017	50000
Klodjan Pajuni	Agjensia Tatimore Durres	10/27/2017	50000
Nurie Selaci	Agjensia Tatimore Fier	8/30/2017	50000
Gazmir Koçi	Agjensia Tatimore Elbasan	8/24/2017	50000
Pp-Lol 2017	Agjensia Tatimore Tiranë	10/31/2017	50000
Arjon Haxhiraj	Agjensia Tatimore Vlore	10/17/2017	50000
Vesjel Demiraj	Agjensia Tatimore Tiranë	10/14/2017	50000
Bledi Shehu	Agjensia Tatimore Tiranë	10/11/2017	50000
Adrian Kuqi	Agjensia Tatimore Durres	8/8/2017	50000
Metin Abakay	Agjensia Tatimore Tiranë	10/23/2017	50000
Çezar Tali	Agjensia Tatimore Kruje	10/24/2017	50000
Sokol Tabaku	Agjensia Tatimore Tiranë	10/13/2017	50000
Shpresa Zorba	Agjensia Tatimore Tiranë	8/7/2017	50000
Ylli Hidri Agjensia	Tatimore Tiranë	10/22/2017	50000
Drita Lahi	Agjensia Tatimore Tiranë	10/7/2017	50000
Sadete Ahmali	Agjensia Tatimore Elbasan	8/25/2017	50000
Alma Baho	Agjensia Tatimore Fier	10/25/2017	50000
Veli Çela	Agjensia Tatimore Durres	10/6/2017	50000
Abaz Sina	Agjensia Tatimore Tiranë	10/30/2017	50000
Qefserë Kodra	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Redi Panariti	Agjensia Tatimore Tiranë	1/16/2017	50000
Kazazi-Meat.Sh.PK	Agjensia Tatimore Kavaje	8/4/2017	100000
Osman Xherri	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Zamir Meraj	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Olljon Shehu	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Elsa Pine	Agjensia Tatimore Tiranë	1/19/2017	50000
Rexhep Dalipi	Agjensia Tatimore Tiranë	1/20/2017	50000
Andon Ibra	Agjensia Tatimore Tiranë	1/20/2017	50000
Jolanda Zifla	Agjensia Tatimore Tiranë	1/20/2017	50000
Fari Spaho	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Besmir Dosti	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Divendo	Agjensia Tatimore Tiranë	11/7/2017	50000
Elton Balla	Agjensia Tatimore Elbasan	11/29/2017	50000
Fatbardh Shlitza	Agjensia Tatimore Shkoder	11/9/2017	50000
Erjon Çeku	Agjensia Tatimore Tiranë	11/9/2017	50000
Fatbardh Shlitza	Agjensia Tatimore Shkoder	11/8/2017	50000
Lukëzim Merollari	Agjensia Tatimore Pogradec	11/16/2017	50000
Zigur Ismaili	Agjensia Tatimore Vlore	11/15/2017	50000
Sadi Koçi	Agjensia Tatimore Lushnje	11/15/2017	50000
Fejz Meçaj	Agjensia Tatimore Tiranë	11/2/2017	50000
San Graal A.E.	Agjensia Tatimore Tiranë	11/1/2017	50000
Enkelëjd Muxllari	Agjensia Tatimore Vlore	11/21/2017	50000
Besnik Ismailaj	Agjensia Tatimore Tiranë	11/2/2017	50000
Agron Mema	Agjensia Tatimore Tiranë	10/25/2017	50000
Keidi Velçani	Agjensia Tatimore Fier	10/24/2017	50000
Fatma Turku	Agjensia Tatimore Tiranë	10/22/2017	50000
Ilirian Oako	Agjensia Tatimore Korçe	8/11/2017	50000
Natya E Oete	Agjensia Tatimore Tiranë	10/31/2017	50000
Elsa Vathi	Agjensia Tatimore Tiranë	10/16/2017	50000
Shaban Aga	Agjensia Tatimore Tiranë	10/16/2017	50000
Elvis Rusta	Agjensia Tatimore Elbasan	8/23/2017	50000
Dritan Xheka	Agjensia Tatimore Durres	8/18/2017	50000
Beleri	Agjensia Tatimore Vlore	1/25/2017	9000
Beleri	Agjensia Tatimore Vlore	1/25/2017	102472
Beleri	Agjensia Tatimore Vlore	1/25/2017	23528
Mallin Prenga	Agjensia Tatimore Lezhë	3/29/2017	50000
Sadik Elezi	Agjensia Tatimore Tiranë	3/15/2017	50000
Mallin Prenga	Agjensia Tatimore Lezhë	3/13/2017	50000
Perparim Terëshalla	Agjensia Tatimore Sarandë	3/7/2017	200000
Miti Boçi	Agjensia Tatimore Tiranë	3/6/2017	50000
Bukurosh Peza	Agjensia Tatimore Elbasan	3/1/2017	50000
Andrea Ndoci	Agjensia Tatimore Lezhë	3/27/2017	50000
Marvin Tafaj	Agjensia Tatimore Durres	3/17/2017	50000
Besnik Zela	Agjensia Tatimore Tiranë	5/9/2017	50000
Iliri B-2012	Agjensia Tatimore Tiranë	4/18/2017	50000
Olger Lemellari	Agjensia Tatimore Korçe	3/24/2017	50000
Haxhi Tagani	Agjensia Tatimore Shkoder	3/11/2017	50000
Hekuran Shehu	Agjensia Tatimore Tiranë	1/18/2017	50000
Adrian Domo	Agjensia Tatimore Tiranë	1/23/2017	50000
Metai Gjana	Agjensia Tatimore Tiranë	1/17/2017	50000
Enri Pengu	Agjensia Tatimore Tiranë	12/4/2017	50000
Arian Shkira	Agjensia Tatimore Pogradec	12/5/2017	50000
Admir Selimi	Agjensia Tatimore Tiranë	12/4/2017	50000
Bledi Qafzezi	Agjensia Tatimore Korçe	12/5/2017	50000
Alfredo Rëmbeci	Agjensia Tatimore Korçe	12/5/2017	50000
Xhulliano Lila	Agjensia Tatimore Tiranë	12/11/2017	50000
Erion Daulja	Agjensia Tatimore Durres	12/7/2017	50000
Ndriçim Lloshi	Agjensia Tatimore Durres	6/23/2017	50000
Bajram Dedej	Agjensia Tatimore Tiranë	2/23/2017	50000
Enea Kalemii	Agjensia Tatimore Tiranë	2/8/2017	50000
Rogert Zylfo	Agjensia Tatimore Tiranë	2/23/2017	50000
Era 2000	Agjensia Tatimore Dtm	2/17/2017	50000
Beleri	Agjensia Tatimore Vlore	1/25/2017	65000
Blerina Sejko	Agjensia Tatimore Sarandë	10/25/2017	50000
Gazmen Kume	Agjensia Tatimore Tiranë	10/24/2017	50000
Novruz Xhemali	Agjensia Tatimore Tiranë	10/9/2017	50000
Xhovano Boshi	Agjensia Tatimore Tiranë	10/9/2017	50000
Blerina Shehu	Agjensia Tatimore Elbasan	8/24/2017	50000
Fejzi Meçanaj	Agjensia Tatimore Permet	10/31/2017	50000
Bujar Hoxha	Agjensia Tatimore Tiranë	10/30/2017	50000
Dorian Grori	Agjensia Tatimore Tiranë	10/27/2017	50000
Miguel Vila	Agjensia Tatimore Tiranë	10/25/2017	50000
Antonia Majlinda Beleri	Agjensia Tatimore Vlore	8/14/2017	50000
Perparim Oenaj	Agjensia Tatimore Durres	11/9/2017	50000
Shqiponja Ramadan	Agjensia Tatimore Tiranë	11/7/2017	50000
Etleva Bardhi	Agjensia Tatimore Tiranë	11/3/2017	50000
Bukurije Hida	Agjensia Tatimore Elbasan	11/2/2017	50000
Genc Braho	Agjensia Tatimore Tiranë	11/1/2017	50000
Ada Musaraj	Agjensia Tatimore Tiranë	9/20/2017	50000
Robert Skendaj	Agjensia Tatimore Fier	9/19/2017	50000
Sali Lila Agjensia	Tatimore Tiranë	9/6/2017	50000
Dedenik Dedenikaj	Agjensia Tatimore Vlore	9/14/2017	100000
Kejvis Haçi	Agjensia Tatimore Tiranë	9/4/2017	50000
Urim Thaçi	Agjensia Tatimore Tiranë	9/15/2017	50000
Benard Stafaj	Agjensia Tatimore Tiranë	9/21/2017	50000
Fulong Agjensia	Tatimore Tiranë	9/8/2017	50000
Eralda Nehani	Agjensia Tatimore Shkoder	5/2/2017	50000
Rrahman Selmanllari	Agjensia Tatimore Vlore	12/14/2016	100000
Blerina Shehu	Agjensia Tatimore Elbasan	3/1/2017	50000
Alketa Ibraj	Agjensia Tatimore Lezhë	3/13/2017	50000

**SHPLLJE ANKANDI**  
 Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbasues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 02.03.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankanda i III për shfjtitjen e pasurisë të paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1000 m<sup>2</sup>, numër pasurie 294/33, Zona Kadastrale 3339, Volumi 11, Faqe 208 e ndodhur në Vrinë, Durres në pronësi të Z.Ardian Rexhep Kola me vlerë fillestare në ankan 1,764,000 LEKE.  
 Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672072580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



**M**inistri i Infrastruktura dhe Energjisë Damian Gjoknuri së bashku me Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve Arben Skënderi, kanë inspektuar punimet e ndërtimit të ujësjellës-kanalizimeve në Gjirin e Lalzit. Dy projektet që po zbatohen në këtë zonë, të cilat iu vijnë në ndihmë rreth 30 mijë banorëve kapinë vlerën e 13 milionë eurove. Projekti i parë lidhet me ndërtimin e kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe impiantit të Trajtitimit të Ujërave të Përdorura, për të cilin Gjoknuri tha se do të përfundojë në vitin 2019. Ndërkohë, projekti i dytë përfshin

## Investimet e qeverisë të Gjiri i Lalzit Gjoknuri: Impianti i ujërave të zeza vihet në funksion më 2019

### PROJEKTI

"Me përfundimin e këtij impianti, i cili do të vihet në funksionim në vitin 2019, e gjithë kjo zonë nuk do të ketë më probleme me trajtimin e ujërave të zeza. Do kemi një zgjidhje me një teknologji të fundit, projekt i bërë është ndër me bashkëkohorët".

ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit. "Me përfundimin e këtij impianti, i cili do të vihet në funksionim në vitin 2019, e gjithë kjo zonë nuk do të ketë më probleme me

trajtimin e ujërave të zeza. Do kemi një zgjidhje me një teknologji të fundit, projekt i bërë është ndër me bashkëkohorët. Realisht i jep një zgjidhje përfundimtare

gjithë kësaj zone dhe i shërbën gati 30 mijë banorëve të cilët do të lidhen me këtë rrjet-tha Gjoknuri. Ministri vijoi më tej duke u ndalur te reforma e ujit të pijshëm, duke u shprehur se rivendosja e ligjshmërisë në këtë sektor do të mundësojë shtimin e investimeve, veçanërisht në zonat me potencial turizmi. "Qeveria shqiptare, në vazhdim edhe të aksionit që ka nisur për një



Ministri i Infrastruktura dhe Energjisë Damian Gjoknuri, dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve Arben Skënderi në Gjirin e Lalzit

miradministrim të sistemit të ujit që është i lidhur me kanalizimet, pikërisht këtë ka qëllim, rritjen e performancës ekonomike. Rritja e arkëtimit, shëndosha financiare e gjithë sektorit,

në mënyrë që të kemi investime aq të nevojshme duke filluar nga zona që kanë potencial më të madh ekonomik, siç janë zonat me përparësi turizmi", tha Gjoknuri.

Ministria e Bujqësisë shpall konkursin për ideim brand-in e dyqaneve me produkte vendi

Ornela Manani

**M**inistria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur konkursin për përzgjedhjen e brand-it të rrjetit më të ri të dyqaneve me produkte tipike shqiptare. Deri më datë 21 Shkurt 2018, studentët, individët, studio, kompanitë të fushës, etj., kanë mundësi të bëhen pjesë me aplikimet e tyre. Ministria, në kuadër të promovimit të produktit shqiptar, mbështetur në punën e deritanishme të bërë nga shumë bujq, fermerë, agropëpunues dhe artizanë shqiptarë, ka projektuar krijimin e një rrjeti dyqanesh me produkte cilësore vendase.

### PRODUKTET

Produktet do të jenë 100% me origjinë nga territori dhe trevat e Shqipërisë, ndërsa dyqanet duhet të paraqesin pikërisht këto produkte me standarde maksimale, që nga cilësia, deri tek pakëtimi dhe marketimi i produktit. Dyqanet do të vendosen në zona qendrore dhe të aksesueshme lehtë nga turistët vendas dhe të huaj. Elementët tradicionalë kombëtarë janë një kërkesë specifike për këtë konkurs dhe aplikantët duhet të përpigjen t'i ndërthurin sa më mirë me elementë modernë. Edhe lëndët ndërtuese dhe arredimi duhet të reflektojë kulturën shqiptare, ndaj këshillohet të përdoren materiale të riciklueshme, dru, kashtë, hekur, gur, etj.

### APLIKIMI

Një aplikim i plotë duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm: Ideimi i një logotje që përfaqëson denjësisht markën/produktin tipik sh-

# Prodhimet shqiptare, 5 mijë dollarë për brand-in fitues

*Kushtet, afatet dhe dokumentet për të aplikuar*



Foto ilustruese

### DY FAZAT E KONKURISIT

- Faza e parë do zhvillohet brenda një jave për të përzgjedhur 10-15 aplikantët e parë, të cilët do të përmbushin idenë më të përafërt.
- Faza e dytë do të zhvillohet pas përzgjedhjes, ku fituesit do të paraqesin punimet e tyre në eventin përmbyllës, ku do të shpallet fituesi.

### KUSHTET PËR TË APLIKUAR

- Në konkursin për përzgjedhjen e brand-it të rrjetit të dyqaneve me produkte tipike shqiptare mund të marrin pjesë:
  - o Të gjithë të interesuarit: studentët e universiteteve, individë, studio, kompani të fushës, etj.
  - o Aplikantët e interesuar për pjesëmarrje në konkurs mund të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al).
- Të gjitha aplikimet, me projekt idetë përkatëse mund të ngarkohen në format PDF, brenda formatit të mësipërm.
- Aplikantët të përzgjedhur nga juria do të njoftohen brenda datës 23 Shkurt 2018 dhe do të ftohen për të prezantuar idetë e propozuara, në eventin përmbyllës, në datën 26 shkurt 2018.

qiptar, krijimi i një brand-inovativ, tërheqës dhe të qëndrueshëm, logo/slogan i përshtatshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë, ideimi i një projekti vizual në 3D i arredimit të dyqanit TIP. Idetë dhe materialet e më-

sipërme duhet të ngarkohen në formatin PDF në faqen e Ministrisë së Brendshme. Përzgjedhja e fituesit, i cili do të marrë çmimi prej 5 mijë dollarësh, do të bëhet në dy faza dhe do të vlerësohen nga një juri e

përbërë nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peleshi, përfaqësues i RED (Regional Economic Development) Rezart Sako, kryeredaktore RTSH Yllka Gjokopulli dhe ekspertë të fushës.

## Koncesionet për HEC-et, nis diskutimi i projektligjit për shpejtimin e procedurave

**T**ë hënën Komisioni parlamentar i Vepimitarive Prodhuese do të nisë shqyrtimin e projektligjit "Për koncesionet dhe partneritetit publik-privat", i cili i hap rrugën përshpejtimin të procedurave për dhënien e koncesioneve të HEC-ëve. Projektligji është depozituar në Kuvend që në datën 2 nëntor, por nisja e diskutimeve duket se kërkoj mbi 3 muaj kohë. Ndërkohë, referuar ndryshimeve parashikohet që ndërtimi dhe shfrytëzimi i burimeve të energjisë së rinovueshme me kapacitet të instaluar mbi 2MW, të cilat kanë vlerë investimi mbi 100 milionë euro të përjashtohen nga procedurat aktuale të dhënies me koncesion apo partneritetit publik-privat. Sipas relacionit shoqëruar, në këtë kategori mund të shqyrtohen në mënyrë specifike ndërtimi i kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike nga hidrocentralet apo termocentralet, ndryshe nga legjislacioni aktual, i cili për HEC-et me kapacitet të instaluar mbi 2 MW, kërkonte zbatimin e procedurave së dhënies me koncesion. Sipas relacionit, sektori energjetik shqiptar aktualisht ka nevojë për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese, me qëllim rritjen e prodhimit të energjisë, por kuadri ligjor aktual parashikon procedurë të zgjatura për miratimin e kontratës. Gjithashtu, në dokument thuhet se ky përjashtim do të mundësojë thithjen e investimeve strategjike të huaja dhe atyre vendase, pasi deri më tani, shumë investitorë që kanë pasur interes për të investuar në sektorin elektroenergjetik, janë tërhequr pas konstatimit se kuadri ynë ligjor për koncesionet dhe PPP-të kërkon një kohë të gjatë prej më shumë se dy vjetësh, për finalizimin e kontratës koncesionare.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me datë 26.02.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m<sup>2</sup>, me Nr pasurie 1/1544-1-4, Vol.7, Fa.247 me vlerë fillestare në ankand 24,570 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me datë 16.02.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shitjen e pasurisë të paluajtshme Truall me Nr. pasurie:6/286 dhe sip.242 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8513, Vol.24, Fa.102 e ndodhur në Rr"V.Kuqi", Lagjia 12, Durrës me vlerë fillestare në ankand 67,200 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me datë 16.02.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluajtshme Ndërtëse me Nr. pasurie:6/56 dhe sip.108.24 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8513.vol.31,fa.121 e ndodhur në Rr"V.Kuqi",Lagjia 12, Durrës me vlerë fillestare në ankand 1,120 EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



## ANALIZA

Shaban Murati

# MBI ROMANIN "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" të shkrimtares Flutura Aça

Mbarova së lexuari romanin "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" të shkrimtares Flutura Aça, dhe kam mbetur i befasuar nga forca dhe pjekuria artistike dhe filozofike e trajtesës dhe e formësimit të kësaj vepre të denjë të letrave shqipe.

Problemet ekzistenciale koherente të njeriut, të ndjenjave, të moralit, të shpirtit dhe të shoqërisë njerëzore ngërthehen mjeshhtërisht në një sinkronizim artistik të veçantë.

Si një roman i madh i letrave shqipe, "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" ngërthen disa enigma të përhershme të letërsisë dhe të jetës, të cilat kanë nevojën e një kontributi të secilës kohë njerëzore dhe historike për t'u kuptuar gjithmonë e më shumë. Romani juaj e sjell këtë kontribut nëpërmjet dritëhijëve të reja dhe të vjetra të shpirtit njerëzor si një galaktikë, që ka nevojë gjithmonë për të eksploruar vje të rij.

Triptiku, që i jep emocionin e veçantë romanit:

Të trondit loja e unit dhe e ekzistencës, që përshkon romanin. Sa origjinalë e të veçantë, aq dhe përgjithësuese fatet e personazheve, që ndërthuren si trupëzime apo shenja dalluese të ideve, të shpirtit, të konflikteve, të dilemave dhe të të panjohurave të mëdha. Ka një origjinalitet të rrallë zhbirim psikologjik, ekzistencial, human dhe shpirtëror në raportet me Jan Van Anđel, që janë ndër faqet më të mrekullueshme të letërsisë shqipe të këtij shekulli.

Të trondit loja e dashurisë si një krijim poetik i një udhëtimi nëpër kohë të pakohë, e cila nuk mund të mbarojë kurrë dhe pikërisht për këtë shquhet letërsia e madhe që ta çojë lexuesin në hapësira dhe pamje ndjenjash, që nuk i rrok dot. Dashuritë e mëdha, që nuk kanë kufij dhe adresë kohe apo vendi apo njeriu unik, të Gjenezës apo Genti apo Van Anđel apo Majla, janë po aq sublime sa kopjet klasike të dashurive të mëdha me fillim dhe me fund. Romani e sheh dashurinë si diçka të madhe, që i përket shpirtit njerëzor dhe jo një emri të veçantë dhe kjo e bën edhe më tokësore, edhe më pranë njeriut të sotëm.

Të trondit loja e shoqërisë dhe e historisë, që rrok metamorfozën e enigmës ende të padeshifruar të rënies së komunizmit në Europën Lindore, përfshirë edhe Shqipërinë. Mendoj se kjo linjë e romanit përbën një kontribut



Në foto:  
Shkrimtarja  
Flutura Aça

të shquar në ndriçimin artistik të dinamikës dhe të katrahurës dhe të ndryshimeve reale, ireale, të vërteta dhe të rreme, që ndodhën në vendin tonë. Zbërthimi artistik i fenomenit "Shqipëri", ku siç

kam shkruar diku: "edhe monarkia, edhe komunizmi, edhe demokracia ishin karikaturë", është një detyrë e pakryer e letërsisë shqiptare në letërsinë europiane.

Romani "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" i Flutura Açës plotëson një nevojë njohjeje kulturore dhe shpirtërore për publikun e gjerë jo vetëm të vendeve ish-komuniste, por më gjerë në shkallë europiane. Nuk mendoj se ka ndonjë vepër tjetër letrare të periudhës 25-vjeçare postkomuniste

në letrat shqipe, që të pasqyrojë me kaq art dhe me kaq vështrim analitik dhe sintetizues të vërtetat e hidhura dhe format e një përmbyseje, që qe më shumë si nderi, se sa shtytje njerëzore.

Është një kapitull historik shqiptar, por që jep një filmim artistik origjinal të ballafaqimit historik midis regjimit komunist mbytës dhe aspiratës për demokraci. Kemi ndërthurjen e fateve njerëzore me fatet e shoqërisë, por edhe forcën e individualitetin e fateve njerëzore të fuqishme, që ngrihen mbi iluzionet dhe zhgënjimet, që historia u rezervon popujve në zhvillim e sipër. Kjo forcë shpirtërore e bën romanin të ketë koloritin e pandashëm të shpresës dhe të shpirtit optimist njerëzor.

Mendoj se romani "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" do të duhet të përkthehet në gjuhë të huaj, sepse niveli i lartë artistik, tema tejet interesante, dhe forca psikologjike e filozofike, e bëjnë një vepër të denjë për lexuesin europian, që të mësojë edhe të kuptojë pjesën gjeografike dhe historike më të pakuptueshme të Europës në 30 vitet e fundit, pjesën Lindore të saj.

Si veçori e një vepre të madhe kemi në roman shkrimin sa elegante, aq profesionale midis narracionit dhe filozofimit, gjë që është aq e vështirë dhe që është shpesh herë i paarrtshëm edhe për shkrimtarë me stazh më të gjatë letrar.

Forca artistike, pasuria e mjeteve shprehëse dhe kultura e thellë i japin mendimit estetik dhe shijimit estetik një ndikim iluminues të fortë mbi lexuesin, duke e nxitur atë të prodhojë mendim dhe të futet thellë në detin e zhbirim psikologjik shpirtëror dhe mendimor të autorit.

Duke qenë përshkrim origjinal artistik për jetën e sotme shqiptare, romani "Të ftuar në Rrethin e Dhjetë" tejkalon kufijtë e identitetit të vet lokal dhe shndërrohet në një vepër me horizontet të gjera letrare, që i flet edhe lexuesit shqiptar, edhe lexuesit europian, edhe qytetarit botëror, ambicie artistike që mund ta realizojë vetëm një fuqi e veçantë artistike.

## RRËFIM

Firence, qershor 2016.

Tre miq të vjetër qysh nga fëmijëria, të cilët e kanë lënë Shqipërinë në rrethana dhe në kohë të ndryshme pas kapërcyellit të 1990-tës, vendosin të festojnë së bashku 50-vjetorin e lindjes. Por në jetëshkrimin e tyre prej shqiptarësh tashmë në emigrim, përzihen gjurmët e së shkuarës nën diktaturë, rrugëtimet e veje-vijës së shpeshtë në vitet e lirisë mes dy atdheve të tyre dhe shenjat e përpjekjes për ta mbrojtur thelbin e tyre mes identitetit etnik të lindur dhe atij europian të fituar. A janë ata të përgatitur ta fshijnë të shkuarën shqiptare, e cila befas ende ua dikton dhe ua helmën ndonjëherë jetën? A do të munden ata të mbeten miq edhe pas shqyrtimit që ky takim i pafajshëm do t'u kërkojë, shqyrtim që shpesh nuk lidhet me ata vetë, por që kryqëzohet dhe ndikon në jetën e tyre? Kjo rrëfënjë që shtrihet në gjysmëshekullin e fundit shqiptar dhe që merret me shtegtimin e viteve të fundit të mijëra shqiptarëve nëpër botë, është një sagë mirëfilli shqiptare e luajtur në Europën e sotme. Ky rrëfim është një kushtim për dashurinë njerëzore, për dashurinë si sublimim që nuk e zhbën koha dhe një triumf për atdhedashurinë, të tretura në gjakun shqiptar nga substanca më e bekuar e kësaj bote: Liria.

○ "Flutura Aça është një nga zërat shqiptarë sqimatarë."

Dacia Maraini, Itali

○ "Flutura Aça është si Marguerite Duras - mbi-emoionale."

Amelija Liçeva, Bullgari

○ "Aça, është një transkriptuese e fortë e emocioneve."

Ennio Grassi, Itali

○ "Stili i Açës, me përfytyrime dhe skena të gjalla, ka ndonjëherë elementë të sagave të vjetra."

Arjan Peters, Holandë



Flutura Aça  
Të ftuar  
në Rrethin  
e Dhjetë  
Roman

Në foto:  
Kopertina e librit

Operacioni "Forca e ligjit", sekuestrohen 2.2 kg kokainë, shpallet në kërkim një 26-vjeçar

# Tregtonin kokainë dhe heroinë në lokalitë e natës, 7 vetë në pranga

## Agjentët e infiltruar zbuluan bazën e drogës, aktiviteti kriminal që prej 3 vitesh

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Shtatë persona, pjesë e një grupi kriminal që shpërndante kokainë dhe heroinë në Shkodër kanë përfunduar në pranga, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Mësohet se në kuadër të operacionit "Forca e ligjit" (goditja e dytë në qytetin verior) u sekuestrua një sasi prej 2.237 kg kokainë. Droga u gjet në lokalitë e natës "Sampa" në fshatin Beltojtë të zonës së Bërdicës, i cili që prej të paktën 3 vitesh ishte kthyer në një bazë e trafikantëve të kokainës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës dje bënë me dije se në bashkëpunim me prokurorinë u bë e mundur shkatërrimi i grupit kriminal "Kokaina". Sipas bluve, gjatë operacionit të zhvilluar ur ditë më parë u arrestuan shtetasit: Helidon Marku, 42 vjeç, banues në Shkodër (person i dënur disa herë për vepra të rënda penale); Indrit Tagani, 30 vjeç banues në Shkodër; Erjon Zekaj, 31 vjeç, banues Koplik i Sipërm, Malësia e Madhe; Saimir Arçi, 31 vjeç, banues në Shkodër, Aldo Vruçaj, 28 vjeç, banues në Shkodër; Kristjan Ujkaj, 31 vjeç, banues në Shkodër dhe Aleksandër Matoja, 31 vjeç, banues në Shkodër. Gjatë operacionit, drejtori i policisë vendore të Shkodrës, Gjovalin Loka doli në një deklaratë për mediat duke dhënë më shumë detaje rreth këtij operacioni të finalizuar me sukses.

**HETIMI**

Sipas policisë së Shkodrës operacioni "Kokaina" u finalizua pas një hetimi 3 mujor me aplikimin e metodave speciale të hetimit. Gjatë hetimeve është provuar se Helidon Marku, menaxher i një lokali nate në Shkodër në bashkëpunim me shtetasit e tjerë të arrestuar dhe 26-vjeçarit në shpallur në kërkim kanë zhvilluar prej kohësh aktivitetin kriminal të mbajtjes, shitjes së drogave të forta kokainë dhe heroinë, duke ua shitur klientëve brenda ambienteve të këtij lokali. Burimet e mësipërme sqaruan se ky lokal aktivitetin e tij e kishte gjatë orëve të natës duke ofruar muzikë live për klientët dhe disa balerina që kërcenin në lokal. Gjatë hetimeve 3 mujore agjentët të ndryshëm kanë hyrë në këtë lokal nate duke u sjellë si klientë. Po ashtu shtatë shtetasit e arrestuar dhe personi i shpallur në kërkim janë përgjuar qoftë aty brenda përmes përgjimit ambi-



I arrestuari, Indrit Tagani



I arrestuari, Erjon Zekaj



I arrestuari, Aldo Vruçaj



I arrestuari, Saimir Arçi

**PLAGOSJA NË LOKAL**

Më 3 shtator të vitit të kaluar, në lokalitë me muzikë live "Sampa" u plagos rëndë 21-vjeçari Edmir Nilaj, i cili pas afro 4 muajsh u nda nga jeta. Në lidhje me këtë ngjarje, policia akuzon shtetasin Admir Dekovi, i cili ishte bodiguar në atë lokal. Përpara kësaj plagosjeje me pasojë vdekjen kishte ndodhur një tjetër sherr me disa shtetasve nga Lezha dhe Shkodra, të cilët kanë goditur njëri-tjetrin dhe kanë thyer xhamat e makinave. Tashmë ky lokal deri në një afat të pacaktuar nuk do funksionojë për shkak të sekuestros së vendosur.

ental, por edhe në telefonatat apo bisedat mes tyre përmes mesazheve në telefon. Pas përgjimeve dhe agjentëve të infiltruar është arritur në shkatërrimin e grupit kriminal dhe sekuestrimin e sasisë së kokainës. Shtatë personat e arrestuar dhe i riu i shpallur në kërkim, përveç muzikës live dhe balerinave në lokalitë e tyre, ofronin për klientët edhe droga të ndryshme kundrejt çmimeve të ndry-

shme. Përveçse kokainës, policia sekuestroi në cilësinë e provave materiale dhe: 3 automjete të tipeve "Audi" Q5, "Ford Fiesta" dhe "BMW"; 10 telefona celularë të markave të ndryshme, 489.000 lekë, 635 dollarë dhe 280 euro. Ndërsa është vënë nën sekuestro lokalitë "Sampa", në ambientet e të cilët zhvillohej ky aktiviteti kriminal. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për kryerjen e veprave penale të "Prodimit, mbajtjes e shitjes së

**OPERACIONI "KOKAINA" NË SHKODËR**

**TË ARRESTUARIT**

1. Helidon Marku, 42 vjeç, banues në Shkodër, i dënur disa herë për vepra të rënda penale
2. Indrit Tagani, 30 vjeç, banues në Shkodër
3. Erjon Zekaj, 31 vjeç, banues Koplik i Sipërm, Malësia e Madhe
4. Saimir Arçi, 31 vjeç, banues në Shkodër
5. Aldo Vruçaj, 28 vjeç, banues në Shkodër
6. Kristjan Ujkaj, 31 vjeç, banues në Shkodër
7. Aleksandër Matoja, 31 vjeç, banues në Shkodër

**NË KËRKIM**

1. H.K, 26 vjeç, banues në Shkodër

**SEKUESTRIMI**

- 2 kilogramë e 237.6 gramë lëndë narkotike e dyshuar Kokainë.
- 3 automjete të tipeve "Audi" Q5, Ford "Fiesta" dhe "BMW".
- 10 telefona celularë të markave të ndryshme.
- 489.000 lekë, 635 dollarë dhe 280 euro,

narkotikëve" e përshtatje e lokalit për përdorim droge, kryer në bashkëpunim.

**SHKURT**

**Digjet zyra e drejtorit të ALUIZNI-t, gjenden tre bidonë me benzinë**

**FUSHË KRUIJË** - Zyra e drejtorit të ALUIZNI-t në Fushë-Krujë është përfshirë mbrëmë nga flakët e zjarrit. Mësohet se zyra e kreut të ALUIZNI-t është djegur plotësisht, përfshirë kompjuterin dhe bazën materiale. Sipas raportimeve paraprake, dyshohet se zjarri ka qenë i qëllimshëm, pasi në ambientet e godinës janë gjetur dhe tre bidonë me benzinë të papërdorur. Ndërhyrja në kohë e punonjësve të reparitit të zjarrfikësve ka parandaluar djegjen e plotë të godinës. Ndërkohë, në vendngjarje ka shkuar policia, e cila po punon intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të kriminit.

**I gjenden armë dhe kanabis në sera, kapet 56-vjeçari**

**KUÇOVË** - Policia e Kuçovës ka sekuestruar një sasi prej rreth 60 kg kanabis, ndërsa ka vënë në pranga një 58-vjeçar. Bëhet fjalë për shtetasin Pëllumb Marra, banues në fshatin Salcë, Kozare. Sipas bluve, Marra u arrestua, pasi nga kontrolli i ushtruar në sera të pronës të tij iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: sasia e drogës e ndarë në 16 pako; 1 automatik model 56; 2 kërrha dhe 2 fishekë të kalibratit 7.62 dhe 1 pistoletë me ajër e kalibratit 8 mm. Materialet në ngarkim të tij i kaluan për hetime të mëtejshme prokurorisë Berat për veprat penale: "Prodhim dhe shitje të lendeve narkotike", "Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake".

**U vuri çiftin në kokë gruas dhe djalin, prangoset agresori**

**DIBËR** - Një 59-vjeçar nga Dibra është arrestuar nga policia, pasi akuzohet për dhunë në familje. Mësohet se blutë kanë ndërrhyrë në kohë duke parandaluar në konflikt të rëndë në familjen e shtetasit Elez Mera, banues në fshatin Lishan i Poshtëm në Luzni të Dibrës. Policia bëri me dije se Mera pasi kishte dhunuar bashkëshorten e tij D.M., 58 vjeçe dhe djalin e tij K.M., 29 vjeç, iu kishte drejtuar atyre armë dhe i kërcëronte me jetë. Pas sinjalizimit, blutë mundën të vënë në pranga kryefamiljarin, ndërsa iu sekuestrua arma e gjahut, me të cilën ai terrorizonte familjarët e tij. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Dibër për veprat penale: "Dhunë në familje" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

**Gjendet "Volksvageni" i braktisur dhe pa targa**

**Vidhet argjendaria në qendër të qytetit, autori shqeu qepenin me një makinë të vjedhur**



Pasi ka marrë bizhuteritë, autori ka dalë nga aty dhe është larguar me shpejtësi duke mos arritur që të kapet

nga forcat e policisë. Mësohet se sapo autori ka goditur me makinë qepenat e argjendarisë ka rënë sinjali i alarmit duke qenë se ky subjekt kishte një kontratë me një prej policive private. Pas afro 4 minutash policia private ka shkuar në vendngjarje, por nuk e ka gjetur aty autorin. 7 minuta më pas, policët privat kanë njoftuar Policinë e Shtetit. Një patrullë që ka qenë në lëvizje ka shkuar me shpejtësi, por pa arritur që të kapë hajdutin. Ndërkohë, blutë pohan se vetëm pak

metra larg nga vendi i ngjarjes është gjetur automjeti i braktisur, me të cilin është kryer vjedhja me thyerje. Hetuesit dyshojnë se ky mjet është i vjedhur, pasi ishte pa targa. Nga këqyrja e mjetit rezultoi se nuk është ndezur normalisht me çelës, por i janë shkaputur telat dhe autori e ka ndezur përmes kësaj lidhje të improvizuar siç ndodh kur dikush vjedh një automjet. Burimet e mësipërme pohan se autori (ka qenë me kapuç në kokë) ka përfutur edhe nga errësira dhe moti i keq. se.ni.

E DIEL  
4 Shkurt  
2018

MILOSA O

## Ekskluzive.

**N**ë këtë intervistë të gjatë për “Milosao”, historiani i njohur tregon disa nga keqkuptimet për monografinë e tij, por edhe në mënyrë të thukët mënyrën sesi e ka parë Skënderbeun. Ai shpreh se e respekton figurën e Skënderbeut, ndërsa qëllimi ka qenë rindërtimi i figurës së heroit kombëtar të Shqiptarëve në Mesjetë. Edhe njëherë ai shpjegon motivet e luftës së kryeheroit dhe mënyrën sesi e ka trajtuar. Autori sot, e kësaj dite, mëton të thotë se nuk e kupton atë reagim që pati publiku shqiptar dhe disa nga historianët për librin e tij. A ja vllente e gjithë ajo energji për të hedhur poshtë këtë figurë të jashtëzakonshme? “Ende pyes veten se pse kaq shumë pjesëmarrës që morën pjesë në këtë debat besonin se një historian mund ta denigrojë qëllimisht Skënderbeun dhe si mund të mendohet që vitet e hulumtimit shkencor t’i jenë dedikuar qëllim të vetëm për të dëmtuar shoqërinë shqiptare. Ende ruaj përshtypjen se ideologjia e vendit të rrethuar prej Enver Hoxhës, ksenofobia e skajshme, besimi hysterik në teoritë e konspiracionit dhe armiqhtë, ishin ata që e vendosën popullin shqiptar në vazhdimësi nën rrethim; kjo trashëgimi helmuese e kohës së Enveristit, kishte dhe ruan ende një ndikim të fortë në reagimin e shumë njerëzve. Nën regjimin e Enver Hoxhës, historiografia ishte një ndërmarrje shtetërore, historianët ishin nën kontroll të ngushtë dhe përmbushnin me punën e tyre një mision politik. Duke pasur parasysh në mendje këtë përvojë, shumë njerëz ende nuk mund të imagjinojnë se kërkimi historik është bërë diku tjetër në kushte krejt të ndryshme”.

Autori është kritik për mënyrën sesi bëhet historia në vendin tonë, por këtu fajin e gjen te politika dhe futja e saj sot në çdo aspekt të jetës shqiptare. Ndërkohë që hedh dritë për faktin se monografinë e tij e kishin kritikuar më së shumti ata që nuk e kishin lexuar fare librin, por i mirëkuptonte sepse ky përbën një fenomen të zakonshëm ë Shqipëri, sipas Schmitt.

Z.Schmitt, që tashmë mban detyrën e Presidentit të Sektorit të Shkencave Humane dhe Sociale dhe gjithashtu anëtar i Kryesisë së Akademisë Austriake të Shkencave davarit edhe njëherë debatin sa i përket përkatësisë etnike të Skënderbeut dhe shpjegon arsyen sepse




Foto: Jutta Benzberg

Oliver  
Jens

SCHMITT

Kurrë nuk shkrova se Skënderbeu është me origjinë të pastër serbe

fisnikëria e kohës së Skënderbeut, si shkallë të dinjitetit aristokratik, kishte edhe kryqëzimin me etnitë e tjera.

“Në fund të periudhës së Mesjetës, ekzistonte një rrjet i fortë ortodoks i lidhjeve farefisnore në Ballkan. Politikisht, Bizanti ishte i dobët, por ideja perandorake ishte e gjallë, ashtu si dhe prestigji i fuqisë bizantine-ortodokse. Dallimi gjuhësor ose

etnik nuk luajti një rol të madh për elitat sociale. Ashtu si në pjesët e tjera të Evropës, fisnikëria ishte me prejardhje multietnike dhe sa më i rëndësishëm ishte për mjedisin një fisnik, aq më të zgjeruara dhe multietnik do të ishte rrjeti i tij i farefisnisë. Ideja e pastërtisë etnike thjesht nuk ekzistonte në këtë mjedis të elitës...”, shprehet ai për “Milosao”.



Vijon në faqen 14

Në këtë numër: Oliver Jens SCHMITT, “Armëpushimi”, romani i Primo LEVIT sjellë nga Aida BARO, Cikël poezish dygjuhësh nga Agron TUFA, Bajram SEFAJ, Armand PLAKA, Thanas GJIKA etj...

# I

## INTERVISTA

### INTERVISTOI BEN ANDONI

**S**hqipëria ka bërë në harkun e pak viteve dy përkujtime të mëdha sa i përket Skënderbeut. A mendoni se figura e tij mund të vijë ende në kohët tona si simbol i identitetit në histori?

“Është në dorën e shoqërisë shqiptare t’i përgjigjet kësaj pyetjeje. Natyrisht, qeveria e sotme, njësoj si shumë qeveri më parë saj qysh prej nga themelimi i Shqipërisë së pavarur, do t’i jepte një përgjigje pozitive. Skënderbeu sigurisht përbën një pasqyrë të debateve shqiptare për identitetin dhe vendin e shqiptarëve në Evropë, Mesdhe dhe në Botën Islame. Identiteti shqiptar është negociuar dhe rinegociuar pothuajse rregullisht me pyetjen se çfarë përbën Skënderbeu për të. Madje edhe islamistët që nuk e pranojnë si një simbol kombëtar njohin në mënyrë indirekte pozicionin vendimtar të Skënderbeut në debatet e identitetit”.

**Juve keni bërë një punim shumë interesant lidhur me heroin tonë kombëtar dhe përballja me publikun shqiptar, ka qenë jo e mirë. E kishit pritur këtë lloj reagimi që vazhdon deri më sot? A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar?**

“Kërcënimet erdhën menjëherë pas publikimit të përkthimit në shqip kur njerëzit u nxitën nga Ismail Kadare, politikanë dhe gazetarë nacionalistë dhe ofendimet vazhduan për një kohë mjaft të gjatë. Unë nuk e prisja këtë lloj reagimi sepse besoj se libri e thekson rëndësinë e Skënderbeut në historinë ballkanike dhe evropiane dhe e trajton atë si një figurë madhore të kohës së tij.

Ende pyes veten se pse kaq shumë pjesëmarrës që morën pjesë në këtë debat besonin se një historian mund ta denigrojë qëllimisht Skënderbeun dhe si mund të mendohet që vitet e hulumtimit shkencor t’i jenë dedikuar qëllimit të vetëm për të dëmtuar shoqërinë shqiptare. Ende ruaj përshtypjen se ideologjia e vendit të rrethuar prej Enver Hoxhës, ksenofobia e skajshme, besimi historik në teoritë e konspiracionit dhe armiqë, ishin ata që e vendosën popullin shqiptar në vazhdimësi nën rrethim; kjo trashëgimi helmuese e kohës së Enveristit, kishte dhe ruan ende një ndikim të fortë në reagimin e shumë njerëzve. Nën regjimin e Enver Hoxhës, historiografia ishte një ndërmarrje shtetërore, historianët ishin nën kontroll të ngushtë dhe përm-bushnin me punën e tyre një mis-

*Në këtë intervistë ekskluzive për “Milosao”, autori shpjegon mënyrën sesi e ka parë Skënderbeun, keqkuptimet për të dhe pse ngjall kaq interes figura e heroit tonë kombëtar. Skënderbeu sigurisht përbën një pasqyrë të debateve shqiptare për identitetin dhe vendin e shqiptarëve në Evropë, Mesdhe dhe në Botën Islame. Identiteti shqiptar është negociuar dhe rinegociuar pothuajse rregullisht me pyetjen se çfarë përbën Skënderbeu për të. Madje edhe islamistët që nuk e pranojnë si një simbol kombëtar njohin në mënyrë indirekte pozicionin vendimtar të Skënderbeut në debatet e identitetit, shprehet Schmitt...*



Oliver Schmitt

### Schmitt: Kërcënimet ndaj meje


“Kërcënimet erdhën menjëherë pas publikimit të përkthimit në shqip kur njerëzit u nxitën nga Ismail Kadare, politikanë dhe gazetarë nacionalistë dhe ofendimet vazhduan për një kohë mjaft të gjatë. Unë nuk e prisja këtë lloj reagimi sepse besoj se libri e thekson rëndësinë e Skënderbeut në historinë ballkanike dhe evropiane dhe e trajton atë si një figurë madhore të kohës së tij. Ende pyes veten se pse kaq shumë pjesëmarrës që morën pjesë në këtë debat besonin se një historian mund ta denigrojë qëllimisht Skënderbeun dhe si mund të mendohet që vitet e hulumtimit shkencor t’i jenë dedikuar qëllimit të vetëm për të dëmtuar shoqërinë shqiptare.

# Oliver Schmitt: Jam kërcënuar dhe ofenduar për Skënderbeun

*Intervista mundohet të përcaktojë shumë nga keqkuptimet për figurën e heroit tonë kombëtar por edhe të sqarojë publikun me risitë e kësaj figure sa i përket trajtimeve nga shkollat e sotme historike. Autori shpjegon vështirësitë për ta pasqyruar heroin, por edhe shumë veçanti të tjera, që lidhen me të, kryesisht mënyrën sesi funksionoi në mënyrë ekonomike, por edhe motivet që e mbajtën gjallë luftën e tij... Schmitt tregon shumë vëmendje edhe për mënyrën sesi i qaset diskursit historik, publicisti Fatos Lubonja...*

ion politik. Duke pasur parasysh në mendje këtë përvojë, shumë njerëz ende nuk mund të imagjinojnë se kërkimi historik është bërë diku tjetër në kushte krejt të ndryshme.

Gjatë katër viteve kam pasur mundësi të mbaj leksione në Prishtinë dhe Tetovë dhe kam diskutuar me studentë, kolegë dhe shumë njerëz që kam takuar gjatë vizitave të mia në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Kemi diskutuar hapur edhe për teoritë e konspiracionit të cilat qarkullojnë nga politikanët dhe gazetaret në Shqipëri dhe faktin që shumë tema të debatit publik nuk kishin asfarë lidhje ose vetëm një lidhje të paqartë me përmbajtjen e librit. Në këto takime personale, përvoja ime gjithmonë ka mbetur pozitive - kryesisht për shkak të faktit se mund të tregojë se libri im shikon te Skënderbeu një figurë historike vërtet mbresëlënëse dhe e përshkruan atë si një aktor kryesor në historinë e vonë evropiane mesjetare dhe se kurrë nuk kam shkruar se Skënderbeu është me origjinë të pastër serbe. Unë mund të përsëris edhe një herë se kjo është



të një shpikje dhe jo një tezë e librit tim.

Në fakt, debati tregoi se shumë njerëz diskutuan për një libër që ata nuk e kishin lexuar kurrë - një fenomen që sigurisht nuk është unik apo specifik për Shqipërinë dhe mund të vërehet edhe në shumë raste të tjera. Në retrospektivë, besoj se debati kishte të bënte më shumë me dinamikën

politike, interesat partiake dhe interesat personale sesa me një debat mirëfilli shkencor rreth përmbajtjes dhe interpretimeve shkencore”.

**A keni pasur ndonjë ftesë nga autoritetet shqiptare për festimet mbi Skënderbeun?**

“Unë jam ftuar, për fat të keq, vetëm tre javë para kremtimit, për të marrë pjesë në përkujtimin e Skënderbeut më 17 janar”.

**Në librin tuaj, Skënderbeu është shumë njerëzor dhe merr përmasa humane, që e bëjnë të dashur dhe shumë të prekshme si figurë. Në parathënien flitet për rindërtimin historik mbi bazën e gjithë burimeve të shfrytëzuara dhe me peshë. A ishte një nga qëllimet për ta ç’mitizuar Skënderbeun?**

“Ky përbën një nga keqkuptimet kryesore të të gjithë debatit. Libri ka për qëllim rindërtimin e figurës së Skënderbeut në Mesjetë dhe nuk synon dekonstruktimin e mitit historik, që natyrisht përbën një fenomen mbresëlënës i kulturës shqiptare. Natyrisht, lex-

uesit janë të lirë të nxjerrin përfundime dhe të bëjnë interpretime të librit në kuadër të debatit për mitet kombëtare, madje një debat i cili zhvillohet edhe në shumë vende evropiane dhe kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për krijimin e një kulture demokratike në Shqipëri. Debatit në vitin 2008/2009 tregoi sesa të forta janë strukturat autoritare të cilat rrjedhin nga e kaluara totalitare që ende ndihet në Shqipëri. Gjatë dhjetë viteve të fundit, për fat të keq nuk ka pasur ndonjë përmirësim të dukshëm të kësaj situatë.

Për shkak të ndikimit të madh të historiografisë Enveriste dhe mungesës së një tradite jo-Enveriste të sistemit të institucionalizuar shkencor, shumë njerëz s’kishin dhe ende nuk kanë dijeni për mekanizmat e debateve shkencore në botën perëndimore, por ndjehen menjëherë të ofenduar nga interpretimet që ata nuk i njohin dhe të cilat ata nuk i kanë mësuar në shkollë. Ideja që historianët nuk janë studiues të paguar nga universitetet e tyre, por agjentë të paguar nga qeveritë janë ende të përhapura dhe nxiten nga

ata që shkruajnë në këtë kuptim libra të tërë të shpikura me spekulime, pa asnjë provë - dhe duket se ka lexues që janë më të përgatitur për të besuar teoritë e pabaza se sa për të reflektuar në mënyrë kritike mbi mekanizmat e debatëve publike në Shqipëri. Kjo është gjithashtu një trashëgimi e së kaluarës totalitare dhe pjesërisht edhe pasojë direkte e përfshirjes së historianëve në jetën politike".

**Dokumentet që ju keni sjellë, por edhe ata që e kanë trajtuar Skënderbeun para jush, tregojnë për një figurë historike me shumë qasje. Mendoni se ka ende shumë dokumentacion të pazbuluar për Skënderbeun dhe sa mund të ndikojnë në të ardhmen në pasqyrimin e tij?**

"Me aq sa kam mundur të shoh, pas më shumë se 150 vjet hulumtimeve sistematike në arkivat evropiane, është disa e pamundur që të zbulohen njësi kryesore arkivore; Nuk mund ta gjykoj situatën e arkivave osmane, por përveç regjistrave tatimorë dhe kronikave, ka shumë pak dokumente të veçanta që i drejtohen drejtpërdrejt Skënderbeut. Kjo nuk përjashton mundësinë e zbulimeve, kryesisht të dokumenteve të veçanta që i përkasin shekullit të 15-të; por ata do të mund të na vijnë kryesisht nga rastet. Nuk duhet të harrojmë se arkivat e rëndësishme si ato të Romës, Venecias (ose: Venedikut) dhe Napolit, të cilat janë vendimtare për Skënderbeun, përsuan humbje të mëdha (në shekullin e 16-të, në Napoli në vitin 1943), kurse arkivat mesjetare në Shqipëri dhe në zonën përreth (me përjashtim të arkivit në Dubrovnik) janë pothuajse tërësisht të zhdukur. Ndërsa dokumente të reja që lidhen me formësimin e jetës së Skënderbeut do të jenë të rralla, hulumtimet mbi burimet që lidhen me kohën e pas vdekjes së tij do të vazhdojnë, kjo dhe për shkak të famës së tij evropiane, pasi ka shumë librez dhe botime të tjera nga periudha e hershme moderne (shek XVI-XVIII) dhe nga shek. XIX që presin të zbulohen. Por shumica e tyre do të mbështeten kryesisht në Barleti si burim dhe prandaj nuk do të mund të ofrojnë dëshmi të reja".

**Cilat janë segmentet e jetës së tij, të cilat janë më të dokumentuara?**

"Është e qartë: periudha kur ai erdhi në kontakt të ngushtë me botën italiane dhe kur u bë figurë e rëndësishme në politikën evropiane dhe jo thjesht biri i një fisni-ku rajonal, i cili shërbeu në ushtrinë osmane. Kjo është arsyeja pse në dimë shumë për vitet e tij të fundit dhe pse deri në 1443 burime janë kaq të pakta".

**Juve e vlerësoni shumë personalisht si figurë Skënderbeun, ndërkohë që teza juaj për fillimin dhe motivin e hakmarrjes së tij ka bërë që disa nga studiuesit shqiptarë ta shikojnë këtë tezë si të vjetër dhe të paqenë. A i qëndroni sërish kësaj teze?**

"Po. Por më lejoni të përsëris atë që kam shpjeguar në librin tim: domethënja se kryengritja kishte disa motive që janë kryesisht strukturore: rezistenca kundër sistemit fiskal dhe të drejtësisë osmane, kundër sundimit të drejtpërdrejt osman; në fakt, motive që në mund t'i zbulojmë edhe në shumicën e kryengritjeve kundër sundimit osman deri në vitin 1912.

Vetëqeverisja, mos dhënia e taksave, ruajtja e traditave ligjore rajonale janë kërkesat e zakonshme klasike të shqiptarëve nën sundimin perandorak osman. Në vitin 1443, udhëheqësi i kryengritjes kishte gjithashtu një motiv personal të hakmarrjes. Por ky motiv nuk shpjegon të gjithë kryengritjen, megjithëse shumë njerëz që nuk e kanë lexuar librin ende vazhdojnë dhe e pretendojnë këtë. Pra, ekzistonte një kombinim i ndërlikuar i motiveve".

**Emri në kohën e Mesjetës nuk tregonte fare prejardhjen etnike, por disa ndikimin kulturor të kohës. Në familjen e Skënderbeut kemi lidhje martesore me princa sllavë dhe nënën e tij nga Pollogu. Si jetonin dhe bashkëpunonin në shekullin e XIV dhe XV etnitë në Ballkan?**

"Në fund të periudhës së Mesjetës, ekzistonte një rrjet i fortë ortodoks i lidhjeve farefisnore në Ballkan. Politikisht, Bizanti ishte i dobët, por ideja perandorake ishte e gjallë, ashtu si dhe prestigji i fuqisë bizantine-ortodokse. Dallimi gjuhësor ose etnik nuk luajti një rol të madh për elitat sociale. Ashtu si në pjesët e tjera të Evropës, fisnikëria ishte me prejardhje multi-etnike dhe sa më i rëndësishëm ishte për mjedisin një fisnik, aq më të zgjeruara dhe multi-etnik do të ishte rrjeti i tij i farefisnisë. Ideja e pastërtisë etnike thjesht nuk ekzistonte në këtë mjedis të elitës.

Sigurisht që nuk kishte asnjë antagonizëm etnik midis sllavëve (ortodoksë dhe katolikë, serbëve, bullgarë dhe kroatë / dalmatë - nuk kishte asnjë bllok sllav as në atë kohë e as më vonë) dhe shqiptarëve - të cilët as nuk përbënin një entitet kompakt etnik dhe sigurisht nuk vepronin si të tillë: shqiptarët katolikë nga Shkodra, Dukagjinet dhe shqiptarët e islamizuar luftuan kundër Skënderbeut; shumë shqiptarë ortodoksë në Jug nuk u bashkuan me kryengritjen e tij, ndërsa sllavet e jugut dhe vllahët mund të gjenden midis mbështetësve të tij".

**Ka domethënie varri i vllait të Skënderbeut në Hilandër, në manastirin serb në Malin Athos?**

"Ajo tregon lidhjen e familjes me traditën bizantine-ortodokse dhe vullnetin e saj për të shprehur pozitën e saj politike dhe shoqërore në një vend simbol të besimit ortodoks. Fakti që Kastrioti zgjodhi Hilandarin lidhet me rrjetin e tyre të lidhjes dhe të pushtetit në një zonë (Dibër) që ishte që nga fillimi i shek XIV nën sundimin e kurorës serbe".

**Nëse do flasim për një lloj strukture shtetërore që arriti Skënderbeu, a është e mundur të flasim për mekanizmin ekonomik që e mbante këtë strukturë?**

"Sistemi i pushtetit të Skënderbeut u financua nga tregti, nga eksporti kryesisht i grurit dhe i drurit, nga subvencionet prej fuqive italiane, nga plaçkitja e bastisjet në territoret osmane; Skënderbeu kishte një deponitë bankare në Dubrovnik dhe kështu kishte qasje në sistemin bankar mesdhetar".

**Aktiviteti i Skënderbeut është i shtrirë në shekullin XV. Është një nga shekujt më interesant për qytetërimin. A mendoni se përfshirja e tij në këtë shekull me**

**Fatos Lubonja ka bërë shumë për analizimin e shoqërisë shqiptare**

Intelektualët si Fatos Lubonja kanë bërë shumë më tepër për analizimin e shoqërisë shqiptare se pothuajse të gjithë historianët profesionistë në Shqipëri dhe Kosovë së bashku - për të mos folur për kontributin e tij të rëndësishëm në zhvillimin e një fryme kritike në Shqipëri. Lubonja është një intelektual tejet i vlerësuar ndërkom-bëtarisht ndërsa kundërshtarët e tij janë pothuajse fare të panjohur jashtë Shqipërisë.



"Skënderbeu", Spiro Xega

**Dokumentat e tjera për Skënderbeun mungojnë...**

Me aq sa kam mundur të shoh, pas më shumë se 150 vjet hulumtimeve sistematike në arkivat evropiane, është disa e pamundur që të zbulohen njësi kryesore arkivore; Nuk mund ta gjykoj situatën e arkivave osmane, por përveç regjistrave tatimorë dhe kronikave, ka shumë pak dokumente të veçanta që i drejtohen drejtpërdrejt Skënderbeut. Kjo nuk përjashton mundësinë e zbulimeve, kryesisht të dokumenteve të veçanta që i përkasin shekullit të 15-të; por ata do të mund të na vijnë kryesisht nga rastet. Nuk duhet të harrojmë se arkivat e rëndësishme si ato të Romës, Venecias (ose: Venedikut) dhe Napolit, të cilat janë vendimtare për Skënderbeun, përsuan humbje të mëdha (në shekullin e 16-të, në Napoli në vitin 1943), kurse arkivat mesjetare në Shqipëri dhe në zonën përreth (me përjashtim të arkivit në Dubrovnik) janë pothuajse tërësisht të zhdukur.



Përkrenarja e Skënderbeut

**më shumë prej ndërkom-bëtarëve do e ndihmonte përmasën e vërtetë të kësaj figure?**

"Shekulli i 15 ishte periudha e një ndryshimi të madh në Ballkan

dhe kërcënimi osman sigurisht, fakt që e shtoi rëndësinë strategjike të Ballkanit për Evropën Qendrore dhe Perëndimore. Kjo e shpjegon interesin e madh të udhëheqësve politikë dhe opinionit të Perëndimit të periudhës së vonshme mesjetare për Skënderbeun, i cili konsiderohej si aleat politik dhe simbol i rezistencës së krishterë kundër valës osmane. Përveç dijetarëve Enveristë, të cilët qëndrojnë të ngulur me një paradigme ahistorike izoluese, shumica e studiuesve janë përpjekur të analizojnë Skënderbeun në një kuadër më të gjerë të dimensioneve evropiane dhe mesdhetare".

**Teoria e biografisë sot jep modele interesante të narracioneve me vështrimet analitike historike. A mendoni se e keni arritur këtë në rrëfimin tuaj historik për Skënderbeun?**

"Ka një debat të sofistikuar sa i përket biografisë si një zhanër letrar dhe zhanrit akademik me të cilin unë vetë jam shumë familjar. Unë nuk ndalem në mënyrë të veçantë në këto teori në librin tim, por lexuesi do të gjejë në të një diskutim të detajuar të metodave dhe burimeve, që kam përdorur".

**Çfarë sfidash e presin në të ardhmen ndriçimin e figurës së Skënderbeut?**

"Nëse ju nënkuptoni me fjalën ndriçim, interpretime të reja shkencore, unë jam mjaft skeptik sepse janë paraqitur shumë argumente deri më tani në gati më shumë se 150 vjet hulumtime.

Skënderbeu, megjithatë, do të vazhdojë të jetë pasqyrë e debatëve të identitetit në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në vendet përreth. Aktualisht, ka disa interpretime, Enveriste, nacionaliste rilindase, evropianiste, Kristiane (katolike dhe ortodokse), Muslimane dhe Islamiste, të gjitha këto pak a shumë kanë shprehur një tendencë autoritare; tendenca e dytë kryesore është një interpretim kritik dhe liberal që dekonstruon modelet ideologjike shtypëse të cilat qëndrojnë prapa qasjeve të përmendura më lart.

Fatkeqësisht, zërat liberalë kishin një qasje të vështirë në vitin 2008 dhe debati që duket se po fillon përsëri tregon se ndërkohë nuk ka pasur ndryshime të mëdha, të paktën në nivelin e elitave politike dhe kulturore. Për

fat të keq, asgjë e re nuk po duket nën diellin ku jetojmë.

Ende ekziston pretendimi se vetëm historianët profesionistë mund të komentojnë mbi Skënderbeun, porse intelektualë me profil të lartë, jo, Kjo është gjithashtu një trashëgimi e kohës së Enverizmit: historianët me siguri kanë një trajnim profesional, aplikojnë një metodologji shkencore dhe teori. Por ata nuk mund të jenë administratorë ekskluzivë ose pronarë të së kaluarës dhe nuk kanë të drejtë të përjashtojnë intelektualët nga debati publik. Kjo është në kundërshtim me kulturën e debatit publik në botën demokratike.

Më lejoni të shprehem qartë: Intelektualët si Fatos Lubonja kanë bërë shumë më tepër për analizimin e shoqërisë shqiptare se pothuajse të gjithë historianët profesionistë në Shqipëri dhe Kosovë së bashku - për të mos folur për kontributin e tij të rëndësishëm në zhvillimin e një fryme kritike në Shqipëri. Lubonja është një intelektual tejet i vlerësuar ndërkom-bëtarisht ndërsa kundërshtarët e tij janë pothuajse fare të panjohur jashtë Shqipërisë.

Mendoj se "viti i Skënderbeut" do të tregojë deri në çfarë shkalle Shqipëria është e aftë të struktur-ojë dhe tolerojë një debat, ku mund të dëgjoen zëra të ndryshëm - ose nëse debati do t'i përcjellë mesazh Shqipërisë dhe botës së jashtme që strukturat autoritare dhe trashëgimia totalitare jo thjesht po zgjat, por mbi-zotëron ende në mendjen e krijujesve të opinionit. Fillimi i debatit për fat të keq tregon edhe kahun e drejtimit të mëtejshëm.

Dikush mund të pyesë gjithashtu nëse debati i tepërt (pasi shumica e argumenteve janë shkëmbyer shumë herë, herën e fundit në 2008/09), i cili është iniciuar nga qeveria, nuk e devijon vëmendjen e publikut nga pyetje të rëndësishme që Shqipëria duhet ta trajtojë: sundimi i ligjit, forcimit e institucioneve, përmirësimin e kulturës demokratike, lirinë e mediave, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, zhvillimin e ekonomisë dhe mbi të gjitha perspektivat për brezin e ri me qëllim që të ndalojë largimin e trurit dhe emigrimin.

Evokimi i krenarisë kombëtare dhe e lavdërimit të heroit kombëtar në një mënyrë që nuk ka të bëjë fare me hulumtimet dhe debatin shkencorë është në pikëpamjen time kryesisht një program politik - jemi dëshmitarë të valëve të reja të nacionalizmit në Ballkan, një autoritarizëm i ri që po shfaqet gjithashtu në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë duhet gjithashtu të pyesin pse politikanët fillojnë një debat për Skënderbeun dhe çfarë do të thotë me të vërtetë ky diskutim për Shqipërinë moderne".

**Me çfarë po merret në ditët tona studiuesi Oliver Schmitt?**

"Që nga korriku 2017, unë jam Presidenti i Sektorit të Shkencave Humane dhe Sociale dhe gjithashtu anëtar i Kryesisë së Akademisë Austriake të Shkencave. Unë jam përgjegjës për departamentin e krijuar kohët e fundit të studimeve të Ballkanit në Akademi, i cili fokusohet në studimet shqiptare. Për momentin po mbaroj një botim të raporteve konsullore Austro-Hungareze mbi vilajetin osman të Kosovës dhe vitet e para të okupimit serb (1870-1914) në pesë vëllime".

## P

## POEZIA

*Akademia Europiane e Shkencave Arteve dhe Letërsisë (Académie Européenne des Sciences, des Arts et des Lettres, AESAL) ka dhënë ditët e fundit, në kuadër të një aktiviteti multidisiplinor kulturor-shkencor çmimet vjetore në disa kategori. Një nga çmimet, titulluar "Taras Shevçenko", ka shkuar për poetin shqiptar Agron Tufa...*

## Për pjesëmarrjen shqiptare

Akademia Europiane e Shkencave Arteve dhe Letërsisë (Académie Européenne des Sciences, des Arts et des Lettres, AESAL), me resedencë në Paris, është një organizatë jopolitike, e krijuar në vitin 1980 dhe që përfshin brenda saj mbi 300 anëtarë të Akademive Kombëtare, 72 laureatë të çmimeve NOBEL prej 54 vendeve. Qëllimi i AESAL është që në interes të Paqes të mundësojë bashkëpunimin ndërmjet kombeve në fushën e arsimit, shkencës, artit dhe letërsisë jashtë varësisë nga dallimet racore, nacionale, gjuhësore, religjioze dhe dallime të tjera.

Akademia Europiane e Shkencave, Arteve dhe Letërsisë bashkëpunon me UNESCO-n, akademitë nacionale dhe me struktura të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Veprimtaria përfshin hulumtimet shkencore, kërkimet teorike, organizime

konferencash, publikime ligjëratorash. Mban simpoziume të përvitshme ndërkombëtare.

Qëllimi zanafillor i Akademisë është hedhja e urave ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes (në radhë të parë me ish-BRSS-në). Në kohën e sotme Akademia bashkëpunon gjerësisht me përfaqësuesit e Amerikës, Afrikës, Azisë, Oqeanisë, e në mënyrë që ta kuptojë e realizojë më mirë rolin e Europës në botë.

President i AESAL aktualisht është profesori i merituar i fizikës se Kolegjit Mbretëror të Londrës - Zhan-Patrik Konrad (Jean-Patrick Connerade), i cili ka qenë më parë president i Euroshkencës. President i parë i AESAL ka qenë profesor Rejmond Dodel (Raymond Daudel) — ish bashkëpunëtor i Irene Zholiu Kyri, nxënës i Lui de Brojli. Ai e pati udhëhequr Akademinë deri në ditët



Agron Tufa

e tij të fundit më 2006.

Iniciativa e krijimit të Akademisë (1973) i takon doktor Nicol Lemer d'Araxhio-s (Nicole Lemaire d'Agaggio), e cila sot është sekretare e përgjithshme e Akademisë që nga koha e krijimit. Akademia shpërndan çmime vjetore nga të gjitha fushat e shkencës, artit, filozofisë dhe Letërsisë.

Aktiviteti poetik u zhvillua në kualifikime në katër kategori. Poezitë e Agron Tufës ishin prezantuar nga poeti kosovar Jeton Kelmendi, ndërsa ishin përkthyer nga Ardian Marashi dhe Edmond Tupja. Me sakte ato poezi i pati dërguar poeti nga Kosova Jeton Kelmendi. Në përfundim, një nga çmimet e kësaj kategori, dhe pikërisht ai me titullin "Taras Shevçenko", shkoi për poetin shqiptar.

## Sonet

S'do të të flas më me gojë, ty o pyetje-përgjigje!  
O, mbliidheni, mbliidheni vesën në agim!  
Cip më cip manaferra, tejpartej luleshtry  
dhe bulurijnë, regëllinë gjakut tend, gjakut tim.

Jam shigjeta që rend në mollë aguridhe -  
energji e dështuar në takt, keqkuptim. O,  
mbliidheni, mbliidheni vesën në agim! Gjysma  
jole - pyetje, gjysma ime - përgjigje.

Je meze e lashtë gatuar me frikë.  
O mbliidheni, mbliidheni vesën në agim!  
Pulpët e tua - makthi i pezulluar në grykë -

filozofi e dështuar në takt, keqkuptim:  
dhe terr edhe dritë të bie si prikë, -  
O, mbliidheni, mbliidheni vesën në agim!

Peshkopi, 1990

## Aty te portat Skee

Portat e qytetërimit tend do të hapen  
me dëshirë që përposh fsheshin dash  
Tejçohet dhe imuniteti i prëkjes me

## Llogari trupore

Ngado që të shkoj, prapa më ndjekin  
rrefime të nxehta për kurmin tend.  
Është ai tjetri që rrefen.  
Në tavolinën përballë.

Ai tjetri ka shtrirë trupin tend të zhveshur tek  
feks mbi tavolinë si "Rruga e Oumëshitil".  
Tashmë ai tjetri,  
l'i shpleks në vijë lineare  
e një për një l'i numëron  
nishanet e tua si shifer e pafundme me presje  
dijetore.

Filxhani i kafesë drejtuar nga një nxjerr tym të  
zi si grykë  
e shkrehur kobureje

## Pikërisht

E kam të pamundur me ty.

Këtë ma ke thënë  
Këtë ma kanë thënë  
Këtë edhe vetë e di  
Se kështu thone  
Arsyeja  
Logjika  
Matematika

## SONNET

Je n'ai que faire de toi, ô question-réponse! Ô,  
cueillez, cueillez la rosée du matin!  
D'innombrables mûres, de merveilleuses  
fraises Refleurissent, mugissent dans ton sang,  
dans le mien.

Je suis la flèche qui vise les pommes vertes, -  
Énergie déçue, malentendu divin.  
Ô, cueillez, cueillez la rosée du matin!  
Ta moitié - question, ma moitié - réponse.

Tu es de la vieille sauce cuisinée à la peur  
Ô, cueillez, cueillez la rosée du matin!  
Tes mollets - angoisse suspendue à mon coeur -

Philosophie déçue, malentendu divin:  
Et l'ombre et la lumière sont les grandes soeurs,  
-O, cueillez, cueillez la rosée du matin!

## LÀ, AUX PORTES SKAIES

Les portes de ta civilisation céderont  
Aux béliers chachant par-dessous des amoureux...

## DES COMPTES PHYSIQUES

Où que j'aille me poursuisvent  
des ragots emballés au sujet de ton corps. C'est  
l'autre qui raconte.  
Celui de la table en face.

Il vient de coucher sur sa table ton corps  
dénudé qui scintille comme de la chair de Voie  
Lactée. L'autre, déjà,  
étale de manière linéaire sur sa  
table en les comptant un par un  
tes grains de beauté alignés à l'infini  
derrière la virgule du chiffre.

La tasse à café dirigée vers moi fume  
noir comme un canon de revolver.

## JUSTEMENT

Il m'est impossible de continuer avec toi.

C'est ce que tu m'as dit  
C'est ce que l'on m'a dit  
C'est ce que je sais moi aussi  
Puisque c'est ce que disent  
La Raison  
Logjika  
La Mathématique.



## Il t'est impossible de continuer avec moi.

C'est ce que je t'ai dit  
C'est ce que l'on t'a dit  
C'est ce que tu sais toi aussi  
Puisque c'est ce que disent  
La Raison  
La Logique

Mais je ferai mon impossible  
Pour toi justement  
Puisque justement je te l'ai dit  
Puisque justement tu me l'as dit  
Puisque justement on me l'a dit Puisque  
justement nous les savons nous-mêmes

Puisque justement c'est ce que disent  
La Raison  
La Logique  
La Mathématique...

Puisque justement je t'aime  
tel point que le compte perd son

équilibré. 1990

## L'ORIGINE DE LA PENSÉE

Y a-t-il donc une justification de la pensée ? C'est-à-dire,  
// y a-t-il quelqu'un (homme ou forme raisonnée) qui  
puisse la justifier ? // Quand est-elle apparue pour la  
première fois, qu'était-elle avant l'instant donné la pensée  
nue, ayant une signification pour tous... ? // La pensée-  
sentiment, la pensée-idée, la pensée-existence  
-/ celle qui constitue les Vérités Supérieures, celle qui  
donne la joie ou la peur, celle qui observe, qui surveille,  
qui guide, qui fait la recherche - // la pensée déclinée en  
identités, la pensée qui fait mal ? // Comment est-elle  
apparue ? D'où est-elle venue ? Dans quel but ? De quoi  
vit-elle ? // Et encore, que seraient les

## E ke të pamundur me mua

Këtë ta kam thënë  
Këtë ta kanë thënë  
Këtë edhe ti e di  
Se kështu thone  
Arsyeja  
Logjika

Po unë do të bëj të pamundurën  
Pikërisht me ty  
Pikërisht ngaqë të kam thënë  
Pikërisht ngaqë më ke thënë  
Pikërisht ngaqë ma kanë thënë  
Pikërisht ngaqë edhe vetë e dimë  
Pikërisht ngaqë thone  
Arsyeja  
Logjika  
Matematika...

Pikërisht ngaqë të dua deri në atë pikë  
Ku llogaria humbet ekuilibrin.

Peshkopi 1990





**...NGA NUMRI I SHKUAR**  
 "Milosao" e këtij numri mund të konsiderohet e zakonshme. Ishte interesant shkrimi i profesor Bardhyl Demiraj për një jezuit kroat dhe kontributi i tij për Zojën e Shkodrës, që e konsideruam për shkrim kryesor, i cili duhet thënë se ngriti disi peshën e numrit. Bardhyl Demiraj bën trajtesa shumë interesante por nga ana tjetër në lëmin e vet shquhet për shumë këndshmëri sa i përket gjuhës shqipe. Ka një leksik të këndshëm që e ndërthur me fjalët e vjetra dhe ato të arealit të shqiptarëve të Italisë, që i jep temave vërtetë shumë jetë. Vincenzo Basile-n (S.J) është i njohur në enciklopedinë kroate si mecenai i letërsisë ekleziastike kroate. Është i pari

që shkruan shqip për kultin e Zojës së Shkodrës, afresku i së cilës "fluturoi" më 25 prill 1467 në Genazzano e nderohet gjithkund në botë si "Zoja e Këshillit të Mirë".  
 Sadik Bejko kishte ditë të tëra që mëtonte të sillte një shkrim për poetin e ndërjet Basri Çapriçi. Shkrimin e solli shumë vonë dhe shoqëruar me një triptik opinionesh për poetin Çapriçi. Mوند të ishte pak më i thukët dhe ta trajtonte ndryshe, por edhe këstu ishte shumë i ndërjet.  
 Ylli Polovina boton në linjë librin e tij të dytë, kushtuar nacionalizmit dhe në kuadër të trajtesave të tij të vazhdueshme publicistike, zgjodhëm një pjesë të tij.  
 Në kuadër të ditëlindjes së sh-

krimtarit të njohur, Ismail Kadare, studiuesi Mehmet Elezi na ka përcjellë një shkrim kushtuar "Prillit të thyer". Me skemën e përshtatur vepra bëhet më tërheqëse, thellësisht tronditëse. *Përmasat e dramës rriten rrungajtë, shkojnë shpërthyeshem deri në kufijtë e një tragjedie të krahasueshme me epidemitë shtaruese.* Po të përdorim një shprehje të autorit nga sprova për *Eskilin, fataliteti rri sipër gjithçkaje si një diell i ftohtë, prej të cilit nuk shpëton dot. Pa fatalitetin e këtij dielli të ftohtë, me gjithë gjënjë shekspiriane të Kadaresë, nuk mund të jesh i sigurt nëse Prilli i Thyer do të dilte më shumë se Prilli i Thatë, shkroi ai.* Po të ishte pak më i përmbledhur do të ishte shumë më i

kapshëm për publikun.  
 Në këtë numër patëm dhe një cikël nga Shimborska që na e solli doktor Pandeli Çina, një përkthim nga origjinali, por që duhet të kishin pak më shumë prej muzikalitetit të zonjës së poezisë.  
 Në të njëjtën ditë kishte ditëlindjen dhe gjuhëtari ynë Xhevat Lloshi që na u përcoll nga një prej drejtuesve të Institutit të Studimeve Protestante David Hosaflock. Redaktori pati vend vetëm për parathënien...  
 Në përgjithësi numri ishte disi patetik, por që u rregullua falë Zojës së madhe të Shkodrës. Lay-out punoi me shumë forcm dhe pa shumë dashuri për numrin.

ORIGJINA E MENDIMIT

A ka valle një të drejtë për mendimin? Domethënë, // a del dikush (njeri a trajtë arsyetuese) ta përligjë? // Kur u shfaq për së pari, çfarë ishte para çastit të dhënë mendimi i zhveshur, me kupim për të gjithë...? // Mendimi-ndjenje, mendimi-ide, mendimi-ekzistencë - // ai, që përbën të Vërtetat e Epërme, që dikë gëzon, tremb, ai që vëzhgon, survejon, udhëheq, bën shkencë - // mendimi i lakuar ndër identitete, mendimi që dhemb? // Si u shfaq? Nga erdh? Me ç'qellim? Si mbahet gjalle? // Si dhe çfarë do të ishin qeniet pa mendim? Cila vallë // është ajo shigjetë që çan eterin neutral të Hiçit // me trajektoren e vet për t'u ngulur në Qellim?  
 Cili është harku vetë? Kush e tendosi? Midis "Dicit" // dhe "Hiçit" - trajektorja e lëshuari Me ç'paramendim? // Çfarë kushtesh lyp mendimi? Çfarë synimi? // si do të mishërohej ai, nëse nuk do të kishte bartës të gjallë? // Mos është mendimi pjeke e energjisë dhe evolucioni mbi kushtet, // përshatja, ruajtja dhe transformimi i drejtpeshimit mbi to? // Mos është thjesht, përvojë, sintezë përvojash, pushtet? // Mos është varësi? Kompromis për të zgjatur kushtet? Jo! Jo! Jo! // Mendime ka ngado! Mendimi bun në bartës! // Sa janë të një mendjeje? A nuk vdes dhe mendimi tok me ta? // Domethënë, mendimi-shpëtimtar, mendimi-vrasës? // Sa vdesin valle duke e varrosur edhe mendimin? // ç'bën mendimi në var? // Si ta mishërojë pa mish mishërimin? // A zhdukët mendimi? Duket: është më i fortë se biologjia? // Mendimi ia ha xhanin njeriut, e detron ta nxjerrë // pjesë-pjesë, para se ky të vdesë... Dhe ndjehet si të Shtëpia // e Perjetshme: gojdhana, rrefenjash, në letër - i pa bjerrë... // Mendimi bredh - si kurvë ta dredh: aty është, aty zhdukët // dhe ti, vret mendjen që s'e ke: ai kukafshethi struket // e nganjëherë të lë, siç të burri gruan e tij, të ndarë: // në fakt shkollon të lërë dikë tjetër me barrë, ndërsa ty - të marrë! // Por ndodh shpesh që mendimi t'i hyjë të ftohtët, ankthi, frika - // mendimi shkëputur konvulsesh, nuk e zë kurmi që e ndrym: këto, rëndom, i quajmë "mendime të liga", // dhe vijmë mendime të tjera ku mendimi mendimin shpyn // gjersa ta asgjësojë fare. Shpesh mendimi për mendimin është ujë. // Mendimi riprodhon vetveten, siç riprodhon një vreshtar a një bujk // varietete të reja me shermen të vjetra. Ateherë merr turr // mendimi i papritur, i panjohur, mendimi-kentaur // që lidh skajet e kundërta dhe mbi rregullat merr hak - // mendimi-tranvestit, mendimi-hermafrodit, mendimi-afrodiziak. // Mandej vjen me i tmerzshmi - mendimi në shmag, mendimi-asket: kur rrugën i zënë, ai si akrep ngre thumbin dhe vetveten vret. // ...Ja se si iken mendimi! Herë firas, herë mësyn - tërmet. // Ti e ndjek i bindur. Pse? Sepse mendimi është vullnet? // çfarë është mendimi? Kush e tendosi Harkun? E kujt është Shigjeta? // Pse i duhet mendimit gjuha? Pse nuk i mjafton as ajo // me gjithë simbolet, analogjitë, metaforat, alegoritë? Ku qëndron e Vërteta? // Kush fshihet prapa Harkut? Cila Domosdo? // Dhe nëse s'do të kishte Bartës që mendimin ta bartin // në legjenda, memorie, letër (siç po bëj dhe unë), // cili do të ishte fati i tij, me cakun, progresin, afatin? // Dhe kush do të ishte në gjendje ta shuante? Cila dhunë? // Po unë, një Bartës që fale tij i shkruaj këto radhë, // që fale tij i hap udhë njëfarë kuplumi me mendimin-pandehmë, // edhe këto pak pyetje i bëj fale një rastiesie plus-minus njëzete gradë, // ndryshe, fale Atij pas Harkut që mund të mos leshtonë asnjë shigjetë...

étrés sans la pensée ? Quelle est donc // la flèche perçant l'éther neutre du Néant // pour terminer sa trajectoire droit dans le But ? Et l'arc lui-même, c'est quoi ? Qui le maintient tendu ? Entre le "Queleque chose" // et le "Néant" la trajectoire s'étire ! Dans quel dessein ? // Quelles conditions lui sont profitables ? Quel objectif ? // Comment se réincarmerait-elle s'il n'y avait pas de supports vivants ? // La pensée ne serait-elle pas de l'énergie morte et une évolution sur les circonstances, // l'adaptation, la préservation et la transformation de l'équilibre qui en résulte ? // Ne serait-elle pas tout simplement de l'expérience, une synthèse d'expériences, pouvoir ? // Serait-elle dépendance ? Un compromis pour maintenir en vie ces mêmes circonstances ? Non ! Non ! // Il y a des pensées partout ! La pensée habite ses hôtes ! // N'ont-ils pas tous la même pensée ? La pensée ne meurt-elle pas avec eux ? // C'est-à-dire, la pensée salvatrice, la pensée meurtrière ? // Combien ne meurent-ils pas en emportant leur pensée avec eux ? // Que fait la pensée dans une tombe ? Comment incarnera-t-elle, sans chair, l'incarnation ? // La pensée disparaît-elle ? // Elle apparaît : elle est plus puissante que la biologie ! // La pensée rongé l'âme, elle oblige l'homme à rendre son âme // peu à peu, avant qu'il ne meure... Et il se sentirait comme dans son chez-lui // éternel : mythes, légendes à la carte - indéfectible... // La pensée erre, elle se joue de tout : elle est là où elle n'est pas // et alors vous avez une façon de penser sans pensée, vous êtes perdants au jeu du cache-cache // aussi vous abandonne-t-elle à un moment, comme la femme son mari : c'est le divorce // en effet, elle va se faire féconder par quelqu'un d'autre, tandis que tu pètes les plombs ! // Mais il arrive souvent que la pensée ait froid, qu'elle ait peur, qu'elle soit anxieuse - // la pensée est prise de convulsions, elle déteste le corps qui la retient : celles-là on les appelle d'habitude "de mauvaises pensées", // et d'autres pensées se succèdent en se repoussant les unes les autres // jusqu'à ce qu'elles s'éliminent. Souvent la pensée est un loup pour la pensée. // La pensée se reproduit elle-même, comme un vigneron ou un agriculteur reproduisent // de nouvelles variétés sur la base d'anciens sarments. S'élançent alors // la pensée subtile, secrète, la pensée-centaure // qui relie les extrêmes en se vengeant des règles établies - // la pensée-travestie, la pensée-ascète : si on lui coupe le chemin, tel un scorpion, elle se morfond et se mord elle-même. // ...Voilà comment marche la pensée ! Maintenant elle t'assaille, maintenant elle te déserte. // Vous la suivez docilement. Pourquoi ? Car la pensée est volonté ? // c'est quoi la pensée ? Qui a tendu l'Arc ? A qui est la Flèche ? // En quoi la pensée a-t-elle besoin du langage ? Pourquoi ne lui suffit-il pas // malgré tous les symboles, les analogies, les métaphores, les allégories ? Ou se trouve la Vérité ? // Qui se cache derrière l'Arc ? Quelle Nécessité ? // Et s'il n'y avait pas d'Hôte pour porter la pensée // sur des légendes, des mémoires, du papier (comme je le fais), // quel destin aurait-elle eu par rapport à la limite, au progrès, au sursis ? // Et qui serait en mesure de l'éteindre ? Quelle Violence ? // Et moi, simple Hôte, qui grâce à elle peux écrire ces lignes, // qui grâce à elle peux ouvrir une voie au sens hypothétique, // ces maigres questions je ne les pose que grâce au concours de certaines conjonctures de plus-moins vingt degrés Celsius, // autrement grâce à Celui qui se tient derrière l'Arc et qui aurait pu ne lancer pas une seule flèche...

Traduit par Ardian MARASHI



Ty të kujtohet qielli i tjetër : i gjerë e i huaj : turma e të panjohurve në rrugë, automobilët... dhe dëbora e pjerrët - mbulon pothuaj si vual pikëlor zhurmat, pamjet, stinët - po me së pari - kurmet lakurik, të bardhë të të dashurave të trishia.  
 Ç'u be me to valle? Ku shkoi ajo enigmë e vale që shkeqej e purpurit prej buzëve të tyre të mishta?  
 Herëdokur, si karusel i prishur, stepin të ngrira fragmente të gjymta paiszazhesh, interieresh, copëra frazash, përgjërime n'errësire... Pers-pektiva ndalon prerë dhe njëherësh - sikur le të kuptojte, se retina pelcët prapa vetit - nga drita çrënjëzore në fund të tunelit...

Tu te souviens de cet autre ciel vaste et étranger De la foule des inconnus dans la rue, des autos... et de la neige oblique qui telle une voilette à pois couvrait presque bruits, paysages et saisons, mais avant tout les corps nus, blancs des filles à l'amour morose. Que sont-elles devenues ? Qu'en est-il du mystère brûlant qui se détachait empoûvré de leurs lèvres charnues? De temps en temps, comme un manège en panne, se figent des fragments mutilés de paysages, d'intérieurs, des bouts de phrases, des supplications dans le noir... La vue se mire sur-le-champ, comme si l'œil crevait derrière la voilette à cause de la lumière inhumaine au bout du tunnel...

Vienne, septembre 2005

Vjenë, shtator 2005

Po më soseshin ditët dy e nga dy...  
 Para e prapa fluturonin  
 Krillat e letorit të shkuar mbi liqen.  
 Me çati të peskuqura ndër sy, mora rrugën  
 Duke çarë linëz ajërin e presuar me mall - po  
 Gurë, gur nën rota më bëheshin gëzhojat  
 Dhe mijëra plagë të vockla  
 Çelmin si të dehura  
 Rreth plages sime të madhe.  
 Veç trupit im i lenë djerrë  
 Kerrciste e digjej si barot i plleshëm  
 Pa e përmbajtur ndrydhjen e ditëve të fshehura.  
 Kështu, o gjaku im i sheqerit,  
 Kur dolem të kodrat mbi liqen  
 Na përzhijë qyteti. Krillat  
 E peskuqura në ajër  
 Më lagnin vështrimin  
 Dhe plaga ime e madhe  
 Llamburiste llampadar  
 Qarkuar nga të vocklat  
 Vrer e ar.  
 O ditët e mia të pandryshueshme!  
 Ja tek shtang e përralëzueshmja dhe  
 Shijellet atje, një lëmsj i hidhur i mbledhur  
 Me vite - banor i maskuar i përtje-thelleshive.  
 ...Lëbryja e liqenit me diell të manushaqë që  
 më vdes  
 Në ujërat e vona. Dhe muzdo bie si dërgesë  
 nga lart.  
 Vështrimi dobësohet.  
 Tingulli thyhet ndër veshë -  
 Dhe krillat  
 Pikëllimthi përsërisin  
 Imazhe të vdekshme shkrimore.

Mes journées s'en allaient deux par deux...  
 Devant et derrière volaient  
 Les cigognes d'octobre dernier au-dessus du lac. Le regard plein de loils empoûvrés, je suis parti En fendant discret l'air si lourd de nostalgie - Oui, Les douilles devenaient des pierres sous mes roues  
 Et des milliers de petites blessures  
 S'épanouissaient comme ivres  
 Autour de ma blessure béante.  
 Seul mon corps en jachère  
 Crépitait et brûlait comme une poudre féconde  
 Sans occulter le refoulement des jours cachés.  
 Ainsi, o mon sang sacré, une fois  
 Au sommet des collines surplombant le lac,  
 Nous n'avons fait qu'un avec la ville. Les cigognes  
 Dans leur vol empoûvré  
 M'humectaient le regard  
 Et ma blessure béante  
 Brillait de mille feux  
 Au milieu des petites  
 De fiel et d'or.  
 O mes jours invariables!  
 Voici l'irréalisable qui demeure interdit et  
 La se déroule une pelote amère faite  
 Depuis des années - habitant masque d'au-delà les profondeurs.  
 Le lac est ébloui par un soleil violet qui se meurt  
 Dans ses eaux tardives. Et le crépuscule tombe  
 comme un don du ciel.  
 Le regard s'affaiblit.  
 Le son se brise dans les oreilles  
 Et les cigognes  
 Renouvellement avec affliction  
 De mortelles images d'une certaine écriture.

Moscou, 1994

Traduit par Edmond TUPJA


Moskë, 1994

# B BOTIM

*Përgjatë gjithë "Armëpushimit", kësaj historie të trazuar dhe të larmishme të një pranvere lirie të pashpresuar, nota më e theksme është ajo e një ankthi të tmerrshëm, e një trishtimi të pangushëllueshëm njerëzor. Romani i Primo Levit erdhi pak ditë më parë në shqip...*



**PRIMO LEVI** është shkrimtar italian me origjinë hebreje, një prej të mbijetuarve të kampeve të përqendrimit hitleriane. U diplomua si kimist në vitet e para të vendosjes së regjimit fashist, i cili, më 1938 shpalli ligjet racore, që sollën diskriminimet e rënda ndaj qytetarëve italianë "të racës hebreje". Të gjitha këto e shtynë Levin të hynte në radhët e antifashistëve dhe të merrte pjesë në disa çeta partizane. U arrestua në dhjetor 1943 dhe, prej shkurtit 1944 deri më 27 janar 1945, përjetoi tmerrin e pafund të kampit të shfarosjes në Aushvic. Përvoja në kampin e përqendrimit e tronditi si fizikisht, edhe psikologjikisht dhe e shtyu të hidhte në letër makthin e jetuar prej tij e miliona njerëz të tjerë, përmes shkrimesh të paharrueshme si "A është, vallë, njeri...?", "Armëpushimi" dhe "Të mbytyrit e të mbijetuarit".



**Titulli:** Armëpushimi  
**Titulli në origjinal:** La tregua  
**Autori:** Primo Levi  
**Përkthyer:** Aida Baro  
**Zhanri:** Roman  
**Data e botimit:** Janar, 2018  
**Numri i faqeve:** 272  
**Çmimi:** 1000 lekë  
**Koleksioni:** Mozaik

dergjej në to; na i mbushi edhe me brenjë, sepse e ndienim që kjo s'mund të ndodhte, që kurrë më s'kish për të na ndodhur diçka kaq e mirë dhe e dëlirë sa të fshinte gjithë të shkuarën tonë, dhe damka e përdhosjes s'do të na shlyhej kurrë, s'do të shlyhej as nga kujtimet e atyre që i kanë përjetuar, as nga vendet ku ndodhi, as nga tregimet e rrëfimit që do të shkruanim. Ngase, dhe ky është privilegji i tmerrshëm i brezit dhe i popullit tim, askush tjetër, kurrë, s'ka arritur të rrokë natyrën e pashërueshme të poshtërit, që përhapet si epidemi. Është marrezia të mendosh që drejtësia njerëzore do ta shfarosë.

## Për Armëpushimin

"Armëpushimi", libri i kthimit, odisëja e Europës mes luftës dhe paqes, është vijimi i "A është vallë, njeri...?", një ndër librat më të bukur të letërsisë europiane lindur nga kampet e shfarosjes. Nëse libri i parë ishte shkruar menjëherë pas kthimit, thuajse me qëllimin për t'u cilruar së brendshmi nga barra e rëndë shpirtërore, si nevojë dëshmie, duke qenë se ai ishte një ndër të paktët hebrenj që mbijetuan në kampin e përqendrimit dhe duke iu bindur nevojës së menjëhershme për "t'u treguar të tjerëve, për t'i bërë të tjerët pjesëmarrës" të asaj tragjedie, libri i dytë është shkruar me njëfarë largësie nga ngjarjet, në një klimë më të shtruar e më të qetë.

Aventura europiano-qendrore e Levit nuk mbyllet me kthimin e Aushvicit nga ana e Ushtrisë së Kuqe, përkundrazi, si në një shtegtim fantazmagorik, Levi bashkë me një mijë e katërqind italianë të tjerë vërtiten nëpër hapësirën e paskajshme ruse për muaj me radhë, nga janari deri në fund të vitit 1945. Nuk dihen as sot e kësaj dite arsyet e kësaj sorollatjeje të panevojshme, ndoshta edhe thjesht për shkak të neglizhencës ose rrëmujës burokratike që mbizotëronte në Bashkimin Sovjetik

të asokohshëm. Gjatë gjithë kësaj periudhe, të mbijetuarit e Aushvicit përshkojnë gjithë Europën Qendrore dhe Lindore, përmes Polonisë, Rusisë së Bardhë, Ukrainës, Rumanisë, Hungarisë dhe vetë Gjermanisë. Lufta ende s'ka mbaruar ose siç thotë greku i Levit, një ndër personazhet më të spikatura të romanit, "Luftë është përherë", Europa po shijon njëfarë "armëpushimi" para se të mbërrijë lufta tjetër, "Lufta e ftohtë" që do ta copëtojë sërish Europën.

Me vërtetësi, ironi therëse deri në sarkazëm, Levi përshkruan tipa dhe karaktere nga më të ndryshmet, tregjet klandestine të Krakovës dhe Katovicës, çmobilizimin e shthurjen e radhëve të Ushtrisë së Kuqe, tokën ruse të pafund, të pushtuar nga lavidia, mjerimi, harresa dhe forca jetësore; kënetat e pyjeve të paprekura, trenat të shkatërruar, gostitë e shfrenuara të rusëve të dehur nga fitorja; fjetoret plot ëndrra të italianëve në udhën e pasigurt të kthimit. Libri është përkythyer cilësisht në shqip nga Aida Baro, që i shton kolonës së librave të saj dhe titullin e këtij romani të shquar. Ajo shquhet për zgjidhjen e shumë detyrave të vështira në përkthim.

### FRAGMENTE NGA LIBRI

1) Në kohë luftë, për dy gjëra duhet menduar para së gjithash: së pari për këpucët, së dyti për ushqimet; dhe jo anasjelltas, siç pandeh vegëllia: se kush ka këpucë mund të gjezdisë lirshëm për të gjetur ushqim, ama e kundërta s'bëhet.

- Po lufta ka mbaruar, - kundërshtova: dhe mendoja vërtet se kishte mbaruar, si shumë të tjerë në ata muaj armëpushimi, në një kuptim shumë më universal se ç'guxoj të mendoj sot.

- Luftë është përherë, - m'u përgjigj në mënyrë të paharrueshme Mordo Nahumi.

2) Malli është një vuajtje e brishtë dhe e ëmbël, ndryshe qysh në thelb, më intime, më njerëzore se vuajtjet e tjera që kishim përballuar deri në atë kohë: rrahje, të ftohtë, uri, terror, skamje, sëmundje. Është një dhembje e kthjellët dhe e pastër,

por ngulmuese: pushton gjithë minutat e ditës, s'të lejon të mendosh për asgjë tjetër, e të shtyn drejt nevojës për arrati.

3) Ishte po ai turp që e njihnim mirë, ai turp që na fuste në dhë pas seleksionimeve, apo sa herë që na takonte të shihnim, ose t'i nënshtrroheshim vetë, përdhosjes: ai turp që gjermanët s'e njohën kurrë, ai turp që njeriu i drejtë ndien para krimit të kryer nga të tjerët dhe e bren ndërgjegjja që një krim i tillë ekziston, që, në mënyrë të pandreqshme, është bërë pjesë e rendit të kësaj bote, dhe vullneti i mirë i këtij njeriu nuk ka sjellë asnjë dobi ose mbasë fare pak, e dëm ka shkruar gjithë munda për t'u mbrojtur.

4) Kësisoj, edhe për ne, ora e lirisë ra e rëndë dhe e errët, na mbushi shpirtat me hare e njëkohësisht me një ndjesi të dhembshme turpi, ndaj do të kishim dashur të pastronim ndërgjegjet dhe kujtimet tona nga shëmtia që



### KRIKITA

*Një prej librave vërtet më të nevojshëm të shekullit tonë.*

**Phillip Roth**

"Armëpushimi" është historia e një marrëzie kolektive, e një ligësie, e një budallallëku të pabesueshëm, gjithashtu dhe e një naiviteti njerëzor, e një shpirti, mirësie, kokëfortësie dhe natyre të zakonshme të fatit kombinuar me sipërmarjen. Ky është më shumë se një reportazh: është përjetimi i llahtarit në një prozë lirike e të ngjeshur. Në fund të fundit, mbetet një libër që ngre jetën në kult, sepse zgjeron horizontet, në vend që t'i eklipsojë; përforcon dëshirën për të jetuar mirë dhe ndërmshërisht. Të frymëzom mirësi.

**The Independent**

Vepra e Levit shërben për të dekonstruktuar forcat e së keqes. Triumfi i identitetit njerëzor dhe vlerave të tij mbi patologjinë e shkatërrimit të njeriut shkëlqen kudo në shkrimësinë e Levit. Për shumë arsye, veprat e tij zënë një vend të veçantë ndërmyjet pasurisë së Letërsisë së Holokaustit. [...] I pamposhtur si impulsi nekrotik, nevoja për të "treguar", për të përshkruar "tmerrin monoton të baltës" është jetike për të, sepse ai flet në emër të miliona njerëzve që vdiqën.

**Toni Morrison**

# P PROZE URBANE

*Në formën e aluzionit, shkrimtari kosovar përcjell subjektin e tij pa u kujdesuar aq shumë për formën sesa përmbajtjen...*

## evliatë...

### NGABAJRAM SEFAJ

... u shfaqen shpejt, rrufeshëm...

po aq shpejt, si për ngut, për fat, u zhdukën, u zhbënë, u zhbënë...! e qenë shfaqur aq befasishëm, aq fuqishëm, sa që pushtuan sakaq trojet tona varfanjake.

gjeten terren të përshatshëm: atje poshtë, në mykun e fundshekulit, në fund pus, të varfërisë e skajshme shumëshekullore në fshatrat tona të vrara lie e të mbytura në zhanin e errët mesjetar...

u zgjua evlia! zbardhur evlia, dje! njeju evlia, sot! nesër...?! pasnesër sigurisht, jashtë çdo dyshimi... diçka e tillë, do të ndodhë...!

\* fjala evlia, aq e ngulitur në gjuhën tonë, nuk është fjalë turke, se më fjalë shqipe, jo se jo, hiç se hiç!

fjala evlia, arabishten e ka gjuhë amtare, gjuhë të prejardhjes. asnjë fjalor s'ka pse të shfletohet, të gjurmohet se, s'bëhet gjë tjetër, veçse ngatërrohen punët e dilet në mal krejt, si prashitje në ujë, mjafton dijenia se evliatë janë robër të perëndisë, të zgjedhurit e madhërisë saj, besimtarët e

përpiktë, të devotshëm e vetëmohues...

nuk është fjala për kushedi çfarë njerëzish të mistershëm, fshheh e mbështjellë faqesh të vrugëta të dertërve të besimit mysliman, por që, megjithatë, ndjellin një lloj frike të mistershme, mbuluar me një me plaf si të frik-



# B BOTIM

Pas botimit shqip të poemave të Homerit prej përkthyesve të talentuar Gjon Shllaku ("Iliada") dhe Pashko Gjeçi ("Odiseja"), mendohej se nuk do të guxonte kush të përkthente dhe një herë këto dy kryevepra të letërsisë botërore. Mirëpo në vitin 2013 ndodhi e papritura: studiuesi i botës së lashtë greke i heshtur, Ilia Vasil Ballauri, e befasoi botën e letrave shqipe duke publikuar përkthimin e poemës "Iliada" përmes një botimi në një numur të kufizuar kopjesh, luksoz, realizuar jashtë vëndit me ISBN të nxjerrë nga Libraria KOTTI, Korçë dhe me shpenzimet e veta dhe më 2017 përkthimin e poemës "Odisea".

## SHQIPËRIMI I VEPRAVE HOMERIKE ILIADA dhe ODISEA prej ILIA V. BALLAURIT

NGA THANAS L. GJIKJA

Pas botimit shqip të poemave të Homerit prej përkthyesve të talentuar Gjon Shllaku ("Iliada") dhe Pashko Gjeçi ("Odiseja"), mendohej se nuk do të guxonte kush të përkthente dhe një herë këto dy kryevepra të letërsisë botërore. Mirëpo në vitin 2013 ndodhi e papritura: studiuesi i botës së lashtë greke i heshtur, Ilia Vasil Ballauri, e befasoi botën e letrave shqipe duke publikuar përkthimin e poemës "Iliada" përmes një botimi në një numur të kufizuar kopjesh, luksoz, realizuar jashtë vëndit me ISBN të nxjerrë nga Libraria KOTTI, Korçë dhe me shpenzimet e veta dhe më 2017 përkthimin e poemës "Odisea". Të dy këto poema janë botuar në format të madh A 4 të ndara secila në dy vëllime:

*Iliada* vëll. I përfshin rapsoditë 1-12 në 411 faqe dhe vëll. II përfshin rapsoditë 13-24 në 523 faqe.

*Odisea* vëll. I përfshin rapsoditë 1-12 në 354 faqe dhe vëll. II përfshin rapsoditë 13-24 në 383 faqe. Faqet e hyrjeve të secilës poemë hartuar prej përkthyesit, si dhe shënimi i gjatë në fund, nuk bëjnë pjesë në këtë numërim.

Dr. Ballauri ia dërgoi si dhuratë me anën e mikut të tij z. Thoma Karamitro, bibliotekës së qytetit tonë Uster (Public Library of Worcester MA) të katër vëllimet, që kushtojnë gjithsej 112 Euro / 11.200 lekë të rinj. Si dhuratë e ka shpërndarë ai këtë vepër ndër miq e shokë dhe në biblioteka e institucione të tjerë nëpër botë. Prej British Library, London, biblioteka më e madhe në botë me rreth 150 milion vëllime dhe me 3 milion dhurata në vit, ka mare dy here (për të dy veprat) vlerësim dhe falënderim nga drejtorët e sektorit për Evropën.

Ilia Ballauri mes tre vëllezërve është vëllai i vogël i poetit dhe përkthyesit Aleko Ballauri. Të dy këta bij të Korçës janë djemtë e muzikantit Vasil A. Ballaurit, pinjoll i një familjeje të vjetër e të pasur korçare me origjinë nga Voskopoja. Kjo familje është shquar për punë cilësore intelektuale të kryer pa bujë. I ati i tyre, Vasil, njohës i mirë i greqishtes si dhe i një sere gjuhëve të tjera por sidomos i muzikës (violinist e pianist), la në dorëshkrim një libër me shumë të dhëna nga historia e përhapjes së muzikës qytetare korçare, libër të cilin e botoi Ilia bashkë me serinë e tij prej shumë librave, mbi jetën e veprën



e filozofëve, historianëve e shkrimtarëve të antikitetit grek, etj. Kjo seri botimi parapriu botimit e dy poemave madhore të Homerit, atij të letërsisë artistike europiane.

Djali i madh i Vasilit, mësuesi i matematikës Aleko Ballauri, i cili kaloi jetën në fshatra të Gramshit, pas vitit 1992 iu kushtua letërsisë, sidomos poezisë. Ai shkroi e botoi disa vëllime me poezi origjinale dhe shumë vëllime me përkthime poezish nga letërsia ruse.

Me jetën dhe veprën e tyre, Vasil Ballauri dhe djemtë e tij Aleko dhe Ilia treguan se familjet e vjetra e të pasura korçare, që u luftuan aq

ashpër prej regjimit komunist, kishin në vetvete potenciale të mëdha mendore, të cilat ai regjim nuk ia shfrytëzoi e as ia vlerësoi sa e si duhej. Bijtë e kësaj borgjesie po ia dhurojnë arrijtet e veta kulturës, artit dhe shkencës sonë kombëtare pas shkërmoqjes së diktaturës, me dinjitet e pa bujë duke punuar me pasion mbas punës për të mbijetuar, ose në vite penisoni, pra jo duke qenë rrogetarë institucionesh shkencore a kulturorë si shumica e kuadrove të përkëdhelur të ish diktaturës ose të qeverive pasdiktatoriale.

Fatkeqësisht qeveritë pasdiktatoriale, ku mbizotërojnë ish komunistë e ish sigurimta, po humbin kohë dhe energji për të mbuluar dhe jo për të dënuar krimet e komunizmit, si dhe jo për t'u këthyer gjithë pronat pronarëve të shpronësuar dhe as për të vlerësuar arrijtet e ish të përdjekurve të regjimit komunist, që punojnë për të mëkëmbur dinjitetin e kombit tonë të abuzuar në shekuj.

Ilia është nga ata djem që e kryen gjimnazin shkëlqyeshëm, por për shkak të "biografisë së keqe", në vend që të dërgoheshin për studime në Tiranë në degët që donin, u dërguan të kryenin shërbimin ushtarak në brigadat e punës me lopatë në dorë, si Eugjen Merlika me shokë. Ai arriti të fitonte të drejtën e studimit në Institutin e Lartë Bujqësor, Korçë, ku nuk mori asnjë notë më poshtë se maksimalja. Punoji fillimisht si agronom në malësitë e Li-brazhdit dhe më pas në Korçë u muarr me punë shkencore në fushën e gjenetikës së bimëve. Ai kreu eksperimente dhe studime në këtë fushë, dha leksione për rreth 20 vjet në Universitetin Fan Noli Korçë dhe gjithë aktiviteti i tij shkencor pasqyrohen në rreth 3500 faqe botim librash, tekstesh, artikujsh e kumtesash.

Për shkak se qeveritë pasdiktatoriale nuk e morrën seriozisht krijimin e shtetit ligjor dhe përmirësimin e kushteve të jetës së mësuesve dhe pedagogëve, studiuesëve e krijuësëve, Ilia si dhe shumë të tjerë të cilët për fat të keq vazhdojnë edhe sot të emigrojnë, u detyrua të merrte rrugën e mërgimit në shtetin fqinj, në Selanik të Greqisë. Këtu, njohja e

gjuhës dhe përgatitja profesionale e ndihmuar të punësohet si studiues në fushën e virusologjisë për shumë vite.

Pasioni për mësimin e gjuhëve të huaja dhe shfrytëzimin e tyre i lindi Ilia që në fëmijëri, kur në familjen e tij babai, xhaxhallarët e miq të tyre recitonin në greqishten e vjetër pjesë nga poemat e Homerit. Dashuria për atë kulturë dhe pasioni për të mësuar gjuhët e huaja e mbajti Ilian të mbërthyer gjithë jetën që fëmijë, gjatë viteve të gjimnazit, të shërbimit ushtarak e gjatë punës si pedagog e studiues. Për të arritur tek përkthimin enciklopedik i poemave "Iliada" dhe "Odisea" ai ka shfrytëzuar përkthime të këtyre veprave dhe enciklopedi e libra të ndryshëm në tetë gjuhë të ndryshme.

Ky botim është i mbushur me sqarime, komente, analiza, etj, si dhe ilustrime, nga veprat më të mira të piktorëve dhe gravurave e krijuara gjatë shekujve për ilustrimin e kryeveprave homerike. Përfitimi i gjatë leximit të kësaj vepre madhore është i shumanshëm: artistik, letrar, filologjik, historik, filozofik, thjesht përfitim enciklopedik shumëdimensional.

Pyetja e parë që i bën lexuesi vetes gjatë leximit është: si ka pasur mundësi Ilia Ballauri të arrijë një përkthim shkencor enciklopedik pa jsur me kaq shume shënime sqaruese dhe ilustrime, punë për të cilën do t'i duheshin dy jetë njerëzore, pa u marrë me gjë tjetër. Kurse ai këtë punë që përfshin përkthimin e 23.000 varjeve (3000 faqeve) homerike në nivel të paarrtishëm në përkthimet e mëparshme, e ka kryer krahas punës pedagogjike e hulumtuese dhe përkthimeve të ndryshme, duke u ndihmuar vetëm prej bashkëshortes së tij.

Si askush, Ilia Ballauri me librat e tij ka krijuar një bibliotekë të tërë: ai ka botuar artikuj e kumtesa, ka përkthyer e botuar **31 libra** mbi jetën e veprën e njerëzve të shquar të Antikitetit Grek, mbi 600 faqeve me studime e dokumente për vendin e origjinës, Voskopojën e magjishme dhe 700 faqe me dokumente e studime për vendlindjen, Korçën frymëzuese dhe të paharueshme.

Kur e pyesin se cili është për ty vlerësimi më i madh sot, përgjigjet i përmalluar: *letëlvadërimi i klasës së parë prej mësueses Julia dhe puthjet e saj sa here që më shikonte fletoren e bukurshkrimit të cilën ia tregonte pastaj gjithë klasës si shembull.*

Për kryeveprën e tij të re, duke dashur të nënkuptohet se nuk do lavdërimet, thotë fjalët e Lazgushit: *Vepra let vetë.* Kënaqësi e madhe që midis ne shqiptarëve ka të tillë punëtorë të mëdhenj pa mburrma, të cilëve u jemi shumë borxhllinj për pasurimin e kulturës, artit, shkencës dhe botës sonë shpirtërore...

shëm religjioz...

po, po, vërtetë...

po, pra, ra në me fjetur, si kudo në gjithë botën mbarë, shëndosh e mirë, sytë mbyllur, kur gjumi i rëndoi mbi qepalla.

përralla, nis përrallë...

përralla...

fillon, ajo... përrallë dite e nate, datenatë! kur gjysma e botës mbështillet me rrobën e vrugët të territ të zi. në terr, mund të ndodhë çdo gjë, e papritura gjë.

e pabesueshmja gjë.

e panjohura gjë...

metamorfozë, qoftë ajo!

(nuk bëhet fjalë për metamorfozën e njohur të kafkës, por megjithatë, në pyetje është një gjë e tillë, e ngjashme me te, që ndodhte netëve të gjata, në gjumë të trazuar, a të pa gjumë fare!, mbytur në pusin e skamës shekullore, të prapambeturës shqiptari, në dimrat të saj, të pa fund të të pashpresë...!)

si askund tjetër, në botën shqiptare, evlajja nuk njihet gjini tjetër, pos gjinisë femërore!

ajo "godiste" vetëm nusët e reja, kryesisht, ndonjë të vajzë të re, aty-këtu, ndonjë çobaneshë të shëndetshme, kofshë nxehtë, me vorbull të valë nën brez, kur duhej të bëhej nuse, pa pasur qejf, pa e begenisur burrin çoban, në

ia impononin prindër e familje. këto ishin të përzgjedhurat e perëndisë! në këtë punë kishin gisht hoxhallarët e ri hileqarë, kur si ndërmetjesues të ishin, me koqe të mbushur, si hamshorë të ishin, nuseve të reja, jo të kënaqura me martesë, gjë merrej veshe e për botohej vetëm disa ditë pas natës së parë të dasmës, për tua larguar demonët shejtanë e, për tua afruar shenjtërinë, në birë të veshit plot pëshëtim e djerstitje, ua derdhin porositë e të madhit, pse jo edhe të fortit, se ç' duhej bërë e vepruar, si lipsej të silleshin (të loznin) brenda kornizave të atij skenari mirë të studiuar e me përpikëri të sajuar. diçka të turbullt birveshi, (a të ndonjë bire tjetër, helbete!), i hipnotizonin duke i porositur ato, për diçka tepër top sekret e të fshehtë që askush nuk bënte të dinte se cila është enigma e saj.

\* të nesërmen, me sabah, e reja duhet që zgjohej nga gjumi e, si e zgjedhur e perëndisë, pra si evlaja dhe duhej të vepronte si pas një skenari të nxënë mirë dhe të mësuar përmendesh...

duhej të rrinte shtrirë, pa ndërnuar më askënd asnjë një fjalë goje, duhej t'i gozhdonte sytë në një qosh të tavanit, të priste sinjal nga tavanit e pastaj të fillonte bisedën mecece me melaqet e qiellit... ideale do të ishte po qese në

atë çast, mbi atë qyshe tavanit të parakalonte ndo mijë ose shumë sish, veçse mbi dërrasa të tavanit të shkel këmbë e ndonjë shenjtërori të padukshëm, hoxhe të ri, kur mbase vetë autor i tërë këtit maskarallëku, atëherë, suksesi do të ishte i plotë, qëllura mu në shënjestër. pas lidhjes misterioze me qiellin dhe emisarët e tij të padukshëm gjithmonë, evlajja e re, mund t'ia kriste një gjumi të rehatshëm, duke pritur çastin kur "melaqja", hoxha i ri, atin e ti përdore, të vij e nuses-evlaja t'i jep gjajret, ta ngushëlloj t'ia freskoi sadopak sikletin. edhe nëse nusja apo vajza e re, zihet me të linjta neper këmbë edhe kësaj i gjendej qarja. evlajja kishte hipë në tavan, kishte zbritur në podrum, apo në ndonjë zgëz stalle, ahuri, a diku tjetër, ajo ishte punë e saj, mision i saj, kontakt me zëdhënësit koqe forte të perëndisë, e me evlajnë nuk bën, hiq nuk bën, të flitet për asgjë, të qortohet ajo aq më pak, kur është në thelbin e ëndrrës, syhapur.

\* Fatmirësisht, evlajatë tona sikur i pa sy' i keq, shpejt e për ngut, u zhdukën, pa zënë rrënjë të forta bima e tyre e fatkeq! fatbardhësisht!

(diku në shqiptari)

# D

DOSSIER

*Këto imazhe botohen për herë të parë. Në një kohë kur Shqipëria po përjetonte një nga fazat e saj më të vështira, por edhe më frytdhënëse në kuadrin e ringritjes institucionale e përpjekjeve shtetformuese, Spitali i Kryqit të Kuq Amerikan në Tiranë dhe veprimtaria e vullnetarëve të tij, njihet e nderohet nga të gjithë shqiptarët...*

## Vitet '20 kur "Spitali (i Kryqit të Kuq) Amerikan" i Tiranës ishte 100% me staf amerikan!

NGA ARMAND PLAKA

Sot ka një "Spital Amerikan", një francez e një gjerman, të cilët nuk e di nëse epiteli që mbajnë e cilësori që i shoqëron, shërben edhe si lidhje për të gjykuar apriori mbi origjinën e stafit të tyre e standardeve të shërbimit, përtej emrave që tingëllojnë shumë joshës.

Por dikur, ndoshta si pa u vënë re, e në një kohë kur Shqipëria po përjetonte një nga fazat e saj më të vështira, por edhe më frytdhënëse në kuadrin e ringritjes institucionale e përpjekjeve shtetformuese, duket se paskësh pasur një të tillë.

Të paktën kështu konsiderohet "Spitali i Kryqit të Kuq Amerikan" në Tiranë, në vitin 1920, menjëherë pas Luftës së Parë, i cili në ndryshim nga sot, në pjesën më të madhe përbëhej nga staf 100% amerikan, i cili nisi të plotësohej më pas edhe me infermierë shqiptarë.

Veprimtaria e Kryqit të Kuq Amerikan vijoi në fakt përgjatë gjithë viteve '20-të të shekullit të shkuar thuajse në mbarë territorin e Shqipërisë e sidomos u shtri në shumë në rajonin e Tiranës, Elbasanit, Beratit, Korçës e Vlorës.

Ra në sy sidomos përkujdesja për fëmijët jetimë dhe lufta për zbutjen e varfërisë në një vend që sapo kishte dalë i dërrmuar nga një luftë shkatërrimtare, e cila kombinohej me aktivitete plotësuese, sikurse ishte ngritja e kampeve të hapura për fëmijët dhe mësimi falas i gjuhës angleze.

Primare në kushtet e Shqipërisë për anëtarët e tij, të cilët vinin në Shqipëri në më të shumtën e rasteve tërësisht mbi baza vullnetare, ishte higjienizimi apo edukimi i njohtë e popullsisë me bazat e higjienës personale, çka solli me vete edhe investime ndoshta modeste, por të domosdoshme në kushtet e një vendi tejet të prapambetur.

Përbalja me një mentalitet tërësisht të ndryshëm nga ai që ato kishin lënë pas në vendin e origjinës, apo në vende të tjera europiane ku kishin shërbyer, gjithsesi nuk i pengoi vullnetarët amerikanë të arrinin objektivat e tyre në masën më të madhe me mirëkuptimin dhe mirënjohjen e popullsisë vendase, e cila shihte tek ta, përkrahësin më të madh në përpjekjet e tyre për një kapërcim epokal në jetën e tyre dhe formësimin e pavarësisë reale të tyre, sipas normave e standardeve më të



Kjo foto, edhe pse e fundit në renditje, duket se është ndoshta më e rëndësishmja për nga risia që sjell. Diçitura e saj në fondin arkivor amerikan, shënon se aty paraqitet një grup fëmijësh jetimë, të ardhur në jetë nga ndërveprimi shpesh i dhunshëm mes ushtarëve austriakë e atyre gjermanë me popullsinë vendase. Tashmë të braktisur nga fati dhe të paragjykuar nga një shoqëri me norma të një morali të ngurtë, duket se ata ndoshta ishin edhe kontigjenti më primar për t'u trajtuar nga duart e vullnetarëve amerikanë.



Shfaq një pjesë të anëtarëve të Kryqit të Kuq Amerikan në Shqipëri, me apo pa uniformë, po në janar 1920, ku sërisht dallohet qartë shpalsja me krenari e flamurit të tyre kombëtar dhe emblemat e Kryqit të Kuq.



Në këtë foto duket qartazi një vullnetare amerikane duke shërbyer si dentiste ndaj një pacienti, që sikurse përshkruhet në diciturën e fondit arkivor amerikan, kishte marrë tashmë lejen nga hoxha se ajo që po bënte, ishte konform rregullave të Islamit.

përparuara botërore. Në disa raste, ata do të duhej të merrnin edhe leje të posaçme nga kleri muhamedan për të ushtruar veprimtarinë e tyre, siç ishte ajo në lidhje me vashat shqiptare që do të shërbenin si infermiere e ndihmës-infermiere, apo ( edhe pse duket e çuditshme) edhe në rastet kur një shqiptar muhamedan do të duhej të lihej në dorën e një dentisteje amerikane, e për këtë ky i



Në këtë foto shihet një vagon që në mungesë të lokomotivës, tërhiqet nga një kalë në atë që njihet si "linja e vetme hekurudhore" Tiranë-Durrës, e lënë pas gjysëm e shkatërruar nga austriakët, tashmë humbës të luftës. Me anë të saj transportoheshin me dhjetra e mijëra pako ndihma humanitare, ilaçe e ushqime për popullsinë vendase që po vuante urie në hiterland-in shqiptar.



Shfaq dy infermiere amerikane dhe katër infermiere shqiptare të "sapidiplomuara" nga dora e trajnuesëve nga përtej detit.

fundit duhej të ishte "kompatibël" me normat fetare ( duke marrë bekimin apo miratimin e hoxhës së fshatit).

Në raste të tjera do të duhej të kapërcenin edhe ndonjë rezistencë keqkuptuese e dashakeqe, nga krerët e administratorë

lokalë, apo dhe anëtarë të veçantë të klerit vendas, por sidogoftë puna e tyre do të nderohet e shihet me mirënjohje nga shqiptarët, të cilët s'do të mungonin t'a ngrinin lart flamurin amerikan nëpër rrugët e ndërtesat e Shqipërisë, me po aq krenari sa edhe atë kombëtar:



Shfaq një kamp të hapur në Elbasan, i ngritur në fakt me shumë përfundime të argëtueshme të stafit të tij dhe me shumë gjasa, anëtarë të forcave franceze, si aleatë fitues për krah atyre amerikanë.



Shfaq ndërtesën e "Spitalit Amerikan" në Tiranë, ku dallohet qartë si flamuri amerikan, ashtu dhe ai i Kryqit të Kuq. Në skajin e djathtë të tij, shihet silueta e drejtorit të tij, në uniformën e ushtrisë amerikane të kohës, Dr. Lloyd W. Brooke.

Pas tyre shihet qartë një ndërtesë me arkitekturën tipike të aristokracisë vendase ( tiranase) që shërbente pra edhe si ndërtesa ku ofroheshin shërbimet mjekësore e gjithashtu edhe si administratë. Popullsia vendase, e cila përfilloi në një masë të madhe shërbimet e saj që varionin që nga ato me humanitare, deri tek ndërhyrjet profesionale ( për aq sa mund të flitej në atë kohë e me ato kushte) tashmë e njihje me shumë emrin "Spitali i Tiranës" apo "Spitali Amerikan", por jo rrallë edhe sikurse njihet zyrtarisht: "Spitali i Kryqit të Kuq Amerikan". Po ashtu, ajo shërbeu si një shkollë e mirë dhe gjenezë e arsimit profesional në Shqipëri ndërsa formoi dhe infermieret e para shqiptare.

Fotot që po paraqes bashkangjitur këty artikulli, janë marrë prej arkivave të

Librarisë ( dmth. Bibliotekës) së Kongresit Amerikan dhe tregojnë:

Opinion *i* Ditës

Nga Jorgji KOTE

*(Vijon nga faqja e parë)*

... tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu; për të vijuar me 140 vjetorin e krijimit të Lidhjes së Prizrenit që mbrojti me vetëmohim dhe vendosmëri çështjen kombëtare shqiptare; 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit që miratoi të parin alfabet të gjuhës shqipe dhe së fundi, por jo më pak i rëndësishmi 10-vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt.

Veç kësaj, bie në sy se viti 2018 ka dhe 25 jubile të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtar të lidhur ngushtë dhe me vendin tonë, për të mirë e për të keq. Janë ngjarje madhore të bukura e të gëzuara, por dhe të hidhura e të dhimbshme, që ndajnë epoka të tëra, lindjen e njerëzve të shquar, përfundime luftërash, krijime aleancash dhe organizatash ndërkombëtare, bllokada dhe ballafaqime ushtarake, ndërrime pushtetesh, etj.

Le t'i shohim një e nga një kronologjikisht, duke bërë kësajsoj dhe një kalim në kulmet më të shënuara të historisë botërore dhe asaj të vendit tonë. Jo vetëm për kureshtje intelektuale, por, sepse prej tyre vazhdojnë të nxirren shumë mësim të vlefshme, që të mos përsëriten më "izmat" e këqija të së kaluarës dhe të konsolidohen arritjet dhe vlerat e spikaturat të shoqërisë demokratike.

Nga mesjeta po përmendim vetëm Luftën 30 vjeçare ndërmjet disa vendeve të fuqishme evropiane, lufta më e madhe fetare që shkaktoi 8 milionë viktima. Ajo përfundoi në maj 1648 me nënshkrimin e Traktatit historik të Vestfalisë që në përgjithësi mbrojti paqen dhe sigurinë në Evropë deri në luftërat napoleoniane.

Duke shkuar në shekullin e XIX, më 5 maj 1818 lindi në Trier të Gjermanisë Karl Marks, mendimtar, filozof, sociolog dhe ekonomist me përmasa botërore. I konsideruar dhe si "Profeti" i komunizmit. Në Shqipëri shkollën e Marksit e ktheu në sistem diktatorial, duke e bashkuar padrejtësisht me Leninin dhe Stalinin Enver Hoxha që lindi më 16 tetor 1908.

Padyshim që një ndër ngjarjet më tingëluese të këtij shekulli ishte Revolucioni Industrial në Gjermani, Britani, Francë, etj. që filloi në vitin 1848 me shumë arritje dhe pasoja të njohura.

Më tej, më 10 qershor 1878 u mbajt nën drejtimin e "Kancelarit të Hekurt" Otto von Bismark Kongresi i Berlinit, pikë e madhe referencë për Ballkanin dhe sidomos çështjen shqiptare të përfaqësuar po atë vit nga Lidhja monumentale e Prizrenit.

Më 9 nëntor 1888 lindi Jean Monnet, një ndër ideatorët, krijuarit dhe drejtuesit më të shquar të Evropës së re të bashkuar.

Duke kaluar në shekullin e XX, më 9 nëntor 1918 u krijua Republika demokratike e Weimarit në Gjermani me Presidentin ikonik e social-demokracisë Fridrich Ebert, e cila u asgjësua në mënyrë kriminale 15 vite më vonë nga Hitleri.

Vetëm dy ditë më vonë, më 11 nëntor 1918 përfundoi Lufta e Parë Botërore që u kthye në kasaphanë të vërtetë. E megjithatë, siç dihet

# Vit rekord me 30 data jubilarë



prej saj nuk u nxorën mësimet e duhura.

Ndërsa në Dhjetor 1918 lindi Helmut Schmidt, Kancelar ekonomik gjerman (1974 - 1982) që ndërroi jetë tre vjet më parë.

20 vjet më vonë, më 9 Nëntor 1938 forcat naziste ndërmorën "Natën e xhamave të thyer" kundër qindra pronave, bizneseve dhe qendrave kulturore të hebrenjve në Berlin; në fakt, ajo shënoi fillimin e lançimit masiv të hebrenjve në vitet që do të vinin.

Pas Luftës së II Botërore, viti 1948 mund të konsiderohet si më i shënuari për Evropën e re që po lindte e ndarë. Ish-Bashkimi Sovjetik me Stalinin në muajin maj 1948 vendosi bllokadën e egër humanitare ndaj Berlinit Perëndimor, me qëllim që ta gjunjëzonte popullin e këtij qyteti dhe gjithë perëndimin. Por, dëshoto pas 11 muajve përballë solidaritetit të fuqishëm të aleatëve perëndimorë me në krye SHBA, të shprehur nëpërmjet Urës së famshme Ajrore të Berlinit, e ngritur dhe ajo atë vit, 70 vite më parë.

Po më 1948, Stalini u nda me Titon, të njëjtën gjë bëri dhe rrëgjimi ynë i asaj kohe, që u kthye përfundimisht në shtetin më stalinist në Evropë.

Ndërsa në botën perëndimore po ndodhte krejtësisht e kundërta.

Më 5 mars 1948 politikani em-

blematik Winston Çurcill paralamëroi për herë të parë ngritjen e "Perdes së Hekurt" në Fulton, Missourin në SHBA dhe pak javë më vonë në fjalimin për krijimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës.

Evropa që deri atëherë njihet si balancë e fuqive po rilindte mbi themele krejtësisht të reja të ekonomisë së tregut dhe shtetit të së drejtës. Siç e pohon historiani i shquar francez Jean - Baptiste Duroselle, viti 1948 shënoi dhe lindjen e Trefishtit të Evropës së re. Pasi kishin krijuar Paktin Mbrojtës të Brukselit, embrioni i NATO, më 19-20 Korrik 1948, ministri i Jashtëm të Beneluksit, Francës dhe Anglisë miratuan njëzëri thirrjen e Robert Schumanit, ish-kryeministri i Francës për krijimin e Këshillit të Evropës po atë vit dhe BE-së; kjo e fundit filloi nga funksionimi si Tregu i Përbashkët Evropian më 1 janar 1958, pas nënshkrimit të Traktatit të Romës më 25 mars 1957. Ky vit i shënuar politik u mbyll më 10 dhjetor 1948, kur OKB miratoi në Paris Kartën Universale të Drejtave të Njeriut.

20 vjet më vonë, në Maj 1968, në shumë vende perëndimore shpërthyer lëvizjet dhe protestat masive të rinisë dhe studentëve që morën trajtë e një revolucioni të vërtetë social kundër kapitalizmit, konsumatorizmit, traditave konservatore, etj. Ishin një tërmet të Njeriut.

qishëm politik për sistemin dhe qeveritë perëndimore, të cilit nuk i shpëtoi dot as mitiku francez Charles de Gaulle.

Ndërsa në ish-kampin komunist, më 21 Gusht 1968, Bashkimi Sovjetik sulmoi ushtarakisht Çekosllovakinë; për të parën herë në histori një vend pushtoi "vëllain" e tij më të vogël. Për pasojë, më 13 Shtator 1968, vendi ynë e denoncoi dhe doli nga Traktati i Varshavës.

Më 16 mars 1978 "bandat e kuqe" në Romë rrëmbyen dhe vranë pas një odiseje tejet të dhimbshme gati dy mujore ish-kryeministrin e shquar italian, Aldo Moro, ngjarje që gozhoi dhe tronditi Italinë dhe botën. Ndërsa në Shqipëri ky vit shënoi prishjen zyrtare të marrëdhënieve me Kinën, pas divergjencave të shumta ideologjike. Pas kësaj, të mbetur fillikot vetëm, te ne filloi zbatimi i parimit famëkeq të "mbështetjes tërësisht në forcat tona" që bashkë me ndalimin e kredive, ndihmave, tufëzimit, etj. ai e çoi drejt greminës regjimit monist.

Gjithsesi, më 22 tetor 1988, vendi ynë nënshkroi më në fund Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ekonomik, Teknik dhe Financiar me Gjermaninë Federale, e para e këtij lloji me një vend perëndimor. Në fakt, kjo marrëveshje ishte dhe "testamenti" politik i liderit legjendar të Bavarisë, mikut të

madh të vendit tonë, Franz Joseph Straus që pas tre vizitash historike në Shqipëri, mbylli sytë vetëm tre javë përpara nënshkrimit të saj 30 vjet më parë.

Vite më vonë, në shtator 1998, në Gjermani, pas 16 vjet sundimi demokratik, babai i Gjermanisë së ribashkuar, Helmut Kohl u dorëzua me zgjedhje demokratike përpara pasardhësit të tij Gerhard Schröder; kurse në Tiranë, as një vit pas trazirave të 1997, grupe dhe banda të armatosura të nxitura nga ish-opozita e atëhershme organizuan duke marrë shkas nga vrasja e Azem Hajdarit rebelimin e turpshëm por të dështuar për rrëzimin me dhunë të qeverisë. SHBA dhe Evropa e bënë të qartë se periudha e rrëzimit të qeverive të zgjedhura demokratikisht nga rruga dhe bandat e armatosura kishte marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Dhe vijmë kështu te data 17 shkurt 2008, kur pas demarshve dhe përpjekjeve të pareshtura, Kosova u shpall Republikë e Pavarur, duke realizuar kësajsoj ëndërrën e saj dhe tonën shekullore.

Së fundi, ky vit me aq shumë ngjarje jubilarë ka ardhur dhe me shpresën e madhe që në javët e ardhshme, të ndizet drita jeshile për çeljen e negociatave të antarësimit tonë në BE. Kjo do të ishte një datë tjetër e madhe dhe fatlume në albumin historik të vendit tonë.

Opinion Ditës

Planifikimi "6 në 3" si risi kurrikulare

Nga Pëllumb Karameta

(Vijon nga faqja e parë)

... godina me një dhomë, në godina të mëdha me qindra fëmijë, kanë ndryshuar edhe detyrat që pritet të plotësojnë mësuësit çdo ditë. Nëse mësuësit e dikurshëm zhvillonin vetëm 3 lëndë (lexim, shkrim dhe matematikë), mësuësit e ditëve tona mbulojnë veç tyre edhe shkencën, studimet shoqërore, edukimin fizik, artin, gjuhët e huaja dhe shumë tema të tjera. Është fakti që, përkundër shtimit të nxënësve nëpër klasa dhe ngarkesës mësimore, koha për mësim nuk ka ndryshuar. Secili mësuës zhvillon thua jse 24 orë mësimor çdo javë, me rreth 5 orë mësimor çdo ditë. Atëherë, si duhen planifikuar më mirë koha mësimore ditore e nxënësve? Si mund ta organizojmë ngarkesën ditore, që arrijtjet e tyre të jenë sa më të mira?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve i ofron nisma e re e MARS-it për zhvillimin e 3 lëndëve në 6 orë mësimor, e njohur ndryshe si "6 në 3". Reflektimi ynë rreth saj bazohet mbi të dhënat e përfutura nga disa burime.

Në kontekstin e përgjithshëm, nisma thellon reformën kurrikulare. Qëllim madhor i kësaj të fundit është zhvendosja rrethësore nga mësimdhënia që i aftësojnë nxënësit të ruanin në kujtesë dijet disiplinore, drejt të nxënësve që i aftësohen ata të nxënë vetë, duke vepruar për të ndërtuar njohuri të reja dhe kompetencat e duhura për jetët vetjake / shoqërore dhe tregun e punës. Për këtë, nisma nxit të rikonceptojë shumë prej ideve tona për shkollat, për qëllimet e tyre dhe mënyrat si duhen plotësuar ata me mirë; të rimendojmë gjithë sa bëjmë në procesin mësimor - edukativ, por dhe përsa i bëjmë ato. Këndej, do mund të kuptojmë edhe mundësitë për ndryshim që ofrohen.

Do mund të kuptojmë thellë dhe të shmangim, p.sh., pasojat e natyrës së centralizuar të funksionimit të sistemit tonë arsimor; qysh në zanafillën e tij. Natyrë që krijoi stereotipa të ngurtë mendore tek mësuësit dhe drejtuesit tanë për planifikimin e kohës, të ngarkesës dhe të strategjive / metodave. Stereotipa që kanë frenuar vetëveprimin dhe përpjekjet për ndryshim, në nivelin vetjak dhe institucional. Do na duhet të kuptojmë thellë faktorët me natyrë kurrikulare, organizative dhe profesionale që jetësojnë të nxënës bashkëkohor dhe përmirësimin e rezultateve në vendet e tjera.

Për të njohur nismën e re, një grup pedagogësh të psikologjisë po realizojnë një studim kompleks. Pjesë të tij janë aspektet: a) kërkimi në burimet e literaturës bashkëkohore dhe njohja e përvojës botërore, b) mbledhja e të dhënave në mjediset e klasave tona, si dhe c) pasqyrimi dhe analiza e perceptimeve prindërore. Në këtë fazë, studiueset tona kanë mundur të njohin qasjet planifikimi dhe orga-

nizimi të kohës dhe ngarkesës mësimore, në vende të ndryshme, si dhe mjaft karakteristikat e tyre.

Ai që spikat është planifikimi në bllok i kohës dhe ngarkesës mësimore. Me një orar tradicional, nxënësi në ShBA ndjek 6 deri në 8 lëndë çdo ditë për 45-55 minuta secila. Me planifikimin e ri, nxënësi ndjek një numër më të vogël të lëndëve, për një periudhë më të

klasave, si: marrja e mungesave, shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve apo përgatitja dhe përfundimi i veprimtarive të nxënies, çka ndikon mjaft sasinë totale të kohës në të cilën nxënësit përfshihen në veprimtari të nxënies kuptimplotë dhe produktive. Vëzhgimet kanë treguar se sasi të konsiderueshme të kohës mësimore, zakonisht, përdoren për detyra jomësimore, duke



gjatë kohë. Në vend të 7 lëndëve që zgjasin 55 minuta secili, nxënësi mund të ndjekë vetëm 4 lëndë në ditë, por do të qëndrojnë në secilën prej tyre për 85 - 90 minuta.

Ilustrim 1: Orari i javor i një shkolle të mesme në ShBA, ku koha mësimore e planifikuar është 85 minuta.

Table with columns: Koha, Semestri 1, Semestri 2, Semestri 3, Semestri 4. Rows show subjects like Anglisht, Shkencë, Spanjisht, Matematikë, Kompjuter, Histori, and Dreka.

Ilustrim 2: Oraret ditore të një shkolle fillore në Angli (koha e planifikuar 55 minuta) dhe i një shkolle të mesme të ulët në Kanada (koha e planifikuar 100 minuta). Koha Veprimtaria mësimore 8.45-8.55 Mësuësi kujdestar 8.55-9.00 Teknologji 9.00-10.45 Teknologji 10.45-11.05 Pushim 11.05-12.00 Gjeografi 12.00-12.55 Anglisht 12.55-1.40 Dreka 1.40-2.35 Dizenjim 2.35-3.30 Matematikë Koha Veprimtaria mësimore 100 minuta Lëndë shoqërore dhe arte 60 minuta Matematikë 40 minuta Shkencë Teknologji 50 minuta Edukim fizik 50 minuta Letërsi

PËRPARËSI TË QASJEVE TË REJA KONSIDEROHEN SI VIJON

1. Planifikimi dhe organizimi i ri janë më efektivë se sa ata tradicionalë, sepse u ofrojnë nxënësve më shumë kohë mësimore. Me më pak orë mësimor dhe me më pak kohë për ndryshimin e klasave, gjatë ditës mësimore, nxënësit mund të përqendrohen dhe të arrijnë më shumë.

2. Koha 45 minuta e orës mësimore tradicionale dhe pushimet ndërmetëse pakësojnë sasinë e kohës që mësuësit shpenzojnë për menaxhimin ditor të kohës apo të

lënë, jo rrallë, vetëm 10-15 minuta (nga 35 ose 40 më e pakta) për organizimin e mësimit dhe nxënien e pavarur. Në një ditë mësimore tradicionale, në mjaft shkolla, nxënësit kalojnë shumë kohë në korridore dhe lëvizim mes klasave, gjë që redukton më tej sasinë e kohës që mund t'i kushtohet nxënies apo aspekteve edukative.

3. Vëzhgimet në shkollat ku zbatohet planifikimi i ri i kohës dhe i ngarkesës, tregojnë se mësuësit po përdorin teknika mësimore më të larmishme dhe po shtjellojnë më shumë situata të nxënies, me më pak ndërprerje; ata po u kushtojnë më shumë vëmendje dhe mbështetje nxënësve të veçantë dhe po i përfshijnë ata në projekte më të larmishme; në situata që trajtohen përmes punës në grupe; ose veprimtari të tjera, çka nuk do mund ta arrinin në orën 45 minuta.

4. Në orën tradicionale është mjaft e vogël koha dhe vëmendja që mund t'i kushtohet nga mësuësi secili nxënës. Rrjedhimisht, marrëdhëniet nxënës-mësuës nuk mund të jenë të forta dhe nxënësit, veçanërisht ato me nevojë të veçantë mësimore ose me aftësi të kufizuara, nuk marrin vëmendjen dhe ndihmën për të cilën kanë nevojë, që të arrijnë suksesin e dëshiruar.

5. Planifikimi i më pak orëve mësimore në ditë zvogëlon ngarkesën për mësuësit dhe nxënësit. Për shembull, në një ditë tradicionale me 6 lëndë, mësuësit duhet të përgatiten për deri në 6 planifikime ditore (ditarët) dhe punojnë me një numër, shpesh, dy herë më të madh nxënësish. Rrjedhimisht, ata detyrohen të punojnë në tension, për të plotësuar detyrat e tyre, si: përgatitja ditore, sigurimi i mjeteve mësimore, sasia-cilësia e vlerësimeve për nxënësit etj. Nxënësit, nga ana e tyre, duhet të përgatiten për më shumë lëndë, çka, sigurisht, ndikon negativisht në cilësimin e nxënies dhe në sigurimin e burimeve dhe të mjeteve

për përgatitjen e punëve të pavarura pas mësimit.

Nga ana tjetër, qasjet e reja kanë kritikët e tyre. Këta pohojnë se formati i ri krijon probleme që kërkojnë zgjidhje.

1. Çfarë do të bëjnë nxënësit për 90 minuta? Vetëm planifikimi i ri nuk është garanci për nxënien aktive dhe rezultate të mira. Ai është thjesht parakusht. Nëse mësuësit do të vazhdojnë thjesht t'u japin leksione nxënësve, pa i përfshirë ata në veprimtari aktive gjithë mësimin, nxënësit mund ta kenë të vështirë të përqendrohen. Për të dobësuar ndikimin negativ, kërkuesit rekomandojnë të mbahet parasysh që nxënësi e klasave I-V mund ta përqendrojë vëmendjen për një kohe me vlerë sa mosha fizike + 1. Që do të thotë se nxënësi i klasës së tretë, p.sh., me moshë 8 vjeç, e mban vëmendjen të përqendruar për 9 minuta. Ndërsa për nxënësit më të rritur pranohet vlera rreth 15 minuta. Pas kësaj kohe, nxënësit duhet të kalojnë në veprimtari të tjera argëtuese dhe tërheqëse. Kjo varet kryesisht nga aftësitë profesionale të mësuësit dhe kushtet e mjedisit ku zhvillohet nxënia.

2. Si mund ta përbalim problemin që krijohet nga mungesat e mësuësve dhe nxënësve? Pasi dihet që arrijtjet e tyre mund të ndikohen edhe nga mungesat ditore, pa folur më, për mungesat për një kohë të gjatë. Por edhe mungesat e mësuësve janë faktor rreziku.

3. A do t'i ndikojë arrijtjet e nxënësve distanca ndërmetjet ditëve që krijohet nga përqendrimi i lëndës në një ditë të caktuar? Dihet që arrijtjet e nxënësve kushtëzohen jo pak edhe nga rendimenti i kujtesës. Më e dukshme kjo të nxënësit e shkollave fillore.


Kërkimet e grupit të studiuesve tona nuk kanë arritur ende t'u përgjigjen me argumente shqetësimeve të mësipërme, çka i bën ata objekt me vlerë për studim. Në këtë kuadër, ne vlerësojmë me interes për studim edhe elemente të tjera, si: ngarkesat që duhet planifikuar për vitin shkollor / shkallën kurrikulare; mënyrat e efikasitetit të ndërtimit të orarit javor; përpallja e sfidave që shkaktohen nga mungesat e nxënësve / mësuësve në shkollë etj.

Ne, gjithashtu, dimë se përgjigjet e argumentuara për shqetësimet si këto janë produkt i humlumtimit serioze në nivel sistemi dhe i matjeve e vlerësime profesionale në nivel shkolle. Njëherazi, ne dallojmë qartë se "procesi nuk është produkt", çka na detyron të mos lejojmë që procesi i ndryshimit të mbizotërojë për një kohë të gjatë mbi produktin. Njëherazi, ne mendojmë se është thelbësore që drejtuesit e të gjithë niveleve të jenë të qartë për atë që duan dhe të bëjnë kujdes nga opozita e talentuar e aktorëve të ndryshëm. Ata të mbajnë parasysh se do të ketë mësuës dhe prindër që mund ta shohin ndryshimin si kërcënim për pozitën e tyre apo arrijtjet e nxënësve. Kjo nënkupton jetësimin e motos "vlerësim, vlerësim, vlerësim", për ta bërë vlerësimin profesional të arrijtjeve pjesë integrale të programit për ndryshim.

Tiranë, më 03/02/2018

HOROSKOPI section containing horoscope entries for DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, and UJORI.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Irene aktore.
6. Gjysma e kulmit.
8. Fillojnë vetëm.
10. Qytet rumun
11. Mund të jenë me sahat.
13. Elliott Gould.
14. Inicialet e Altman regjisor.
15. Thomas Alva shpikës i famshëm.
16. Lumë në Spanjë.
18. Ndasheshin me sinorë.
20. Zbuloi Tokën e Van Diemen.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një kapak me titull.
25. Inicialet e Turgeniev.
26. Janë provat që administrohen.
28. Na kanë paraprirë .
30. Rubinstein që qe pianist.
31. Fundi i një fukarai.
32. Gardner aktore.

11. Përbindëshi i labirintit.
12. Vertetojnë firma të tillë.
16. Emri i Zola.
17. Eshhtë si shtëpi.
19. Mbyllin portat.
21. Ka tribuna me shkallë.
23. Mund të jetë telefonike.
24. Charles që krijoi Gishton.
26. Pineda e Garcia Lorca-s.
27. Janë të palëvizshmet.
28. Aty ku del kush bie në sy.
29. Ashtu si jeton anakoretit.
33. Coca... më e famshme.
35. Janë të ndryshme në leje.
37. Ente Civile Kavajë.
39. Shkroi Misteret e Parisit.
41. Beton pa kufij
43. Kështu përfundon një princip.
44. Inicialet e Cruise .
46. Kufizojë lëvizjet.

33. Këndon me Paolan .
34. Mish pa kocka.
36. Mbahet në fund.
37. Diftong teorik.
38. E drejta romake.
40. Eshhtë transporti si kamion.
42. Eastwood i kinemasë.
45. I vocërr ai i Migjenit.
47. Eshhtë numri 1.
48. Eshhtë aftësia e kondensatorit
49. Janë ciganët.

**VERTIKAL**

1. Eshhtë material për qiri.
2. Mali ku ngeci Arka e Noes.
3. Fillojnë panikun.
4. Një zakon.
5. Gjysmë sistem.
6. Janë zogj të verdhë .
7. Në fund të krahot.
8. Shkroi Michel Strogoff.
9. Gjysmë egoist.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Një pjesë e perandorisë
4. Duhën marrë kolegjisht.
11. Qytet rus
13. Fillojnë daljen.
14. Të lë në mëdysheje.
15. Një pjesë teatrale për të qeshur
17. Eshhtë publiku i San Siros.
18. Janë botimet e përnuajshme.
20. Mbyllin aeroportet.
21. Në krye të titullarëve.
22. Ishite gruaja që i dha ujë nga pusi Krishtit
25. Bëjnë zoom të tillë.
27. Inicialet e Kazan regjisior.
29. Centrale Autonome Daneze.
30. Eshhtë e kundërt e analizës.
31. Qe mjeku i Mark Aurelit.
33. Një enë

**VERTIKAL**


1. Një fjalë e pamjaftueshme.
2. Qe fabulist i famshëm
3. Janë ciganët.
4. Hapin vallen.
5. Eshhtë influencim.
6. Janë amatorët
7. Pak ilaritet
8. Një pjesë e mendimeve.
9. Eshhtë budallaçka.
10. Një fjalë e freskët.
12. Një emër i njohur i modës.
13. Me Odiseun u vodhi Palladin trojanëve.
16. Elvira aktore.
17. Pal... ish futbollist i yni.
19. Një pjesë i dardanëve.
21. Eshhtë marsejeze... për çati.
23. Eshhtë ylli më i shndritshëm i Akrepit
24. Liam aktor
26. Mund të jetë një koncert.
28. Kështu flet ai që është mbi kalë.
32. Janë shtetet e ndara nga feja.
35. Sean aktor.
36. Stoker që shkroi Dracula.
37. Një që bëhet si favor.
39. Tre në Genesaret.
43. Mbarojnë fare
44. Diftong për serioz.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

ST T A K I M T O P F  
 T L U I E I E K O N O M I  
 E P I T E T R A T Z A N  
 M A S A T F I N A L I S T  
 A R A T F I T I L A T E  
 T A T K A R A B I N A T  
 N K A M A T A T T A P  
 P O H I M R L A T E R I  
 A J O A R I S R E T E T E  
 S A T I R E T R E G T A R  
 H E V E R T O N T E R R  
 A T L E T E T M A R I E

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

T A N D E M I S A M I  
 E P E R S I A V E N D I  
 K A T I N Q A R K O F  
 T O H O M G N I M E R  
 U V H I R E S I A T T O  
 K A T O L I K E L O H A N  
 R E N E T A T I P A R I  
 G A Z E T A T A E N I  
 N E T R E N D O K K  
 E T U E E A N T E N A T  
 R E T A K T E T I T E T I  
 A E D I T A R T A R E T

*Argëtim filozofik*

**SUDOKU**

			9	2	3			
	8	1		6		5		2
		9				6	4	
5	7	6			1		8	
9			2		5			6
	1		6			4	5	3
6	4				9	1		
2		8		1		9	3	
			5	7	2			8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	8	7	6	9	3	5	2	1
6	2	1	4	5	8	3	9	7
3	5	9	7	1	2	8	4	6
8	9	4	2	3	7	1	6	5
7	1	2	9	6	5	4	3	8
5	6	3	8	4	1	9	7	2
1	4	5	3	7	6	2	8	9
9	7	8	5	2	4	6	1	3
2	3	6	1	8	9	7	5	4

*Argëtim filozofik*

- Të të duan thëllësisht - të jep forcë; të duash thëllësisht - të jep guxim!  
 Lao Tzu

- "Mik i mirë është ai që di gjithçka për ty dhe megjithatë vijon së çëni miku yt".  
 Elbert Hubbard

- "Një mik i vërtetë është shumë e vështirë që të gjendet, shumë e vështirë që të largohet, dhe është e pamundur që të harrojë".

**KRIPTOSKEME**  
 Përgjigja e numrit të djeshëm

9	11	7	8	1	3	16	1	15				
14	8	5	3	4	5	4	2	18	2			
8	4	2	14	8	10	11	1	10	3	1		
13		12	3	13	13	3	1	2	1	3		
6	4	8	10		18	2	4	6	2	13		
3	18	2	E	T	A	15	6	18	2	1	6	7
1	6	1	4	7	3	3	11	6	7			
16	11	1	3	13	3	8	1	2	7	2		
6	16	3	5	3	9	15	8	10	2	1		
6		4	6	10	6	11		6	1			
3	4	14	3	1	10	3	1	10	3	12		
12	3	1	3	4	3	5	16	2	1	3		

C E L P O H I M C E P  
 A C P O L E M I K A L  
 K O K E E R D A R K A  
 U O R P E H T E N  
 I N F O R M A C I O N I  
 H E F E S T I L E D  
 D I K T A T U R E E R  
 P R T A E R R U T A  
 A R M E T R U S C  
 N I I A C A D E T I  
 D A M A R E T H A R S  
 A N I L A C I A I R T

*Thënie të mençura*

- Nëse njerëzit do të dinin sa shumë duhet të bënin për të arritur suksesin, shumica e tyre nuk do t'i hynin asaj rruge. (Lord Tomson i Flotës)
- Sekreti i fitores qëndron në organizimin e gjërave jo të qarta. (Kristofer Morley)
- Mos i beso asgjëje, s'ka rëndësi ku e ke dëgjuar ose kush e ka thënë, edhe sikur ta kem thënë unë, vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde.
- Kush nuk ka plagë në dorë mundet të prekë helmin me atë dorë; helmi nuk penetron aty ku nuk ka plagë; dhe nuk është mëkat (vepra) për atë që nuk e ka mëkat.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

